

# Parlamentet kombëtare si garantues të të drejtave të njeriut në Evropë



Doracak  
për parlamentarët

Përkthimi është  
bashkë financuar nga  
Bashkimi Evropian



COUNCIL OF EUROPE



CONSEIL DE L'EUROPE



# Parlamentet kombëtare si garantues të të drejtave të njeriut në Evropë

## Doracak për parlamentarët

Përgatiti Dr. Alice Donald  
dhe Zj. Anne-Katrin Speck, Universiteti i  
Middlesex, Londër (Mbretëria e Bashkuar), në  
bashkëpunim me sekretariatit  
e Komisionit për Çështjet Ligjore dhe të Drejtat e  
Njeriut të Asamblesë Parlamentare  
të Këshillit të Evropës

**Botimi në frëngjisht:**

*Les parlements nationaux, garants  
des droits de l'homme en Europe –  
Manuel à l'usage des parlementaires*

*Ky përkthim u prodhua me mbështetjen  
financiare të Bashkimit Evropian  
dhe të Këshillit të Evropës.*

Pikëpamjet e shprehura këtu  
në asnjë rast nuk mund të  
merren bazë për të reflektuar  
opinionin zyrtar të asnjë pale.

Të gjitha të drejtat e rezervuara.  
I licencuar në Bashkimin Evropian  
sipas kushteve të miratuara.

Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund  
të përkthehet, riprodhohet ose të  
transmetohet në çfarëdo forme  
ose përmes çfarëdo mjeti, qoftë  
elektronik (CD-Rom, Internet, etj.)  
apo mekanik, përfshirë fotokopjimin,  
regjistrimin apo çfarëdo sistemi  
depozitimi ose marrjeje informacioni,  
pa lejen paraprake me shkrim  
nga Drejtoria e Komunikimit  
(F-67075 Strasburg Cedex ose  
[publishing@coe.int](mailto:publishing@coe.int)). E gjithë  
korrespondenca lidhur me  
këtë dokument duhet t'i  
drejtohet Sekretariatit të  
Asamblesë Parlamentare.

Kopertina dhe faqosja:

Drejtoria e Prodhimit të  
Dokumenteve dhe Botimeve (SPDP),  
Këshilli i Evropës

Fotografitë: © Këshilli i Evropës

©Këshilli i Evropës, Shtator 2018,  
përkthyer në Dhjetor 2019  
Shtypur në Këshillin e Evropës

Ky përkthim është prodhuar me fondet  
e Instrumentit Horizontal II Veprimi  
“Bashkëpunimi PACE me asambletë  
parlamentare me qëllim arritjen e  
përmirësimeve legjislative”, i financuar  
nga Bashkimi Evropian dhe Këshilli  
i Evropës dhe i zbatuar  
nga Këshilli i Evropës.

# Përmbajtja

---

|   |           |
|---|-----------|
| <b>PARATHËNIE</b>   | <b>7</b>  |
| <b>SHKURTIMET</b>   | <b>9</b>  |
| <b>FJALOR ME TERMAT KYÇ</b>   | <b>10</b> |
| <b>SHKURT PËR KËSHILLIN E EVROPËS</b>   | <b>13</b> |
| Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës   | 14        |
| Komiteti i Ministrave   | 15        |
| Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut   | 15        |
| Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut  | 16        |
| <b>KAPITULLI 1 – CILI ËSHTË SYNIMI I KËTIJ UDHËZUESI?</b>   | <b>17</b> |
| <b>KAPITULLI 2 – ÇFARË DETYRIMESH KANË PARLAMENTARËT PËR TË DREJTAT E NJERIUT?</b>                                | <b>21</b> |
| 2.1. Rritja e vetëdijes që parlamentarët janë garantues të të drejtave të njeriut                                 | 21        |
| 2.2. Detyrimet e Parlamentarëve për të ndërmarrë veprime pozitive   | 25        |
| <b>KAPITULLI 3 – DETYRAT E PARLAMENTARËVE PËR PËRMBUSHJEN E DETYRIMEVE NDAJ TË DREJTAVE TË NJERIUT</b>            | <b>27</b> |
| 3.1. Funksionet e parlamentarëve për të drejtat e njeriut   | 28        |
| 3.2. Si duhet të mundësojë ekzekutivi që parlamentarët të kryejnë funksionet e tyre për të drejtat e njeriut?     | 37        |
| 3.3. Bërja realitet e përgjegjësisë së përbashkët për të drejtat e njeriut  | 43        |
| <b>KAPITULLI 4 – ORGANIZIMI I DUHUR I PARLAMENTARËVE PËR PËRMBUSHJEN E DETYRIMEVE NDAJ TË DREJTAVE TË NJERIUT</b> | <b>47</b> |
| 4.1. Mënyra të ndryshme për të organizuar punën parlamentare për të drejtat e njeriut                             | 49        |
| 4.2. Mbështetja për të gjithë parlamentarët që të bëhen garantues të të drejtave të njeriut                       | 54        |
| <b>KAPITULLI 5 – DETYRAT E PARLAMENTARËVE PËR STRUKTURA FUNKSIONALE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT</b>                 | <b>59</b> |
| 5.1. Statusi dhe detyrat  | 60        |
| 5.2. Anëtarësia   | 61        |
| 5.3. Kompetencat  | 62        |
| 5.4. Praktikrat e punës   | 63        |
| 5.5. Zhvillimi i marrëdhënieve të jashtme   | 64        |

|   |           |
|---|-----------|
| 5.6. Trajnimi dhe asistenca teknike   | 67        |
| 5.7. Vlerësimi i efektivitetit të komitetit për të drejtat e njeriut  | 67        |
| <b>KAPITULLI 6 – SI MUND TË PUNOJNË PARLAMENTARËT MË NGUSHTË ME KËSHILLIN E EVROPËS?</b>  | <b>71</b> |
| 6.1. Roli dhe përgjegjësia e veçantë e delegatëve të Asamblesë Parlamentare   | 72        |
| 6.2. Si mund të ndërtojnë të gjithë parlamentarët një marrëdhënie më të ngushtë me Këshillin e Evropës                            | 75        |
| 6.3. Të fituarit e mbrojtjes nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut: si e respekton gjykata praktikën e mirë parlamentare | 83        |
| <b>PËRFUNDIM</b>  | <b>87</b> |
| <b>SHTOJCA 1 – LISTA E KONTROLLIT PËR PARLAMENTARËT</b>   | <b>89</b> |
| <b>SHTOJCA 2 – REZOLUTA 1823 E APKE (2011)</b>  | <b>93</b> |
| <b>SHTOJCA 3 – LEXIME DHE BURIME SHITESË</b>  | <b>96</b> |



”**S**istemi i ngritur në kuadër të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut është sot në shënjestrën e një sërë sulmesh sovraniste, disa prej të cilëve shprehen nga anëtarë themelues të Organizatës sonë. Por, me gjithë sfidat, qofshin këto mosbesim i thjeshtë, përpjekje për të kufizuar fushëveprimin e saj, apo edhe të ndalojnë zbatimin e Konventës, ne duhet të përgjigjemi fuqishëm por edhe në mënyrë konstruktive me qëllim që së bashku të gjejmë zgjidhjet e duhura.

Nëse sulmohet Këshilli i Evropës dhe instrumentet e tij themelore, si Konventa dhe Gjykata, sulmohen qytetarët e Evropës, duke u dobësuar kështu të drejtat dhe mbrojtjen në marrëdhëniet e tyre me shtetin.

Është detyrë e Asamblesë Parlamentare dhe secilit prej anëtarëve të saj të mbrojnë sistemin e Konventës sonë për të Drejtat e Njeriut dhe ta shprehin autoritetin e saj në interes të 830 qytetarëve të Evropës.”

**Liliane Maury Pasquier**  
Presidente e Asamblesë Parlamentare  
të Këshillit të Evropës  
Qershor 2018





## Parathënie

---

**P**arlamenti është në thelb të demokracisë me përfaqësim, pavarësisht veçorive të sistemeve të ndryshme të qeverisjes, qofshin këto sisteme parlamentare, presidenciale, ose gjysmë-presidenciale, që janë të gjitha të pranishme midis shteteve anëtare të Këshillit të Evropës. Kjo është arsyeja përse Asambleja Parlamentare (APKE) është në thelb të kuadrit institucional të Këshillit të Evropës. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Gjykata) dhe roli i përforcuar i APKE-së përbëjnë veçoritë më interesante të Këshillit të Evropës në krahasim me organizatat e tjera rajonale, dhe i japin atij vlerë të shtuar.

Megjithatë, parlamentet kombëtare duhet të bashkëpunojnë aktivisht në mënyrë që APKE-ja të luajë me efikasitet rolin e vet në të tre shtyllat mbi të cilat bazohet Këshilli i Evropës: demokracia, të drejtat e njeriut dhe sundimi i ligjit. Për më tepër, thjesht ekzistenca dhe funksionimi i një parlamenti nuk do të thotë që sistemi i qeverisjes është demokratik, nëse mbrojtja e të drejtave të njeriut dhe respekti për sundimin e ligjit nuk sigurohen, siç përcaktohet qartë dhe në mënyrë praktike nga Komisioni Evropian për Demokraci përmes Ligjit (Komisioni i Venecias) në Listën e Kontrollit të Sundimit të Ligjit të kohëve të fundit.

Në fushën e ndjeshme të të drejtave të njeriut, çdo parlament kombëtar vepron kryesisht si ligjvënës. Kështu, ka gjithmonë rrezik që parlamenti kombëtar të shkelë një të drejtë ose, përmes ligjit kombëtar, të sigurojë mbrojtje të papërshtatshme lidhur me standardet ndërkombëtare, veçanërisht ato që linden në kuadrin e Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (Konventa) dhe nga jurisprudenca e Gjykatës. Pra, detyra parësore e çdo parlamenti kombëtar është të sigurojë harmonizim të legjisllacionit kombëtar me Konventën dhe jurisprudencën e Gjykatës. Pa dyshim, parlamentet kombëtare kanë detyrimin thelbësor të japin kontribut për përputhshmërinë e shtetit të tyre me vendimet përkatëse të Gjykatës dhe më gjerë me çështjet e trajtuara tashmë nga vendimet e Gjykatës.

Për më tepër, parlamentet kombëtare nuk duhet të veprojnë vetëm si kontrollues që mbikëqyrin masën e respektimit të të drejtave të njeriut nga ekzekutivi, por ato duhet gjithashtu ushtrojnë mbikëqyrje të vazhdueshme parlamentare në këtë fushë, duke zbatuar trysninë institucionale që këto çështje të trajtohen dhe të ndërmerren nismat e nevojshme legjislative. Nëse parlamenti kombëtar merr pjesë në procesin e përzgjedhjes së anëtarëve të gjykatave të larta dhe kushtetuese në vend, pa dyshim që mbrojtja e të drejtave të njeriut është një kriter themelor për rekrutimin dhe duhet të sigurohet respektim absolut i parimit të ndarjes së pushteteve.

Funksionet legjislative dhe mbikëqyrëse të parlamenteve kombëtare i bëjnë ato garantues të të drejtave të njeriut, që veprojnë përmes strukturave organizative (komisioneve, përgjegjësive etj.) të përcaktuara në kushtetutat kombëtare dhe në rregulloret që rregullojnë veprimtarinë e parlamentit. Është me rëndësi jetike që parlamentet kombëtare dhe të gjithë anëtarët e tyre të qëndrojnë vigjilent dhe të angazhuar aktivisht.

APKE-ja është përqendruar në këtë çështje duke miratuar një sërë rezolutash mbi objektivat e përgjithshëm të Këshillit të Evropës ose mbi zbatimin e vendimeve të Gjykatës.

Ky doracak për parlamentarët, i përgatitur nga Dr. Alice Donald dhe Zj. Anne-Katrin Speck nga Universiteti Middlesex në Londër, në bashkëpunim me Sekretariatit e Komitetit për Çështjet Ligjore dhe të Drejtat e Njeriut të APKE-së, siguron një paraqitje të shkëlqyer të kuadrit institucional, si në nivelin e Këshillit të Evropës ashtu edhe në nivel kombëtar, brenda të cilit parlamentet kombëtare veprojnë për të mbrojtur të drejtat e njeriut, dhe në veçanti tek zbatojnë standardet e konventës dhe vendimet e Gjykatës, si dhe kur sigurojnë përputhshmëri me parimet interpretuese të jurisprudencës së saj. Rezolutat përkatëse të APKE-së pasqyrojnë praktikat parlamentare të shteteve anëtare që mund të jenë burim frymëzimi edhe për parlamente të tjera kombëtare. Ky doracak i dobishëm nuk është i menduar vetëm për anëtarët e APKE-së, por edhe për të gjithë anëtarët e parlamenteve kombëtare të shteteve anëtare të Këshillit të Evropës.

Në fund të fundit, vigjilenca më e madhe lidhur me të drejtat e njeriut duhet të vijë përpara çështjeve të kompetencës dhe procedurave, vigjilenca nga ana e të gjithë qytetarëve, organizata jofitimprurëse, dhe pa dyshim parlamentarëve që përfaqësojnë qytetarët e tyre.

**Evangelos Venizelos**

Raportues i APKE-së për Zbatimin e Vendimeve të  
Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut

# Shkurtime

---

|       |   |
|-------|---|
| KM    | Komiteti i Ministrave   |
| OJF   | Organizatë Jo Fitimprurëse  |
| IKDNJ | Institucion Kombëtar i të Drejtave të Njeriut   |
| APKE  | Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës   |
| DMPP  | Divizioni i Mbështetjes së Projektit Parlamentar<br>(në Sekretariatit e Asamblesë Parlamentare) |
| OKB   | Organizata e Kombeve të Bashkuara   |

# Fjalor i termave kyç

---

## **Plan veprimi dhe raport veprimi**

Plani i veprimit përcakton hapat që një shtet ka për qëllim të marrë për zbatimin e një vendimi të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (Gjykata). Një raport veprimi përshkruan masat që janë marrë nga një shtet për zbatimin e një vendimi dhe/ose shpjegon përse një shtet është i mendimit se nuk është e nevojshme marrja e masave, ose masa të mëtejshme. Planet e veprimit dhe raportet e veprimit i dorëzohen Komitetit të Ministrave (KM).

## **Ekzekutimi**

Termi i përdorur për zbatimin e një vendimi, pra një gjykim është “ekzekutuar” nëse shteti përkatës ka marrë të gjitha masat e nevojshme për të arritur përputhshmëri me këtë vendim. Procesi i ekzekutimit mbikëqyret nga KM-ja.

## **Agjent qeveritar**

Emërtimi që i jepet zakonisht zyrës qeveritare që përfaqëson shtetin përpara Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, dhe që shpesh koordinonjë ekzekutimin e gjykimeve në nivel vendas.

## **Masa individuale dhe të përgjithshme**

Pas një vendimi negativ të Gjykatës, mund të nevojiten masa individuale për të siguruar që shkelja të mos kryhet më dhe që pala e dëmtuar të rikthehet për aq sa është e mundur në të njëjtën situatë që ai ose ajo gëzonte përpara shkeljes së Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (Konventa). Mund të nevojitet edhe marrja e masave të përgjithshme për të parandaluar shkeljet e reja ose për t’i dhënë fund shkeljeve të vazhdueshme, veçanërisht (megjithëse jo vetëm) në ato raste kur shkelja vjen si pasojë e një problemi strukturor apo në sistem ligjor ose politikash.

## **Unioni Ndër-Parlamentar (UNP)**

Organizata ndërkombëtare e parlamenteve, e themeluar në vitin 1889, me qëllim mëkëimin e koordinimit ndër-parlamentar dhe shkëmbimin e njohurive dhe përvojave mes parlamentarëve të të gjitha vendeve. Promovimi dhe mbrojtja e të drejtave të njeriut janë ndër synimet kyçe të UNP.

## **Autoritet interpretues (ose *res interpretata*)**

Megjithëse vendimet e Gjykatës janë ligjërisht detyruese vetëm në shtetin e përfshirë në çështje, Nenet 1, 19 dhe 32 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut janë interpretuar dhe i kërkojnë shteteve të marrin në konsideratë jurisprudencën e Gjykatës në tërësi, përfshirë parimet e zhvilluara në gjykimet dhe vendimet kundër shteteve të tjera.

## **Marzhi i vlerësimit**

Shkalla e respektit që Gjykata merr parasysh gjatë shqyrtimit të një çështjeje, lidhur me vlerësimin se si autoritetet kombëtare përmbushin të drejtat e tyre në kuadrin e të drejtave të njeriut sipas Konventës. Gjithashtu, shtetet gëzojnë një marzh vlerësimi kur identifikojnë, nën mbikëqyrjen e Komitetit të Ministrave, masat e mara për të korigjuar një shkelje të identifikuar nga Gjykata.

## **Detyrimet negative dhe pozitive**

Një detyrim negativ i kërkon shteteve të mos ndërhyjnë në të drejtat e individit pa justifikim, pra shteti nuk duhet të bëjë diçka. Një detyrim pozitiv i kërkon shteteve të ndër marrin veprime specifike parandaluese ose mbrojtëse për të siguruar të drejtat e Konventës, edhe nëse kërcënohet shkelja e të drejtave ose ajo është kryer nga ana e një individit apo organi privat, përveç agjentit të shtetit.

## **Sundimi i ligjit**

Komisioni Evropian për Demokraci përmes Ligjit (Komisioni i Venecias) ka identifikuar sa më poshtë si elementet kyçe të sundimit të ligjit: (i) ligjshmëria, përfshirë një proces transparent, llogaridhënës dhe demokratik për miratimin e ligjeve; (ii) Siguri ligjore; (iii) ndalimin e arbitraritetit; (iv) aksesin në drejtësi përpara gjykatave të pavarura dhe të paanshme, përfshirë shqyrtimin gjyqësor të akteve administrative; (v) respektimin e të drejtave të njeriut; dhe (vi) mosdiskriminimin dhe barazinë përpara ligjit.

## **Shtetet palë**

Shtetet që kanë ratifikuar një traktat ndërkombëtar, për shembull Konventën Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

## **Subsidiariteti**

Në kontekstin e Konventës, parimi që autoritetet kombëtare (qeveritë, parlamentet dhe gjykatat) kanë përgjegjësinë parësore për t'i siguruar të gjithëve në juridiksionin e tyre të drejtat dhe liritë e Konventës, dhe të sigurojnë korigjime efikase kur këto të drejta shkelen.

## **Mbikëqyrje e ekzekutimit të gjykimeve**

Pas një gjykimi të Gjykatës që përcakton një ose më shumë shkelje të Konventës, Komiteti i Ministrave mbikëqyr masat e mara nga shteti përgjegjës për ekzekutimin e gjykimit në fjalë.



## Këshilli i Evropës shkurtimisht

**K**ëshilli i Evropës ka 47 shtete anëtare, duke përfshirë pothuajse të gjithë kontinentin e Evropës. I themeluar pas Luftës së Dytë Botërore me qëllim krijimin e “një uniteti më të ngushtë midis të gjitha vendeve që ndanin të njëjta mendime për Evropën” në mënyrë që të ruanin dhe të realizonin “ideat dhe parimet që janë trashëgimia e tyre e përbashkët dhe të lehtësonin përparimin e tyre ekonomik dhe shoqëror”<sup>1</sup> ai synon të mbështesë dhe të zhvillojë parimet e përbashkëta demokratike dhe ligjore të bazuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (Konventa) dhe në shumë traktate të tjera të diskutuara dhe të miratuara brenda kornizave institucionale të Organizatës.

1. Statuti i Këshillit të Evropës, 5 maj 1949, ETS. nr. 1.

## Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës

E krijuar në vitin 1949 - si një forum inovativ në një kohë kur sistemet mbikombëtare ishin ende në fillimet e tyre - Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës (APKE, Asambleja) është një nga dy organet statutorë të Këshillit të Evropës dhe vepron si organi i saj diskutues. Asambleja përbëhet nga 648 anëtarë (324 përfaqësues dhe një numër i barabartë zëvendësuesish) nga parlamentet e 47 shteteve anëtare të Këshillit të Evropës. Puna e Asamblesë përgatitet në nëntë komisione të përhershme dhe shumica dërrmuese e anëtarëve i përkasin njërit prej gjashtë grupeve politike. Anëtarët e kuvendit takohen katër herë në vit për seanca plenare në Strasburg për të diskutuar çështje me tema aktuale dhe u kërkojnë qeverive evropiane të ndërmarrin nisma dhe të raportojnë në lidhje me ato. Këta parlamentarë flasin në emër të 800 milionë evropianëve që i kanë zgjedhur.

Me qëllimin e tij parësor i cili është “promovimi i debateve mbi çështjet që dalin dhe ato evropiane, identifikimi i tendencave dhe praktikave më të mira dhe përcaktimi i pikave të referencave dhe standardeve”,<sup>2</sup> Asambleja Parlamentare ka qenë “ruajtare kryesore e të drejtave të njeriut”, duke promovuar sundimin e ligjit dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut në të gjithë Evropën. Modeli i saj unik i dialogut ka kontribuar në ndërtimin e konsensusit për të shuar konfliktin politik dhe për të mbrojtur dhe promovuar vlerat tona të përbashkëta evropiane. Për më tepër, Asambleja zgjedh, ndër të tjera, gjyqtarët e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (Gjykatën) dhe Komisionerin për të Drejtat e Njeriut, si dhe Sekretarin e Përgjithshëm dhe Zëvendës Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Evropës.

### Disa arritje të Asamblesë Parlamentare

Në ekzistencën e saj gati 70 vjeçare, Asambleja ka kontribuar në mënyrë të konsiderueshme për transformimin e Evropës në një “zonë pa dënim me vdekje”, duke e bërë heqjen e dënimit me vdekje kusht paraprak për anëtarësim. Kuvendi ka mbështetur vendet ish-komuniste në tranzicionin e tyre demokratik dhe ka punuar pa u lodhur në drejtim të zbulimit të shkeljeve të të drejtave të njeriut në Evropë kudo që ato ndodhin. Ndikimi i saj vendimtar në fushën e të drejtave të njeriut në Evropë i ka rrënjët që nga vitin 1949, kur APKE (e referuar më pas si “Asambleja Konsultative e Këshillit të Evropës”) miratoi një projekt-Konventë për garancinë kolektive të të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, e cila ishte pararendëse e Konventës.

2. Këshilli i Evropës, “Doracaku i anëtarëve, Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës”, janar 2015, faqe 8.

Kohët e fundit, një raport i APKE për trafikimin e paligjshëm të organeve njerëzore u kurorëzua me miratimin e Konventës së Këshillit të Evropës kundër Trafikimit të Organeve Njerëzore (CETS No. 216), e cila, pasi të hyjë në fuqi, do të jetë instrumenti i parë ndërkombëtar ligjorisht detyrues në këtë fushë. Për më tepër, hetimet e Asamblesë, të udhëhequra nga senatori Dick Marty i Zvicrës, nxorën në pah një “rrjetë merimange” globale të ndalimeve të paligjshme dhe transferimeve ndërshtetërore sekrete e të paligjshme të të ndaluarve në Evropë nga Agjencia Qendrore e Inteligjencës e Shteteve të Bashkuara (CIA), duke hedhur kështu dritë në këtë kapitull të errët të historisë evropiane për të ndihmuar dhe për t’u siguruar që qeveritë evropiane të mos jenë më asnjëherë bashkëpunëtore në tortura.

## Komisioni i Ministrave

Komisioni i Ministrave (KM) është organi statutor ligjvënës i Këshillit të Evropës. Ai përbëhet nga ministrat e punëve të jashtme të shteteve anëtare. Komisioni mbledhet në nivel ministror një herë në vit dhe çdo javë mbledhet në nivelin e zëvendës ministrave (Përfaqësues të Përhershëm në Këshillin e Evropës). Sipas Konventës, KM është organi që ka përgjegjësinë kryesore për mbikëqyrjen e ekzekutimit të gjykimeve. Për këtë qëllim, zëvendës ministrat zhvillojnë të ashtuquajturat takime për të Drejtat e Njeriut (DNJ) katër herë në vit.

## Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore ose Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (Konventa) është një traktat ndërkombëtar, sipas të cilit shtetet kontraktuese marrin përsipër të sigurojnë të drejta themelore civile dhe politike për të gjithë brenda juridiksionit të tyre. Konventa, e cila u nënshkruar në 4 nëntor 1950 në Romë, hyri në fuqi në vitin 1953. Të drejtat dhe liritë e siguruara nga Konventa dhe protokollet e saj përfshijnë të drejtën e jetës, të drejtën e një gjykimi të drejtë, të drejtën e respektimit të jetës private dhe familjare, lirinë e shprehjes, lirinë e mendimit, ndërgjegjes dhe besimit fetar si dhe mbrojtjen e pronës. Konventa ndalon, në veçanti, torturën dhe trajtimin ose dënimin çnjerëzor ose poshtëruar, punën e detyruar, ndalimin arbitrar dhe të paligjshëm dhe diskriminim në gëzimin e të drejtave dhe lirive të garantuara nga Konventa.

## Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut

Gjykatë ndërkombëtare e ngritur në vitin 1959 dhe me qendër në Strasburg, Francë, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Gjykata) merr vendime mbi kërkesat individuale dhe shtetërore që pretendojnë shkelje të të drejtave të përcaktuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe protokollet e saj. Që nga viti 1998, ajo ka funksionuar si gjykatë e përhershme me kohë të plotë, ku individët mund të aplikojnë drejtpërdrejt. Gjykata përbëhet nga 47 gjyqtarë profesionistë me kohë të plotë, të zgjedhur nga Asambleja Parlamentare për një mandat nëntëvjeçar të pa të drejtë rizgjedhjeje.

### **Efektet e vendimeve gjyqësore të Gjykatës së Strasburgut në sistemin kombëtar**

Gjykata merr vendime mbi aplikimet individuale ose shtetërore që pretendojnë shkelje të të drejtave të përcaktuara në Konventë. Në pothuajse pesëdhjetë vjet, Gjykata ka dhënë më shumë se 10 000 vendime gjyqësore. Ndërkohë që këto janë detyruese vetëm midis palëve që janë pjesë e procedurës, të gjitha shtetet palë duhet të marrin parasysh praktikën gjyqësore të Gjykatës kundër vendeve të tjera.

Vendimet gjyqësore janë “në thelb me natyrë deklaruese”, që do të thotë që Gjykata zakonisht nuk përcakton mënyrën se si një shtet i paditur duhet të vërë në praktikë konstatimin e një shkeljeje. Në mënyrë të veçantë, Gjykata nuk mund të hedhë poshtë ligjet dhe politikat kombëtare që janë të papajtueshme me Konventën dhe është përgjegjësi e shtetit që të vendosë se si do ta vërë në praktikë një vendim gjyqësor, nën mbikëqyrjen e Komisionit të Ministrave dhe me anë të masa individuale dhe/ ose të përgjithshme. Vendimet e Gjykatës së Strasburgut kanë bërë që shtetet të ndryshojnë legjislacionin, praktikën e tyre administrative dhe gjyqësore në një gamë të gjerë fushash.<sup>3</sup>

3. Për shembuj të përzgjedhur se si individë nga e gjithë Evropa dhe më gjerë kanë përfituar nga Konventa dhe praktikat gjyqësore të Gjykatës, shihni Këshillin e Evropës (2016), Ndikimi i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në shtetet palë - Shembujt e përzgjedhur, Strasburg, Botim i Këshillit të Evropës (i disponueshëm gjithashtu si një dokument informacioni mbi Komisionin për Çështjet Ligjore dhe të Drejtat e Njeriut, DoK. [AS/Jur/Inf \(2016\) 04](#), 8 janar 2016.



## Kapitulli 1

# Cili është qëllimi i këtij udhëzuesi

**Q**ëllimi i këtij udhëzuesi është ndërgjegjësimi i parlamentarëve brenda Këshillit të Evropës për detyrat dhe mundësitë që ekzistojnë për të mbrojtur dhe realizuar të drejtat e njeriut, si pjesë e angazhimit të tyre ndaj vlerave të demokracisë, të drejtave të njeriut dhe sundimit të ligjit.

Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës ka theksuar<sup>4</sup> në mënyrë të vazhdueshme që, nën parimin e subsidiaritetit, vendet anëtare janë para së gjithash përgjegjëse për zbatimin efektiv të normave ndërkombëtare të të drejtave të njeriut të cilat i kanë nënshkruar vullnetarisht, veçanërisht ato që janë përcaktuar në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe se ata duhet të bashkëpunojnë me organet e Këshillit të Evropës për këtë qëllim.

Në [Rezolutën e saj 1787 \(2011\)](#) Asambleja, me propozim të Komisionit mbi Çështjet Ligjore dhe të Drejtat e Njeriut, ka shkuar deri aty sa të theksojë se nëse parlamentet kombëtare nuk marrin përsipër një rol më proaktiv në zbatimin e standardeve të Konventës dhe vendimeve gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, roli kryesor i Konventës, mekanizmi i tij mbikëqyrës dhe Këshilli i Evropës në tërësi, për garantimin e mbrojtjes efektive të të drejtave të njeriut në Evropë, ka gjasa të vihet në rrezik.

4. Shihni veçanërisht, [Rezolutën 1823 \(2011\)](#), "Parlamentet Kombëtare: garantuesit e të drejtave të njeriut në Evropë", të ribotuar në Shtojcën 2 të këtij manuali.

Detyrimi për të mbrojtur dhe realizuar të drejtat e njeriut varet nga të gjitha degët e shtetit, qoftë ekzekutive, gjyqësore apo legjislativ. Parlamentet kombëtare kanë në mënyrë të veçantë pozicion shumë të mirë për të marrë përsipër këtë përgjegjësi të përbashkët për shkak të tre roleve të tyre kryesore të përfaqësimit, legjislacionit dhe mbikëqyrjes.

Si përfaqësues të zgjedhur, parlamentarët gëzojnë një legjitimitet të veçantë demokratik. Si institucioni kryesor përfaqësues i shtetit, parlamenti mund dhe duhet të përdori legjitimitetin e tij demokratik për të nxitur një kulturë gjithëpërfshirëse të respektimit të të drejtave të njeriut brenda një demokracie që mbështetet nga sundimi i ligjit. Kjo është veçanërisht e rëndësishme kur ka mungesë konsensusi për të drejtat. Në të gjitha shtetet, mund të ketë mosmarrëveshje të arsyeshme që lidhen me fushën e të drejtave të veçanta, për mënyrën se si duhet të balancohen të drejtat e individëve përkundrejt të drejtave të shoqërisë në një shkallë më të gjerë dhe përligjja e ndërhyrjes së shtetit në të drejtat e njeriut. Një debat i tillë është legjitim. Megjithatë, ai gjithmonë duhet të bëhet brenda kornizës së respektimit të detyrimeve të të drejtave të njeriut nga shteti, si në të drejtën kombëtare ashtu edhe në atë ndërkombëtare - dhe ç'është më e rëndësishmja, respektimi i organeve kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare ekzistuese që monitorojnë përmbushjen e këtyre detyrimeve nga ana e shteteve.

Si ligjvënës, parlamentarët kanë mundësinë të sigurojnë që të merren masat për të parandaluar shkelje, dhe që mjete juridike praktike dhe efektive të jenë të disponueshme në nivelin e brendshëm ndaj pretendimeve për shkelje të të drejtave të njeriut. Parlamentet mund të kenë gjithashtu nevojë për legjislacion në mënyrë që të jepen efektet në gjykimet e kundërta të Gjykatës, ose vendimet e organeve të tjera ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, veçanërisht kur ato nxjerrin në pah probleme strukturore ose të sistemit, dhe alokojnë buxhetin e duhur për ta bërë këtë.

Një funksion tjetër i parlamenteve është të mbikëqyrë ekzekutivin; në kontekstin e Këshillit të Evropës, parlamentet mund dhe duhet t'i bëjnë presion organeve ekzekutive që të justifikojnë veprimet ose mosveprimet e tyre për sigurimin e pajtueshmërisë me Konventën, përfshirë gjykimet e Gjykatës.

Duke ushtruar funksionet e tyre përfaqësuese, legjislativ dhe mbikëqyrëse në nivel kombëtar, parlamentarët kontribuojnë në forcimin e efikasitetit dhe legjitimitetit të perceptuar të sistemit të mbrojtjes së të drejtave të njeriut të Konventës Evropiane, pjesë thelbësore e të cilës janë vetë.

Megjithatë, mbrojtja dhe realizimi i të drejtave të njeriut nuk është vetëm detyrim për parlamentet brenda Këshillit të Evropës; ajo gjithashtu paraqet mundësi. Duke interpretuar, zbatuar dhe monitoruar të drejtat e njeriut në kontekstin e tyre kombëtar, parlamentarët kontribuojnë në zhvillimin e një kuptimi të përbashkët të standardeve të të drejtave të njeriut në të gjithë kontinentin e Evropës. Siç shpjegohet në 6.3., ku legjislati kombëtar formohet nga një diskutim i mirë-informuar dhe i sigurtë mbi implikimet e tij për të drejtat e njeriut, ka më shumë të ngjarë që t'i rezistojë çdo kontrolli të ardhshëm për pajtueshmërinë me standardet e të drejtave të njeriut; në këtë kuptim, parlamentet mund të "fitojnë" respektin e organeve rajonale dhe ndërkombëtare të të drejtave të njeriut duke i kryer detyrat për të drejtat e njeriut me përgjegjësi të plotë. Për më tepër, sistemet e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, siç është Konventa, veprojnë si korrigjuese të gabimeve dhe padrejtësive që madje edhe demokracitë funksionale mund t'i kryejnë; për pasojë ato forcojnë, dhe nuk e dëmtojnë besimin e publikut në kredencialet demokratike të vendimmarrësve kombëtar.

Ky manual aftëson parlamentarët brenda Këshillit të Evropës që të përmbushin detyrimet dhe të shfrytëzojnë mundësitë e përshkruara më lart. Ai sintetizon të mësuarit nga përvoja e parlamenteve e vendeve anëtare si të vjetra edhe atyre më të reja se si të zhvillojnë dhe mbajnë marrëveshje institucionale efektive për mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave të njeriut. Në veçanti, trajton strukturat, funksionet dhe metodat e punës që lejojnë parlamentet të verifikojnë në mënyrë më efektive përputhshmërinë e projekt-legjislatit me standardet e Konventës dhe të monitorojnë zbatimin e gjykimeve të Gjykatës së Strasburgut.

Ka shumë potencial të paplotësuar që parlamentet të bëhen garantues të të drejtave të njeriut në Evropë. Ky manual mbështet parlamentarët që ta zhbllokojnë këtë potencial, dhe me anë të tij të ndërtojnë shoqëri të përkushtuara dhe të afta të përkrahin vlerat e të drejtave të njeriut, demokracisë dhe sundimit të ligjit.



## Kapitulli 2

# Çfarë detyrimesh kanë parlamentarët për të drejtat e njeriut?

**A** ngazhimi parlamentar me çështje të të drejtave të njeriut, ndërmarrë me mirëbesim, nxit promovimin dhe realizimin e të drejtave të njeriut. Ky kapitull paraqet prova të njohjes në rritje të kësaj premise (2.1.), para diskutimit të tre dimensioneve të detyrimeve për të drejtat e njeriut (2.2.)

### 2.1. Rritja e vetëdijes që parlamentarët janë garantues të të drejtave të njeriut

” Roli i Parlamenteve në të ardhmen e Gjykatës është thelbësor... Roli juaj si ligjvënës është jetik.

*Sër Nicolas Bratza, ish kryetari i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut<sup>5</sup>*

Në bazë të nenit 1 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, shtetet palë marrin përsipër të sigurojnë për gjithkënd nën juridiksionin e tyre të drejtat dhe liritë e përcaktuara në Konventë. Me ratifikimin e Konventës dhe protokolleve të saj, shtetet vetë angazhohen të sigurojnë që ligji dhe praktika e tyre e brendshme të jetë në përputhje me Konventën dhe të ofrojnë mjete juridike efektive për këdo që beson se të drejtat që u jep Konventa janë shkelur. Kur diskutohet për detyrën e “shtetit” për të respektuar dhe promovuar të drejtat e njeriut, është e rëndësishme të theksohet se “shteti” nuk është një entitet unitar ose monolit - ai është i përbërë nga aktorë dhe institucione të ndryshme, të cilat nëpërmjet fuqisë së tyre relative dhe bashkëveprimeve, përcaktojnë nëse dhe në çfarë mase, janë mbështetur standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Parlamenti është një nga institucionet dhe ka një njohje në rritje - si brenda ashtu edhe përtej Evropës - që parlamentet kanë një detyrë, ashtu si

5. Sër Nikolas Bratza, “E Ardhmja e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut – roli i parlamenteve kombëtare”, Konferenca Evropiane e Kryetarëve të Parlamentit, 20-21 shtator 2012, [Seancat/Aktet](#), faqe 12.

ekzekutivi dhe gjyqësori, të sigurojnë që shteti të respektojë detyrimet e tij për të drejtat e njeriut.

Vitet e fundit është vënë re një përpjekje e përbashkët për të shfrytëzuar më mirë potencialin e parlamentarëve për t'u bërë garantues të të drejtave të njeriut në kontekstin e tyre të brendshëm. Organe të ndryshme të Këshillit të Evropës kanë nënvizuar përgjegjësinë e përbashkët të parlamentarëve për të nxitur zbatimin e Konventës - "zbatimi" kuptohet si nocion i gjerë që përfshin jo vetëm ekzekutimin efektiv të vendimeve të kundërta të dhëna kundër shtetit, por edhe një sërë masash (përfshirë legjislacionin, vendimet gjyqësore, veprimet administrative, dekretet ekzekutive dhe të tjera) për t'i përfshirë në mënyrë të vendosur standardet e Konventës në rendin e brendshëm ligjor dhe në vendimmarrjen politike.

Një mënyrë për të siguruar përputhjen me Konventën është që shtetet të integrojnë në mënyrë proaktive, në tërësinë e saj në ligjin e tyre të brendshëm, praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, duke konsideruar parimet e zhvilluara nga Gjykata, madje edhe për çështjet kundër shteteve të tjera. Ndërkohë që vendimet e Gjykatës janë vetëm juridikisht detyruese ndërmjet palëve për një çështje të caktuar, shtetet mund dhe duhet që në radhë të parë të shmangin që shkeljet e të drejtave të njeriut të ndodhin, duke korrigjuar në mënyrë proaktive situata të ngjashme me ato që Gjykata ka konstatuar në kundërshtim me Konventën, në vende të tjera. Nxjerrja e mësimave nga shkeljet e Konventës të bëra nga shtete të tjera, dhe në këtë mënyrë përkrahja e autoritetit interpretues (res interpretata) të praktikës gjyqësore të Gjykatës, lejon që shtetet të shmangin vendime të kundërta nga Strasburgu.<sup>6</sup>

Brenda Këshillit të Evropës, Asambleja Parlamentare ka qenë më e prerë - për shembull në [Rezolutën 1823 \(2011\)](#) - në thirrjen që iu ka bërë parlamentarëve që të përmbushin detyrimin e tyre për të promovuar realizimin e të drejtave të njeriut.

---

6. Shikoni, për shembull, [Deklaratën Interlaken](#), konferencë e nivelit të lartë: "E ardhmja e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut", 19 shkurt 2010, Pika B., paragrafi 4.c); "Forcimi i subsidiaritetit: integrimi i praktikës gjyqësore të Gjykatës së Strasburgut në ligjin kombëtar dhe praktikën gjyqësore", kontributi i Komisionit për Çështjet Ligjore dhe të Drejtat e Njeriut të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës në Konferencën mbi Parimin e subsidiaritetit, Shkup, 1- 2 tetor 2010, Dok. [AS/Jur/Inf \(2010\) 04](#); Komiteti Drejtues për të Drejtat e Njeriut (CDDH), "Raport mbi të ardhmen më afatgjatë të sistemit të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut" (miratuar në mbledhjen e 1246 të Zëvendës Ministrave, 3 shkurt 2016), Dok. [CM\(2015\)176-add1final](#), paragrafët 37-39.

” Kuadri Kushtetues, i cili përfshin Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, nuk mund të merret kurrë si i mirëqenë. Parlamentarët kanë përgjegjësi të mëdha.

*Anne Brasseur, ish Presidente e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës<sup>7</sup>*

” [A]sambleja u kërkon parlamenteve kombëtare të përdorin potencialin e tyre për të mbikëqyrur zbatimin e standardeve të Konventës, duke përfshirë edhe mbikëqyrjen e ekzekutimit të gjyqimeve të Gjykatës në nivel kombëtar. Përsërit thirrjet e tij të mëparshme ... që ato shtete anëtare të cilat nuk e kanë bërë akoma këtë duhet të hartojnë mekanizma dhe procedura të dedikuara për të shqyrtuar nëse legjislacioni është në përputhje me standardet e Konventës, dhe për të siguruar një mbikëqyrje efektive të zbatimit të vendimeve të Gjykatës.

*Rezoluta e APKE 2055 (2015)*

Thirrjet e Asamblesë për një rol më dinamik të parlamenteve në mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave të njeriut janë përsëritur nga organet e tjera të Këshillit të Evropës, veçanërisht Komisioneri për të Drejtat e Njeriut dhe Gjykata.

” Do të vazhdoj përpjekjet për të ndihmuar qeveritë të krijojnë më shumë politika që përputhen me të drejtat e njeriut, do të mbështes mbrojtësit e të drejtave të njeriut dhe strukturat kombëtare të të drejtave të njeriut dhe do të rris ndërgjegjësimin për çështjet e të drejtave të njeriut në fjalë, dhe kam nevojë për ndihmën tuaj: Unë kam nevojë për ndihmën e parlamentarëve për të përhapur mesazhin për të drejtat e njeriut dhe për të kërkuar zgjidhje bashkëpunuese.

*Nils Muižnieks, ish Komisioner i Këshillit të Evropës për të Drejtat e Njeriut<sup>8</sup>*

- 
7. AKPE, “59 kryetarët e parlamenteve që do të mblidhen për Samitin e Oslo-s”, *njoftim për shtyp* lëshuar me rastin e një konference të Kryetarëve të Parlamentit nga vendet anëtare të Këshillit të Evropës, si dhe vendet fqinje dhe vëzhguese, e organizuar nga Parlamenti i Norvegjisë filluar) në Oslo më 11 dhe 12 shtator 2014.
  8. AKPE, “Seancë e zakonshme e vitit 2016 (pjesa e dytë), procesverbali, seanca e njëmbëdhjetë, e hënë 18 prill 2016 në ora 3.00 p.m.”, *Dok. AS (2016) CR 11*.

” Përmes miratimit të legjislacionit, parlamentet kombëtare kanë një përgjegjësi kryesore për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në kontekstin kombëtar. Roli i vetëm i dhënë zyrtarisht nga Konventa për parlamentet kombëtare është indirekt, përmes kompetencës së Asamblesë Parlamentare, të përbërë nga delegacione të parlamentarëve kombëtarë, për të zgjedhur gjyqtarët e Gjykatës. Sidoqoftë, parlamentet kombëtare kanë role të tjera të rëndësishme për të luajtur në sistem, të tilla si shqyrtimi i përputhshmërisë së të gjitha veprimeve qeveritare me standardet e Konventës dhe përfshirja e tyre në rritje në ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës.

*Komiteti Drejtues për të Drejtat e Njeriut (CDDH)<sup>9</sup>*

Dy konferenca të nivelit të lartë, për më tepër, panë që qeveritë evropiane njohin nevojën e organeve ekzekutive për të lehtësuar këtë aspekt të punës së parlamenteve, siç reflektohet në [Deklaratën e Brajtonit](#) të prillit 2012 dhe, veçanërisht, [Deklaratën e Brukselit](#) të marsit 2015.

### **KB bën thirrje për përfshirje më të madhe parlamentare në çështjet e të drejtave të njeriut**

Në nivelin e Kombeve të Bashkuara (KB), si Asambleja e Përgjithshme dhe disa nga organet që monitorojnë zbatimin e traktateve të KB për të drejtat e njeriut (të njohura si organe monitoruese të traktateve), kanë nënvizuar rëndësinë e demokratizimit të shtetit të së drejtës dhe të drejtave të njeriut duke forcuar rolin e politikanëve të zgjedhur.

Këshilli i KB për të Drejtat e Njeriut iu referua në vitin 2015 rolit thelbësor që parlamentet luajnë, ndër të tjera, në përkthimin e angazhimeve ndërkombëtare në politika dhe ligje kombëtare, dhe kështu do të kontribuojnë në përmbushjen nga secili Shtet Anëtar i Kombeve të Bashkuara e detyrimeve dhe angazhimeve të tij për të drejtat e njeriut dhe për forcimin e shtetit të së drejtës.<sup>10</sup>

9. CDDH, “Raport mbi të ardhmen afatgjatë të sistemit të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut” (shënimi 6), paragrafi 52.

10. Këshilli i KB për të Drejtat e Njeriut, “Kontributi i parlamenteve në punën e Këshillit të të Drejtave të Njeriut dhe rishikimi i tij periodik universal”, [A/HRC/30/L.23](#), 29 shtator 2015.

Në mënyrë të ngjashme, Komiteti për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave ka theksuar se:

“Parlamenti, si një organ që përfaqëson popullsinë në tërësi, pasqyron larminë e mendimit dhe interesave në vend për shkak të qasjes së tij të privilegjuar për të gjithë popullsinë. Si i tillë, parlamentarët mund të jenë aktorët kryesorë në sensibilizimin e Konventës [Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave] dhe Protokollin e saj për popullatën në përgjithësi dhe për gratë në veçanti.”<sup>11</sup>

## 2.2. Detyrimet e Parlamentarëve për të ndërmarrë veprime pozitive

E drejta ndërkombëtare bashkëkohore pranon se përgjegjësia e shteteve - përfshirë parlamentet - për të mbështetur dhe zbatuar të drejtat ndërkombëtare të njeriut ka tre dimensione:

- ▶ detyrimi për të respektuar do të thotë që shtetet duhet të përmbahen nga ndërhyrja ose kufizimi i gëzimit të të drejtave të njeriut;
- ▶ detyrimi për të mbrojtur kërkon që shtetet të mbrojnë individë dhe grupe kundër abuzimeve të të drejtave të njeriut nga subjekte të ndryshme nga vetë shteti;
- ▶ detyrimi për të përmbushur do të thotë që shtetet duhet të ndërmarrin veprime pozitive për të lehtësuar gëzimin e të drejtave themelore të njeriut.

Detyrimi për të respektuar kryesisht nënkupton detyrime negative, duke kërkuar që shtetet të mos ndërhyjnë në të drejtat e individëve pa arsyetim, d.m.th. shteti duhet të përmbahet nga akte të caktuara. Në të kundërt, një detyrim pozitiv - i përfshirë brenda detyrimeve për të mbrojtur dhe përmbushur - kërkon që shtetet të ndërmarrin veprime specifike parandaluese ose mbrojtëse për të siguruar të drejtat e Konventës. Pothuajse çdo e drejtë e parashikuar në Konventë mund të sjellë detyrime të caktuara pozitive.

Shtetet duhet të marrin masa për të garantuar gëzimin efektiv të të drejtave nga individët, edhe nëse shkelja kërcënohet ose ka ndodhur prej një individi

11. për më shumë informacion, shihni tek Asambleja e Përgjithshme e KB, “Raportin e Komitetit për eliminimin e diskriminimit ndaj grave”, A/65/38, Shtojca VI, Deklaratë e Komisionit për eliminimin e diskriminimit ndaj grave për marrëdhëniet e tij me parlamentarët, fq. 143.

ose entiteti privat, dhe jo nga një agjent i shtetit. Kjo shpesh do të kërkojë rregulla legjislative (për shembull, miratimin e dispozitave për të kriminalizuar vrasjen dhe torturën), administrative (siç është vendosja e rregullores së mjedisit për të mbrojtur njerëzit nga ndotja serioze), dhe veprimet procedurale (veçanërisht hetimet efektive për shkeljet e të drejtave themelore, dhe sjelljen e autorëve të krimeve para drejtësisë). Këto detyrime pozitive duhet të përmbushen nga të gjitha autoritetet shtetërore - përfshirë parlamentin.<sup>12</sup>

### **Legjislacioni për të forcuar mbrojtjen nga dhuna me bazë gjinore**

Për të sjellë legjislacionin e tij në përputhje me Konventën e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (CETS Nr. 210, e ashtuquajtura “Konventa e Stambollit”), Gjermania reformoi ligjin e saj që shqyrton shkeljet seksuale. Në korrik 2016, Bundestagu gjerman miratoi një [ligj](#) që kodifikon atë që është njohur si parimi i “Jo do të thotë Jo”, duke e bërë çdo akt seksual jo konsensual një vepër të dënueshme. Legjislacioni i ri u vlerësua si një hap i rëndësishëm drejt forcimit të mbrojtjes së grave nga dhuna me bazë gjinore. Gjermania ratifikoi Konventën e Stambollit më 12 tetor 2017.

Nevoja për krijimin e një kuadri të fuqishëm legjislativ që mundëson të gjitha autoritetet shtetërore të kryejnë detyrimet e tyre pozitive për të drejtat e njeriut nënvizon rëndësinë e veprimit të vendosur parlamentar. Duke pasur parasysh rolin e tyre kryesor në ligj-bërje, të gjithë parlamentarët duhet të shtojnë zërin e tyre për ata që e kanë njohur dhe përsëritur detyrën e tyre për t’u bërë garantues të të drejtave të njeriut. Kapitulli në vijim do të shqyrtojë mjetet dhe funksionet që parlamentarët mund të përfitojnë në mënyrë që t’i ndihmojnë ata të përmbushin detyrimet e tyre për të drejtat e njeriut.

---

12. Për një klasifikim më të detajuar të llojeve të ndryshme të detyrimeve pozitive që Gjykata ka njohur, shiko Laurens Lavrysen (2016). Të drejtat e njeriut në një gjendje pozitive: rishikimi i marrëdhënies midis detyrimeve pozitive dhe negative sipas Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Kembrixh, Intersentia.



### Kapitulli 3

# Detyrat e parlamentarëve për përmbushjen e detyrimeve ndaj të drejtave të njeriut

” Parlamentarët mund të marrin një rol shumë më aktiv duke u kërkuar llogari qeverive të tyre mbi zbatimin e gjyqimeve duke krijuar komisione të posaçme për rishikim, duke mbajtur seanca dëgjimore, duke ndarë fonde për masat e zbatimit dhe duke propozuar legjislacionin përkatës.

*Nils Muižnieks, ish Komisioneri i Këshillit të Evropës për të Drejtat e Njeriut<sup>13</sup>*

**M**eqenëse parlamentet ndajnë me ekzekutivin dhe gjyqësorin detyrimin për të mbrojtur dhe realizuar të drejtat e njeriut, lind pyetja se si parlamentarët duhet ta përmbushin këtë përgjegjësi. Ky kapitull shqyrton funksionet e ndryshme të parlamenteve për të drejtat e njeriut në rolin e tyre si ligjvënës dhe si organi kryesor që mbikëqyr ekzekutivin për çështje që lidhen me të drejtat e njeriut dhe sundimin e ligjit (3.1.). Për më tepër, këtu do të diskutohet se çfarë duhet të kërkojnë parlamentarët nga ekzekutivi në mënyrë që të sigurohen që ata janë në gjendje të kryejnë rolet e tyre legjislative dhe mbikëqyrëse në mënyrë efektive (3.2.).

13. Këshilli i Evropës, *Raporti i veprimtarisë vjetore të 2016* nga Nils Muižnieks, Komisioneri i Këshillit të Evropës për të Drejtat e Njeriut, Dok. [CommDH \(2017\) 3](#), 6 prill 2017, faqe 8.

Duhet theksuar fakti që përmbajtja e këtij kapitulli është e rëndësishme për të gjithë parlamentarët, pasi që të gjithë kanë detyrimin dhe mundësinë për të mbrojtur dhe realizuar të drejtat e njeriut, edhe pse, siç u diskutua në Kapitullin 4, mund t'i caktohen funksione specifike një komisioni për të drejtat e njeriut ose një nën-komisioni brenda parlamentit.

### 3.1. Funksionet e parlamentarëve për të drejtat e njeriut

Asambleja Parlamentare ka identifikuar, në [Rezolutën 1823 \(2011\)](#), një sërë funksionesh që parlamentarët duhet të kryejnë si garantues të të drejtave të njeriut. Këto përfshijnë funksione që mund të parandalojnë shkeljet e të drejtave të njeriut, siç është verifikimi sistematik i përputhshmërisë së projekt-legjislacionit me standardet e Konventës dhe funksionet që sigurojnë mbikëqyrje rigoroze të organeve ekzekutive dhe administrative kur bëhet fjalë për zbatimin e normave të të drejtave të njeriut dhe vendimeve gjyqësore të Gjykatës Evropiane të Drejtave të Njeriut.

Ashtu siç theksoi Asambleja në [Rezolutën 2178 \(2017\)](#), duke pasur parasysh implikimet buxhetore të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, një mjet kryesor, që u mundëson parlamenteve përmbushjen e secilës prej këtyre funksioneve për të drejtat e njeriut, është ndarja e burimeve të përshtatshme për miratimin e masave të duhura për respektimin, mbrojtjen dhe përmbushjen e të drejtave që janë marrë përsipër të sigurohen nga shteti.

” Së pari dhe më e rëndësishme nga të gjitha është fakti që [parlamentet] bëjnë ligje, që do të thotë se ato miratojnë ligje që qeverisin shoqërinë. Kjo përfshin miratimin ose autorizimin e miratimit të traktateve ndërkombëtare dhe garantimin që normat e përcaktuara në ato traktate janë përkthyer në ligjet kombëtare dhe zbatohen. Së dyti, ata miratojnë buxhetin dhe përcaktojnë prioritetet e politikës kombëtare. Në lidhje me këtë, ata duhet të mundësojnë sigurimin e fondeve të mjaftueshme për zbatimin e të drejtave të njeriut dhe se këto fonde janë përdorur në mënyrë të duhur. Së treti, ata mbikëqyrin veprimtarinë e ekzekutivit dhe e mbajnë atë nën kontroll, për t'u siguruar që qeveria, administrata dhe organet e tjera shtetërore po respektojnë detyrimet për të drejtat e njeriut. Së katërti, anëtarët e parlamentit janë udhëheqës të mendimit dhe mund të ndihmojnë duke kontribuar në një kulturë të të drejtave të njeriut në vendin e tyre.

*Christos Pourgourides, ish relator i APKE për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut<sup>14</sup>*

14. “Parlamentet kombëtare: garantuesit e të drejtave të njeriut në Evropë”, Dok. 12636 (raportues: Z. Christos Pourgourides, Qipro), paragrafi 20.

## Shqyrtimi i projekt - legjislacionit për pajtueshmërinë e të drejtave të njeriut

Një funksion kryesor i parlamentarëve për të drejtat e njeriut është shqyrtimi sistematik i projekt-legjislacionit për të kontrolluar pajtueshmërinë e tij me të drejtat e njeriut. Ky mund të jetë një funksion sfidues, veçanërisht kur propozimet legjislative janë publikuar në një agjendë pune të shpejtë, e cila mund të mos u lërë kohë të mjaftueshme organeve parlamentare të të drejtave të njeriut, si për shqyrtimin e implikimeve të të drejtave të njeriut ashtu edhe për raportimin në parlament për çdo ndryshim të kërkuar. Volumi i madh i projekt-legjislacionit gjithashtu mund të paraqesë një sfidë duke pasur parasysh kohën dhe burimet e kufizuara të parlamentarëve.

Ekzistojnë dy mënyra kryesore për lehtësimin e këtyre problemeve. Së pari, parlamentarët duhet t'i kërkojnë ekzekutivit të bashkëngjisë një memorandum të hollësishëm për të drejtat e njeriut në secilën pjesë të legjislacionit të propozuar, duke shpjeguar se pse qeveria mendon se është në përputhje me të drejtat e njeriut ose duke theksuar ndonjë papajtueshmëri të mundshme. Kjo diskutohet më tej në 3.2

Së dyti, parlamentarët mund të zgjedhin t'u japin përparësi për shqyrtim të hollësishëm atyre propozimeve legjislative që ata mendojnë se kanë implikime më të rëndësishme për të drejtat e njeriut dhe sundimin e ligjit.

### Shqyrtimi legjislativ nga Komisioni i Përbashkët për të Drejtat e Njeriut në Mbretërinë e Bashkuar<sup>15</sup>

Përmes shqyrtimit të tij legjislativ, Komisioni i Përbashkët për të Drejtat e Njeriut (KPDNJ) në Parlamentin e Mbretërisë së Bashkuar synon:

Të paralajmërojë të dy Dhomat e Parlamentit për rastet ku ekziston rreziku që ata të miratojnë ligje në mënyrë të papajtueshme me të drejtat e Konventës ose me të drejtat e traktateve të tjera ndërkombëtare të të drejtave të njeriut me të cilat [Mbretëria e Bashkuar] është palë, si dhe të informojë Parlamentin për çështje të tjera të të drejtave të njeriut të ngritura nga legjislacioni, përfshirë këtu edhe rastet kur legjislacioni ka gjasa të përmirësojë promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut në Mbretërinë e Bashkuar ose kur nuk e ka shfrytëzuar mundësinë për të vepruar në këtë mënyrë.

15. Komisioni i Përbashkët për të Drejtat e Njeriut (2006), *Praktikat e ardhshme të punës së Komisionit*, Raporti i Njëzet e tretë i Sesionit 2005-2006, paragrafët 18-49.

Në vitet e para të tij, KPDNJ u përpoq të shqyrtojë të gjitha propozimet legjislativë për implikimet dhe pajtueshmërinë e tyre me të drejtat e njeriut. Megjithatë, komiteti, në vitin 2006, vendosi që t'u japë përparësi për shqyrtim të hollësishëm propozimeve legjislativë që kanë gjasa të ngrenë çështje të rëndësishme të të drejtave të njeriut, me qëllim përmirësimin e aksesit, afatit kohor dhe vlerës së përgjithshme të punës së tij për sa i përket shqyrtimit legjislativ. Këshilltarët ligjorë të KPDNJ shqyrtojnë të gjitha masat e shpallura në programin vjetor legjislativ të qeverisë dhe këshillojnë komisionin për çdonjërin prej tyre që mund të ngrejë çështje të rëndësishme të të drejtave të njeriut, bazuar në kriteret kryesore të mëposhtme:

- sa i rëndësishëm është ndikimi te e drejta?
- sa e dëmshme është ndërhyrja?
- sa i fortë është justifikimi për ndërhyrjen?
- sa njerëz ka të ngjarë të preken nga ajo?
- sa të cënueshëm janë njerëzit e prekur?
- deri në çfarë mase janë zbatuar detyrimet më kryesore pozitive të shtetit?

Anëtarët e KPDNJ-së e marrin parasysh këtë këshillë duke vendosur se cilat propozime legjislativë do të shqyrtojnë në detaje dhe do të raportojnë në parlament. Komisioni më pas bën të ditur propozimet që priten të kenë prioritet për t'u shqyrtuar nga ana legjislativë në seancë dhe bën kërkesë për paraqitjen e provave për çështjet në fjalë.

## Në përgjigje të vendimeve gjyqësore për të drejtat e njeriut:

”Parlamentet kombëtarë mund dhe duhet t'i detyrojnë qeveritë të japin llogari për zbatimin jo të duhur ose të ngadaltë të vendimeve të Gjykatës së Strasburgut, për shembull, duke zhvilluar debate dhe seanca dëgjimore dhe duke shtruar pyetje parlamentare. Mbi të gjitha, ato duhet të ndikojnë në drejtimin dhe përparësinë e nismave legjislativë dhe - kur është e përshtatshme - të autorizojnë fondet e nevojshme për të siguruar zbatimin e standardeve të Konventës.

*Anne Brasseur, ish Kryetare e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës<sup>16</sup>*

16. Këshilli i Evropës, Drejtorja e Përgjithshme e të Drejtave të Njeriut dhe Sundimi i Ligjit, “Zbatimi i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut: përgjegjësia jonë e përbashkët”, Konferencë e nivelit të lartë e organizuar në Bruksel, Belgjikë, në datat 26-27 mars 2015 nga Kryesia Belge e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës, [fjalimi i hapjes](#) nga Anne Brasseur, faqet 21-22.

## Legjislacioni për t'i dhënë forcë ligjore vendimeve për të drejtat e njeriut

Kur origjina e një shkelje të të drejtave të njeriut të identifikuar nga Gjykata ka të bëjë me një ligj me të meta, roli i parlamentarëve në legjislacionin është i domosdoshëm për të korrigjuar shkeljen. Kjo merr rëndësi të veçantë kur problemi me ligjin në fjalë mund të bëhet shkak për parashtrimin e kërkesave të shumta në Gjykatë.

### **Franca: nxjerrja e ligjeve për të dekriminalizuar fyerjen ndaj kreut të shtetit**

Pas çështjes *Eon kundër Francës* (Kërkesa Nr. 26118/10, vendimi i datës 14 mars 2013), në të cilën u gjetën shkelje të së drejtës për lirinë e shprehjes së një aktivisti politik sipas nenit 10 të Konventës, për shkak të ndjekjes së tij penale për fyerje ndaj presidentit sepse kishte ngritur lart një pankartë satirike, parlamenti francez shfuqizoi krimin e fyerjes ndaj kreut të shtetit. Presidenti sot gëzon të njëjtën mbrojtje si ministrat dhe deputetët kundër shpifjeve dhe deklaratave me shkrim për shpifje. Megjithatë, procedimi ligjor për fyerje ose shpifje mund të paraqitet vetëm nga personi në fjalë dhe jo nga prokurori.<sup>17</sup>

### **Greqia: nxjerrja e ligjeve për t'u dhënë njohje ligjore çifteve të të njëjtit seks**

Në dhjetor 2015, parlamenti grek miratoi një projekt-ligj të ri të partneritetit civil, i cili lejon çiftet e të njëjtit seks të hyjnë në një partneritet civil, duke siguruar kështu njohjen ligjore dhe zgjerimin e të drejtave të caktuara, siç janë të drejtat e trashëgimisë, për çiftet e të njëjtit seks. Ky ligj rregulloi një situatë ku çiftet e të njëjtit seks ishin të përjashtuar nga fushëveprimi i një ligji të mëparshëm, i cili kishte krijuar një formë të partneriteteve të regjistruara, por e rezervonte atë për çifte të seksit të kundërt. Gjykata arriti në përfundimin se kjo përbënte diskriminim në çështjen Vallianatos dhe të Tjerët kundër Greqisë [GC] (Kërkesa Nr. 29381/09 dhe 32684/09, Vendimi gjyqësori i Dhomës së Madhe të datës 7 nëntor 2013).<sup>18</sup>

## Monitorimi i përgjigjes së ekzekutivit ndaj gjykimeve

Mbikëqyrja e veprimit ekzekutiv - ose mosveprimi - mbi çështjet e të drejtave të njeriut është një funksion thelbësor i parlamenteve. Asambleja Parlamentare

17. Shihni Këshillin e Evropës, *Ndikimi i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në shtetet palë - Shembuj të zjedhur* (shënimi 3), faqe 13 e dokumentit të informacionit të APKE-ës.

18. Po aty, faqe 17.

u ka kërkuar në mënyrë të veçantë parlamentarëve që të mbikëqyrin hapat e ndërmarrë nga autoritetet kompetente kombëtare për të zbatuar gjykimet e kundërta të Gjykatës (*Rezoluta 1823 (2011)*). Disa organe parlamentare për të drejtat e njeriut kanë krijuar metoda sistematike të monitorimit mbi përgjigjen e ekzekutivit ndaj vendimeve gjyqësore, të cilat mund të përfshijnë kërkimin e provave dhe raportimin në parlament për sa i përket përshtatshmërisë dhe afatit kohor të zbatimit.

Qeveritë duhet ta lehtësojnë këtë funksion të rëndësishëm të parlamenteve për të drejtat e njeriut duke shpërndarë rregullisht dhe në kohën e duhur informacione me parlamentin – konkretisht, përmes (të paktën me anë të) raportimit vjetor ku ekzekutivi i raporton parlamentit mbi përgjigjen e bërë më parë për vendimet gjyqësore të të drejtave të njeriut dhe ndarjen në të njëjtën kohë të planeve të veprimit dhe raporteve të veprimit kur ato paraqiten në Komisionin e Ministrave, siç është diskutuar në seksionin 3.2.

### **Monitorimi i zbatimit të vendimeve gjyqësore - shembulli i Lituanië<sup>19</sup>**

Në Lituani, që prej vitit 2010, Komisioni për Zbatimin e Ligjit dhe Seimas-i (parlamenti) organizon takime të zgjeruara dy herë në vit për të diskutuar zbatimin e vendimeve gjyqësore të Gjykatës. Një monitorim i tillë kryhet gjithashtu edhe nga Komisioni për të Drejtat e Njeriut të Seimas, para të cilit paraqet një raport vjetor nga punonjësi qeveritar. Që nga viti 2016, përfshirja e Seimas në procesin e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore është institucionalizuar. Kryetari i Komisionit të Ligeve dhe Komisionit të Zbatimit të Ligjit regjistroi një ligj që plotëson Statutin e Seimas me dispozita të cilat parashikojnë se njëri nga aktivitetet e komisionit është mbikëqyrja e ekzekutimit të vendimeve të Gjykatës.

### **Monitorimi i zbatimit të gjyqësor kundër Mbretërisë së Bashkuar<sup>20</sup>**

Si pjesë e monitorimit të rregullt të zbatimit të vendimeve të Gjykatës, KPDNJ bashkëpunon me organe të tjera institucionale të të drejtave të njeriut. Një rast i tillë është koordinimi midis KPDNJ-së dhe Rishikuesit të Pavarur të Legjislacionit të Terrorizmit (Rishikuesi i Pavarur) në shqyrtimin

19. Komisioni Drejtues për të Drejtat e Njeriut (KDDNJ), "Udhëzues për praktikën e mira për zbatimin e Rekomandimit (2008) 2 të Komitetit të Ministrave mbi kapacitetet e efektshme vendase në ekzekutimin e shpejtë të vendimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut" (miratuar nga KDDNJ në mbledhjen e saj të 87-të, datat 6-9 qershor 2017), *KDDNJ (2017) Shtojca R87 I*, 13 korrik 2017, paragrafi 97 iv.

20. Shihni Alice Donald dhe Philip Leach (2016). *Parlamentet dhe Gjykatat Evropiane e të Drejtave të Njeriut*, Oksford, Oxford University Press, faqet 234-35.

e tyre përkatës të përgjigjes së qeverisë ndaj *Gillan dhe Quinton kundër Mbretërisë së Bashkuar* (Kërkesa Nr. 4158/05, 12 janar 2010), i cili kishte të bënte me përdorimin e kompetencave për të ndaluar dhe kërkuar individë pa një bazë dyshimi të arsyeshëm sipas Aktit të Terrorizmit të vitit 2000. Gjykata kishte konstatuar se ligji përmbante masa mbrojtëse të pamjaftueshme për të mbajtur nën kontroll pushtetin e zgjeruar që i ishte dhënë ekzekutivit, në kundërshtim me të drejtën e respektimit të jetës private sipas nenit 8 të Konventës. Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar i zëvendësoi dispozitat që kishin shkelje me pushtete të reja e të kufizuara; megjithatë, si KPDNJ dhe Rishikuesi i Pavarur i raportuan parlamentit duke rekomanduar reforma të mëtejshme, pasi liria e veprimit që u ishte dhënë oficerëve mbeti shumë e gjerë për të hequr rrezikun e arbitraritetit. Në vitin 2012, u bënë ndryshime të mëtejshme për të përmbushur shqetësimet kryesore të ngritura nga KPDNJ dhe Rishikuesi i Pavarur.

## Monitorimi i vendimeve gjyqësore kundër shteteve të tjera

Asambleja Parlamentare ka deklaruar se parlamentarët duhet të monitorojnë jo vetëm vendimet gjyqësore kundër shteteve të tyre, por edhe vendimet kundër shteteve të tjera, në mënyrë që ata të jenë në gjendje të identifikojnë nëse po i njëjti problem ekziston në ligjin dhe politikën e tyre dhe të ndërmarrin hapa për ta korrigjuar atë. Duke vepruar në këtë mënyrë, parlamentet respektojnë atë që njihet si autoriteti interpretues i Gjykatës (shikoni 2.1.).

Në praktikë, parlamentet priren të mbështeten te ekzekutivi për të monitoruar dhe raportuar mbi çështjet gjyqësore kundër shteteve të tjera, pasi parlamentarët që punojnë nën presion të fortë nuk kanë aftësinë që të investojnë në një detyrë jashtëzakonisht të ndërlikuar e që kërkon shumë kohë. Qeveritë e Holandës, Gjermanisë dhe Zvicrës raportojnë rregullisht në parlamentet e tyre përkatëse në lidhje me vendimet gjyqësore kundër shteteve të tjera që kanë implikime në rendin e brendshëm ligjor (shikoni 3.2.). Megjithatë, Asambleja Parlamentare minimalisht kërkon që organet parlamentare të njohin me saktësi autoritetin interpretues të Gjykatës dhe të shqyrtojnë përshtatshmërinë e sistemeve ekzekutive për monitorimin e vendimeve gjyqësore kundër shteteve të tjera dhe të raportojnë në parlament mbi çdo vendim që ka rëndësi në kontekstin e tyre kombëtar.

### Marrja e hapave proaktivë për të luftuar trafikimin e qenieve njerëzore

Një shembull i parlamenteve që ndryshojnë ligjet e tyre në përgjigje të një vendimi gjyqësor kundër një shteti tjetër mund të gjendet pas çështjeve të *Siliadin kundër Francës* (Kërkesa Nr. 73316/01, 26 korrik 2005) dhe *C.N. dhe V. kundër Francës* (Kërkesa Nr. 67724/09, 11 tetor 2012). Në këto raste,

Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut pohoi se Franca kishte dështuar në përmbushjen e detyrimeve të saj pozitive dhe në sigurimin e mbrojtjes konkrete dhe efektive të kërkuesve, të cilët ishin të mitur të pambrojtur nga puna e detyruar si shërbyes shtëpiakë. Në përgjigje të këtyre vendimeve, një numër i caktuar parlamentesh të shteteve anëtare të Këshillit të Evropës - midis tyre Parlamenti i Mbretërisë së Bashkuar - miratuan ligje që forcojnë mbrojtjen kundër trafikimit të qenieve njerëzore që synohen të shfrytëzohen për punë.

## Negocimi, miratimi dhe zbatimi i traktateve të tjera për të drejtat e njeriut

Në shumicën e vendeve, miratimi parlamentar është i domosdoshëm që shteti të jetë në gjendje të miratojë ose të ratifikojë një traktat rajonal ose ndërkombëtar për të drejtat e njeriut. Rrjedhimisht, parlamentet kanë rol kritik në formimin e detyrimeve për të drejtat e njeriut të cilat shteti merr përsipër t'i respektojë. Asambleja Parlamentare dhe Unioni Ndër-Parlamentar u kanë bërë thirrje parlamentarëve kombëtarë për një përfshirje më të madhe në negocimin e instrumenteve rajonale dhe ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, pasi në fund të fundit janë ata që duhet të miratojnë legjislacionin përkatës dhe të sigurojnë zbatimin e tij.<sup>21</sup>

Parlamentarët duhet të ndërhyjnë shumë më përpara se të fillojë faza e miratimit dhe të marrin pjesë, së bashku me përfaqësuesit e qeverisë, në hartimin e instrumenteve të reja brenda organeve diskutuese ndërkombëtare. Ata duhet gjithashtu, në këtë kontekst, të shqyrtojnë rigorozisht çdo rezervë (të propozuar) ose deklaratë interpretuese për një marrëveshje ndërkombëtare dhe të rishikojnë rregullisht nëse është (akoma) e përligjur.<sup>22</sup>

Brenda Këshillit të Evropës, anëtarët e Asamblesë Parlamentare janë të përfshirë drejtpërdrejt në formimin e përmbajtjes së instrumenteve të reja të të drejtave të njeriut. Komisioni për Çështjet Ligjore dhe të Drejtat e Njeriut, që efektivisht është "këshilltari ligjor" i Asamblesë, ftohet rregullisht nga Komiteti i Ministrave për të dhënë mendime për projekt - traktatet. Komisioni sjell kështu në tryezën e bisedimeve zërin e parlamentarëve kombëtarë, me pak fjalë, pikërisht ata

21. Dok. 12636 (shënimi 14), paragrafët 31-32; Unioni Ndër-Parlamentar (2016), *Të Drejtat e Njeriut - Doracak për parlamentarët Nr. 26*, Gjenevë, Zyra UNP / KB të Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut, faqet 95-96.

22. Rezerva është paralajmërim për pranimin e një traktati nga ana e një shteti: shteti bën një deklaratë të njëanshme ku nënshkruan, ratifikon, pranon, miraton ose bie dakord për një traktat, me anë të të cilit ai synon të përjashtojë ose ndryshojë efektin ligjor të disa dispozitave të traktatit gjatë zbatimit të tyre në atë shtet. Një deklaratë interpretuese, ndryshe nga një rezervë, nuk synon të përjashtojë ose ndryshojë efektet ligjore të një traktati, por të sqarojë kuptimin e disa dispozitave ose të të gjithë traktatit.

persona që do të kenë për detyrë të miratojnë legjislacionin zbatues dhe, përtej kësaj, do të kenë për detyrë mbikëqyrjen e pajtueshmërisë së shtetit me traktatin duke verifikuar (hartuar) legjislacionin për pajtueshmërinë e tij me standardet e përcaktuara në traktat; do të ngarkohen të mbikëqyrin raportimin e qeverisë të organet që monitorojnë zbatimin e instrumenteve të ndryshme; dhe do të ngarkohen me rekomandimet vijuese të bëra nga ato organe monitoruese.

### **Përfshirja parlamentare në hartimin dhe zbatimin e Konventës së Stambollit**

Sfondi historik i Konventës së Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje ("Konventa e Stambollit") ofron një shembull të shkëlqyeshëm të përfshirjes së gjerë parlamentare në shtjellimin dhe promovimin e një traktati ndërkombëtar. Asambleja Parlamentare ka qenë prej kohësh një zë i fuqishëm për barazinë gjinore dhe kundër dhunës me bazë gjinore. Një "grup i parlamentarëve të kontaktit" dha një kontribut të rëndësishëm në fushatën e Këshillit të Evropës për Ndalimin e dhunës ndaj grave (2006 - 2008), gjatë së cilës Asambleja bëri shprehimisht thirrje (në [Rezolutën 1635](#) dhe [Rekomandimin 1847 \(2008\)](#)) për miratimin e standardeve evropiane ligjërisht të detyrueshëm mbi dhunën ndaj grave.<sup>23</sup> Parlamentarët kanë rritur ndërgjegjësimin për këtë çështje, duke organizuar ndër të tjera debate parlamentare dhe seanca dëgjimore mbi dhunën ndaj grave dhe duke bërë deklarata publike. Asambleja pati gjithashtu përfaqësues gjatë takimeve të Komitetit Ad Hoc për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (CAHVIO), i ngritur nga Komiteti i Ministrave në vitin 2008 dhe i ngarkuar me hartimin e Konventës së Stambollit. Që nga momenti i hapjes së Konventës për nënshkrim në vitin 2011, anëtarët e Rrjetit Parlamentar për Gratë e Mbrojtura nga Dhuna kanë lobuar, brenda parlamenteve të tyre përkatëse, për nënshkrimin, ratifikimin dhe zbatimin efektiv të Konventës së Stambollit.

23. Shihni gjithashtu Këshillin e Evropës, "Raporti Shpjegues i Konventës së Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje"; Letizia Seminara (2014). "Konventa e Këshillit të Evropës për parandalimin dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje", në T. Natoli (ed.), *Scritti in memoria di Maria Rita Saulle*, Napoli, Editoriale Scienta, 1487-1503, faqe 1488; dhe Dubravka Šimonović (2014). "Standardet globale dhe rajonale mbi dhunën ndaj grave: evolucioni dhe sinergjia e Konventave të CEDAW dhe të Stambollit", Vëllimi i të Drejtave të Njeriut botuar çdo tre muaj 36 (3), f. 590-606, faqe 603.

Për më tepër, Konventa e Stambollit është instrumenti i parë dhe i vetëm ndërkombëtar që mundëson përfshirjen parlamentare në procedurën e monitorimit. Kjo përfshirje është e dyfishtë: në nivelin kombëtar, parlamentet do të marrin pjesë në monitorimin e masave të marra për zbatimin e konventës; në nivelin e Këshillit të Evropës, Asambleja Parlamentare do të ftohet të shqyrtojë rregullisht konventën.

## Hetimi i problemeve të të drejtave të njeriut

Parlamentarët janë në pozicionin e duhur për të kryer hetime mbi çështjet aktuale të të drejtave të njeriut, kur ka probleme të pajtueshmërisë së shtetit me detyrimet kombëtare ose ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Rrjedhimisht, parlamentarët janë në gjendje të “përcaktojnë agjendën” për çështjet e të drejtave të njeriut në shtetin e tyre.

Parlamentarët, dhe veçanërisht organet parlamentare për të drejtat e njeriut, duhet të hartojnë një metodologji për zgjedhjen e temave që do t’u nënshtrohen hetimeve, në mënyrë që të sigurohen që po kryejnë hetime vetëm në rastet kur ata janë në pozicionin e duhur ligjor për të dhënë një kontribut të rëndësishëm në mbledhjen e provave ose rritjen e mirëkuptimit publik për këtë çështje, duke marrë parasysh punën e komiteteve dhe organeve të tjera parlamentare, siç janë institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut (IKDNJ), organizatat joqeveritare (OJQ-të) dhe organizatat ndërkombëtare.

### Kryerja e hetimeve në Parlamentin e Mbretërisë së Bashkuar

Komisioni i Përbashkët për të Drejtat e Njeriut kryen rregullisht hetime mbi temat që zgjedh vetë. Përzgjedhja e temave bazohet në punën e kryer nga KPDNJ për sa i përket shqyrtimit legjislativ, gjyqimeve për të drejtat e njeriut dhe monitorimin e traktateve, përveç konsultimeve me shoqërinë civile dhe grupet e interesuara. Sipas ish këshilltarit kryesor ligjor të komisionit, Murray Hunt, hetimet janë “aktivitete për vlerësimin e nivelit të përputhshmërisë së Mbretërisë së Bashkuar me detyrimet e saj përkatëse për të drejtat e njeriut në një fushë të caktuar të politikave dhe për identifikimin e gjërave që duhet të bëhen për të përmbushur standardet minimale përkatëse ose për të përmbushur më mirë çdo detyrim pozitiv për të cilin shteti ka marrë angazhim”.<sup>24</sup>

24. Murray Hunt (2013). “Komiteti i Përbashkët për të Drejtat e Njeriut”, në A. Horne, G. Drewry dhe D. Oliver (redaktorë), *Parlamenti dhe Ligji*, Oksford, Botimet “Hart”, faqe 241.

Gjatë hetimeve, komiteti mbledh prova duke dëgjuar në seanca dëgjimore dëshmitarët dhe duke kryer vizita. Provat me gojë dhe me shkrim publikohen në faqen e internetit të KPDNJ-së. Si shembull, në vitet 2015-16, KPDNJ kreu një hetim mbi politikën e qeverisë për përdorimin e droneve për vrasje të shënjestruar, duke vlerësuar ndër të tjera pajtueshmërinë e tij me detyrimet e shtetit sipas ligjit ndërkombëtar të të drejtave të njeriut, përfshirë këtu edhe Konventën.<sup>25</sup> Përmes rekomandimeve të tjera, komiteti i kërkoi qeverisë që të sqaronte bazën ligjore për politikën e ndjekur prej saj në përdorimin e forcës vdekjeprurëse jashtë vendit kundër terroristëve të dyshuar, madje edhe jashtë konflikteve të armatosura, si mjet i fundit, nëse plotësohen kushte të caktuara. Afati kohor i këtij hetimi ishte i qartë për shkak të faktit se, pothuajse në të njëjtën kohë, përdorimi i droneve për vrasje të shënjestruar ishte objekt i një raporti të paraqitur nga Asambleja (shihni [Rezolutën 2051 \(2015\)](#) dhe [Rekomandimin 2069 \(2015\)](#)).

### 3.2. Si duhet të mundësojë ekzekutivi që parlamentarët të kryejnë funksionet e tyre për të drejtat e njeriut?

Megjithëse detyrimet për të drejtat e njeriut varen nga të gjitha degët e shtetit, janë qeveritë ato që përfaqësojnë shtetin para organeve rajonale dhe ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Kjo do të thotë se qeveritë, efektivisht, janë “rojet” e informacionit. Si rrjedhim, parlamentarët duhet t’i japin udhëzime të hollësishme ekzekutivit për mënyrën se si synojnë të përmbushin detyrimin për mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave të njeriut - dhe çfarë kërkojnë specifikisht nga ekzekutivi në mënyrë që të mund ta kryejnë këtë rol mbikëqyrës.

Këshilli i Evropës u ka kërkuar qeverive që ta lehtësojnë punën e parlamentit për të drejtat e njeriut në mënyra të ndryshme.<sup>26</sup> Këto lidhen kryesisht me detyrimin e qeverive për të lehtësuar shqyrtimin parlamentar të pajtueshmërisë së legjislacionit të propozuar për të drejtat e njeriut dhe të raportojnë rregullisht në parlament për zbatimin e vendimeve gjyqësore për të drejtat e njeriut. Me këto mënyra, qeveritë mund të përfshijnë parlamentet në një dialog transparent rreth zbatimit, duke reflektuar përgjegjësinë e tyre të përbashkët për mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave të njeriut.

25. Komiteti i Përbashkët për të Drejtat e Njeriut (2016), *Politika e qeverisë për përdorimin e droneve për vrasje të shënjestruar*, Raporti i dytë i seancës 2015-16.

26. Shih Konferencën e nivelit të lartë: “Zbatimi i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, përgjegjësia jonë e përbashkët”, *Deklarata e Brukselit*, 27 mars 2015, paragrafët B.2.a, B.2.h, B.2.f, B.2.j; APKE *Rezoluta 1823 (2011)*, (shënimi 4), Shtojcë, paragrafi 1.

## Lehtësimi i shqyrtimit parlamentar të legjislacionit

Siç vërehet në 3.1., funksion thelbësor i parlamenteve është shqyrtimi sistematik i akteve qeveritare mbi pajtueshmërinë e tyre me të drejtat e njeriut. Faktor i rëndësishëm në procesin e shqyrtimit legjislativ është cilësia e informacionit të dhënë nga qeveria, e cila duhet të shpjegojë pse një projektligj konsiderohet që është në përputhje me të drejtat e njeriut - ose, në rrethana të jashtëzakonshme, pse pranon që një projektligj mund të mos jetë në përputhje me të drejtat e njeriut por gjithsesi e lejon të kalojë. Është argumentuar se cilësia e informacionit të dhënë nga qeveria është “faktori i vetëm më i rëndësishëm” që përcakton efikasitetin e punës së shqyrtimit legjislativ të KPDNJ-së.<sup>27</sup>

Parlamentet, dhe komitetet për të drejtat e njeriut në veçanti, duhet të kërkojnë të krijohet një praktikë, përmes së cilës ekzekutivi bashkëngjit një memorandum të hollësishëm për të drejtat e njeriut për çdo pjesë të legjislacionit të propozuar. Kjo praktikë ka avantazhin shtesë të “integritit” të vlerësimeve të të drejtave të njeriut brenda ekzekutivit, pasi ministrat dhe nëpunësit civilë ndërgjegjësohen se propozimet legjislative duhet të kalojnë një shqyrtim të hollësishëm parlamentar mbi pajtueshmërinë e tyre me të drejtat e njeriut, dhe në këtë mënyrë ka më shumë gjasa ta kalojnë shqyrtimin gjyqësor nëse në të ardhmen kundërshtohen.<sup>28</sup>

## Raportimi dhe shkëmbimi i informacionit me parlamentarët

### Raportet vjetore

Kur nga ekzekutivi bëhet raportim sistematik në parlament, zakonisht shoqërohet me një raport vjetor - i përgatitur ose nga ministria përgjegjëse (zakonisht e Drejtësisë ose e Punëve të Jashtme) ose nga agjenti qeveritar - mbi vendimet e kundërta të Gjykatës dhe hapat e ndërmarrë nga ekzekutivi për zbatimin e tyre.

Një formë raportimi zhvillohet, midis të tjerash, në Belgjikë, Bullgari, Kroaci, Republikën Çeke, Danimarkë, Estoni, Finlandë, Francë, Gjermani, Itali, Letoni, Lituania, Mali i Zi, Holanda, Polonia, Rumania, Republikën Sllovaqe, Suedi dhe Mbretërinë e Bashkuar.<sup>29</sup>

27. Murray Hunt, “Komiteti i Përbashkët për të Drejtat e njeriut” (shënimi 24), faqe 229.

28. Brian Chang dhe Graeme Ramshaw (2016). *Forcimi i aftësive parlamentare për mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave të njeriut: raporti i sintezës*. Londër Fondacioni për Demokraci, Westminster. faqe 16.

29. CDDH “Udhëzues për praktikën e mirë” (shënimi 19), paragrafi 93; dhe Divizioni i Mbështetjes së Projektit Parlamentar (PPSD), Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës, “Roli i parlamenteve në zbatimin e standardeve të ECHR: përmbledhje e strukturave dhe mekanizmave ekzistues - Memorandumi bazë”, Dok. *PPSD (2016) 19*, 2 nëntor 2016, Seksioni 2.

## Kroacia<sup>30</sup>

Në 2013, agjenti qeveritar u thirr nga parlamenti për të paraqitur një raport në lidhje me çështjen e përfaqësimit të Republikës së Kroacisë në procedurat gjyqësore dhe për ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës. Parlamenti mori raportin e parë në tetor 2013 dhe, sipas një rregulloreje të re, agjenti qeveritar duhet t'i raportojë të paktën një herë në vit Qeverisë Kroate dhe Parlamentit.

## Mbretëria e Bashkuar

Në vitin 2011, qeveria nisi përpilimin e një raporti vjetor për t'iu përgjigjur gjyqësorëve për të drejtat e njeriut, siç kërkohet nga Komiteti i Përbashkët për të Drejtat e Njeriut që nga viti 2008.<sup>31</sup> Në lidhje me Gjykatën, raporti përfshin seksione mbi qasjen e përgjithshme të Mbretërisë së Bashkuar ndaj zbatimit të vendimeve të Strasburgut dhe përditësimet mbi ekzekutimin e gjyqësorëve specifike. Në vitin 2015, KPDNJ rekomandoi që të shndërrohet në një raportim më të gjerë vjetor të të drejtave të njeriut në parlament, duke përfshirë jo vetëm përgjigjet ndaj gjyqësorëve për të drejtat e njeriut, por edhe raportimin e Mbretërisë së Bashkuar pranë organeve të monitorimit të traktatit të KB dhe zhvillimeve më të gjera të të drejtave të njeriut.<sup>32</sup>

Për më tepër, në mënyrë ideale, raportet vjetore duhet të identifikojnë gjyqësorët kundër shteteve të tjera që kanë implikime për ligjin ose politikën në kontekstin e brendshëm, siç ndodh në Republikën Çeke, Gjermani dhe Holandë.

## Gjermani

Ministria gjermane e Drejtësisë i ka raportuar Vendimet e Gjykatës çdo vit që nga viti 2004 si Komitetit për të Drejtat e Njeriut dhe Ndihmës Humanitare, edhe Komisionit për Çështjet Ligjore dhe Mbrojtjen e Konsumatorit.<sup>33</sup> Fillimisht, raporti përfshinte gjyqësorët dhe vendimet kundër Gjermanisë. Që nga viti 2007, ka mbuluar zbatimin e gjyqësorëve. Që nga viti 2010, është

30. DMPP, "Roli i parlamenteve në zbatimin e standardeve të KEDNJ" (shënimi 29), faqe 8.

31. Për më të fundit, shihni Ministrinë e Drejtësisë në Mbretërinë e Bashkuar (2016), *Në përgjigje të gjyqësorëve për të drejtat e njeriut – Raporti në Komitetin e Përbashkët për të Drejtat e Njeriut për përgjigjen e qeverisë ndaj gjyqësorëve për të drejtat e njeriut 2014-16*.

32. JCHR, *Në përgjigje të gjyqësorëve për të drejtat e njeriut (shënimi 31)*, 11 mars 2015, paragrafi 6.8.

33. Për më të fundit, shihni Bundesministerium der Justiz und für Verbraucherschutz (pa datë), "Bericht über die Rechtsprechung des Europäischen Gerichtshofs für Menschenrechte und die Umsetzung seiner Urteile in Verfahren gegen die Bundesrepublik Deutschland im Jahr 2016."

përgatitur gjithashtu një raport vjetor i veçantë që mbulon gjykimet kundër shteteve të tjera, të cilat kanë implikime të mundshme për Gjermaninë.<sup>34</sup> Nuk ka asnjë procedurë të zyrtarizuar parlamentare në përgjigje të këtyre raporteve. Komisionet parlamentare mund ta vendosin në agjendën e tyre për diskutim (megjithëse kjo nuk bëhet rregullisht) dhe mund të thërrasin përfaqësuesit e qeverisë për pyetje.

## Holanda

Në Holandë, një raport i qeverisë për gjykimet e kundërta nisi në 1996 me kërkesë të Dhomës së Përfaqësuesve të Holandës. Që nga viti 2006, raporti përfshin informacione mbi zbatimin e gjyqimeve, dhe që nga viti 2009 ai përfshin informacione për gjyqime kundër vendeve të treta të cilat kanë implikime të menjëhershme për ligjin ose politikën Holandeze. Që nga viti 2010, ka përfshirë përditësime në lidhje me vendimet që janë arsyetuar të papranueshme nga Gjykata për çështjet Holandeze. Nga 2013, raporti ka pasur një sferë më të gjerë, duke përfshirë të gjitha procedurat ndërkombëtare të të drejtave të njeriut në lidhje me Holandën, përfshirë Komitetin Evropian të të Drejtave Sociale dhe organet e traktateve të Kombeve të Bashkuara.<sup>35</sup>

Raportet vjetore mund të jenë shumë të rralla për t'i mundësuar parlamentit të ketë ndikim mbi përgjigjen ekzekutive të gjyqimeve në "kohë reale"; megjithatë, mekanizma të tillë raportimi ofrojnë disa përfitime të rëndësishme:

- ▶ raportimi i rregullt nga ekzekutivi krijon regjistrin publik për përgjigjet e shtetit ndaj gjyqimeve për të drejtat e njeriut, i cili informon jo vetëm parlamentin, por edhe organet e tjera të tilla si institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut (IKDNJ-të) dhe shoqërinë civile;
- ▶ mekanizmat e raportimit mund t'i shtyjnë qeveritë të sistemojnë bashkërendimin brenda degës ekzekutive, duke rritur kështu efikasitetin e procesit të ekzekutimit. Një proces i tillë gjithashtu mund të nxjerrë në pah problemet që ndodhin, për shembull kur agentit qeveritar i mungon "statusi politik" i kërkuar për të ndikuar ose marrë informacion nga ministrinë;

34. Për më të fundit, shihni Christoph Grabenwarter me Anna Katharina Struth dhe Markus Vašek (pa datë), [Bericht über die Rechtsprechung des Europäischen Gerichtshofs für Menschenrechte in Verfahren gegen andere Staaten als Deutschland im Jahr 2016](#)".

35. Për më të fundit, shihni Ministrinë e Punëve të Jashtme (Divizioni i së Drejtës Ndërkombëtare) (2017), [Rapportage 2016: Internationale Menschenrechtenprocedures](#).

- ▶ Thjesht “**parashikimi i shqyrtimit**” mund të mobilizojë organet ekzekutive për të vepruar në mënyrë që të parandalojnë kritikën parlamentare ose atë më të gjerë të publikut; dhe
- ▶ në raportimin afatmesëm dhe afatgjatë, raportimi i rregullt ekzekutiv mund të ketë efektin e dobishëm që të normalizojë ekzekutimin e procesit dhe **parandalojë politizimin e tij të padrejtë**.

Për këto arsye, dhe në përputhje me thirrjet nga Asambleja Parlamentare, parlamentet kombëtare duhet të kërkojnë raportime të tilla të rregullta nga ekzekutivi, aty ku nuk ekzistojnë aktualisht.

## Ndarja e planeve të veprimit dhe raporteve të veprimit

Planet e veprimit dhe raportet e veprimit u prezantuan nga Komiteti i Ministrave në 2004 dhe janë futur në procesin e mbikëqyrjes që nga viti 2009. Në të dyja procedurat e mbikëqyrjes, si ato standarde edhe të përmirësuarat, të Komitetit të Ministrave,<sup>36</sup> shteteve u kërkohet të paraqesin një plan ose raport veprimi pas një vendimi të kundërt jo më vonë se gjashtë muaj nga data në të cilën aktgjykimi bëhet i formës së prerë.<sup>37</sup>

**Deklarata e Brukselit** përshkruan planet dhe raportet e veprimit si mjete kryesore në dialogun midis Komitetit të Ministrave dhe shteteve, të cilat gjithashtu mund të kontribuojnë në dialog të zgjeruar me palët e tjera të interesit, përfshirë parlamentet kombëtare. Pasi të paraqiten në Komitetin e Ministrave, planet dhe raportet e veprimit janë dokumente publike, të cilat vihen në dispozicion në bazën e të dhënave **HUDOC-EXEC**. Për më tepër, ato duhet të konsiderohen si dokumente pune, të cilat mund të kenë nevojë të rishikohen ose përditësohen ndërkohë që procesi i zbatimit vazhdon. Kur është e përshtatshme, planet dhe veprimet duhet t’i referohen çdo përfshirjeje parlamentare në zbatimin e një gjykimi, në mënyrë që të sigurohet që Komiteti i Ministrave të ndërgjegjësohet për dimensionin parlamentar.

Ende nuk është bërë praktikë e zakonshme që organet ekzekutive të dërgojnë plane ose raporte veprimi në parlament në të njëjtën kohë që u dorëzohen Komitetit të Ministrave, në mënyrë që stafi parlamentar të mund t’i rishikojë ato dhe në mënyrë selektive të tërheqë vëmendjen e anëtarëve të parlamentit për planet ose raportet e veprimit që meritojnë shqyrtim më të hollësishëm. Franca

36. Komiteti i Ministrave, kur mbikëqyr ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës, miraton një procedurë “procedurë binjake”, bazuar në nivelin e përparësisë së tyre, shiko <https://goo.gl/FG4fgk>.

37. Vendimi bëhet i formës së prerë tre muaj pasi të ketë dalë nga dhoma me shtatë gjyqtarë, përveç rasteve të veçanta, kur i drejtohet Dhomës së Madhe, vendimet e së cilës automatikisht janë të formës së prerë. Dhoma e Madhe, e përbërë nga 17 gjyqtarë, dëgjon raste që përfshijnë çështje serioze që ndikojnë në interpretimin ose zbatimin e Konventës ose me rëndësi të përgjithshme.

dhe Mbretëria e Bashkuar ofrojnë rastet e rralla ku kjo ndodh zakonisht.<sup>38</sup> Kjo praktikë duhet të inkurajohet, pasi shqyrtimi i rregullt parlamentar i planeve dhe raporteve të veprimit jo vetëm që do të lehtësonte monitorimin në kohë të veprimitarisë ekzekutive, por gjithashtu do të kishte avantazhin shtesë të galvanizimit të drejtuesve për përmirësimin e cilësisë dhe afateve të planeve të veprimit dhe raporteve të veprimit që nga fillimi.

## **Përmbledhja, përkthimi dhe shpërndarja e vendimeve dhe dokumenteve të tjera kryesore**

**Deklarata e Brukselit** i nxit qeveritë të promovojnë qasjen ndaj vendimeve të gjykatës, planeve dhe raporteve të veprimit dhe vendimeve dhe rezolutave të Komisionit të Ministrave, duke:

- ▶ bërë botimin dhe shpërndarjen e tyre për palët e interesuara (në veçanti, ekzekutivin, parlamentet dhe gjykatat, dhe gjithashtu, kur është e përshtatshme, për IKDNJ-të dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile), në mënyrë që t'i përfshijnë ata më tej në procesin e ekzekutimit të gjykimeve; dhe
- ▶ përkthyer ose përmbledhur dokumentet përkatëse, përfshirë gjykimet e rëndësishme të Gjykatës, siç kërkohet.

Për më tepër, publikimi dhe shpërndarja e gjykimeve, në pjesën dërrmuese të çështjeve, është një kërkesë e masave të përgjithshme të treguara nga Gjykata.

Respekti për autoritetin interpretues të Gjykatës (shiko 2.1.) gjithashtu nënkupton që qeveritë duhet të përmbledhin dhe/ ose përkthejnë në mënyrë selektive gjykimet kundër shteteve të tjera që kanë implikime në urdhrat e tyre juridikë.

Parlamentet duhet të ushtrojnë shqyrtime për të siguruar ekzekutivi vepron mbi këto detyrime.

### **Përhapja e vendimeve të Gjykatës**

Disa sisteme kombëtare përcaktojnë gjithashtu se si do të përhapen vendimet e Gjykatës; për shembull, në Ukrainë, ekziston një kërkesë ligjore që agjenti qeveritar të ofrojë për botim në dy gazeta zyrtare një përmbledhje të gjykimeve kundër Ukrainës, dhe t'u ofrojë përkthime të plota të gjykimeve avokatit të popullit (komisionerit parlamentar për të drejtat e njeriut), organeve shtetërore, dhe të tjerëve që preken direkt. Disa shtete ofrojnë vendimet e Gjykatës (të përkthyer) në internet, për shembull në faqen e internetit të agjentit qeveritar ose ministrisë përkatëse,

38. CDDH, "Udhëzues për praktikën e mira" (shënimi 19), paragrafi 99.

në intranetin gjyqësor, ose në faqen e internetit të gjykatës(ave) më të lartë. Belgjika, Republika Çeke dhe Spanja kanë krijuar bazën e të dhënave në internet me një motor kërkimi, duke lejuar kërkime për çështje ligji.<sup>39</sup> Një numër gjykimesh janë përkthyer në gjuhë jo zyrtare dhe ofrohen në bazën e të dhënave [HUDOC database](#).<sup>40</sup>

### 3.3. Bërja realitet e përgjegjesisë së përbashkët për të drejtat e njeriut

Siç është vënë re në Kapitullin 1, përgjegjësia për të mbrojtur dhe realizuar të drejtat e njeriut bie mbi të gjitha degët e shtetit - ekzekutivin, legjislativin dhe gjyqësorin. Shtetet kanë zhvilluar mënyra të ndryshme për t'i dhënë formë ligjore ose institucionale këtyre përgjegjësive, në mënyrë që të sigurohen që organet e ndryshme t'i njohin dhe të jenë në gjendje t'i zbatojnë ato, dhe që strukturat dhe proceset për zbatimin e të drejtave të njeriut nuk janë të ndjeshme ndaj dobësimit ose sfidës.

#### Mbrojtja me ligj e rolit të parlamentarëve për të drejtat e njeriut

Parlamentet mund të kontribuojnë në zbatimin e standardeve të të drejtave të njeriut duke miratuar legjislationin i cili përcakton kompetencat dhe detyrat e të gjitha degëve të shtetit - ekzekutivit, legjislativit dhe gjyqësorit - me përgjegjësinë për të siguruar respektimin e vendimeve të Gjykatës. Një legjislation i tillë gjithashtu mund të sqarojë se si konventat rajonale dhe ndërkombëtare për të drejtat e njeriut duhet të zbatohen brenda rendit juridik të brendshëm. Një legjislation i tillë ekziston në Itali, "ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë", Rumani dhe Ukrainë.<sup>41</sup>

Thjesht ekzistenca e një kornize legjislative jo domosdoshmërisht garanton zbatimin e plotë të vendimeve për të drejtat e njeriut. As Asambleja Parlamentare dhe as Komiteti i Ministrave nuk e kanë kthyer në prioritet rekomandimin që shteteve u duhet të miratojnë legjislationin që përcakton se si do të zbatohen vendimet, duke sugjeruar që, ky është kusht jo i domosdoshëm

39. CDDH, "Udhëzues për praktika të mira" (shënimi 19) paragrafi 105. Baza e të dhënave çeke ofrohet në <https://goo.gl/a3UUiA>.

40. Faqe e Gjykatës ofron një seri lidhjesh me koleksione të jashtme të përkthimeve të praktikës gjyqësore të Konventës.

41. Shih DMPP, "Roli i parlamenteve në zbatimin e standardeve të KEDNJ" (shënimi 29), faqet 10 - 11.

dhe jo i mjaftueshëm për forcimin e zbatimit në mungesë të një angazhimi të mirëfilltë politik.<sup>42</sup>

Thënë kështu, rregullimi zyrtar i procesit të zbatimit mund të sjellë disa avantazhe. Për shembull, ai mund të:

- ▶ përcaktojë rolin e parlamentit në procesin e përmbartimit, për shembull duke siguruar raportim sistematik dhe në kohë në parlament, për zbatimin e aktgjykimeve nga ekzekutivi (shiko 3.2.);
- ▶ përcaktojë afatet kohore brenda të cilave do të zbatohen aktgjykimet;
- ▶ sigurojë që agjenti qeveritar ka fuqinë dhe autoritetin e nevojshëm për të marrë informacionet përkatëse; të ndërlidhet me ata që janë përgjegjës në nivel kombëtar për të vendosur për masat e kërkuara për ekzekutimin e një gjykimi; dhe të marrë masat e nevojshme për të përshpejtuar procesin e ekzekutimit - siç kërkohet nga Rekomandimi i Komitetit të Ministrave [CM/Rec\(2008\)2](#); dhe
- ▶ sigurojë që proceset e brendshme për të siguruar pajtueshmërinë e Konventës nuk janë të prekshme nga dobësimi nga njëra administratë në tjetrën.

### **Ligji i zbatimit në “ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë”**

Një ligj për ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës u miratua nga Parlamenti i “ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë” në 2009 (dhe ndryshuar në vitin 2014).<sup>43</sup> Sipas këtij ligji, krijohet një komision ndër-sektorial, i cili mbledhet të paktën çdo tre muaj. Ai përfshin zyrtarë të lartë nga ministritë e drejtësisë, të brendshme, punëve të jashtme dhe të financave. Anëtarët sipas posteve përfshijnë kryetarët e këshillit gjyqësor, Gjykatës së Lartë, Gjykatës Kushtetuese dhe gjykatës më të lartë administrative; Këshilli i Prokurorëve Publikë; avokati i popullit; dhe agjenti qeveritar, bashkë me kryetarët e gjykatave të apelit në Shkup dhe tre qytete të tjera.

42. Për shembull, [Rezoluta 1787 \(2011\)](#), në paragrafin 10.2, rekomandon parlamentet të krijojnë “mekanizma efektivë të brendshëm” për zbatimin e vendimeve të Gjykatës “ose me legjislacion ose ndryshe”.

43. Ligji për Zbatimin e Vendimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Nr. 07–2328/1, 21 maj 2009.

Komisioni harton analiza të vendimeve të Gjykatës; rekomandon masa individuale dhe / ose të përgjithshme për të korrigjuar shkeljet; propozon reformën legjislative; dhe monitoron zbatimin e vendimeve të Gjykatës, në përputhje me afatet e ndryshme të përcaktuara në ligjin e përmbartimit. Komisioni raporton çdo vit pranë Komisionit të Përhershëm Hetimor për Liritë dhe të Drejtat Civile, një nga dy komisionet parlamentare me detyrë të lidhur me të drejtat e njeriut.

## Model novator për të bashkërenduar zbatimin e të drejtave të njeriut

Një risi premtuese është krijimi i një grupi të dedikuar që bashkon institucione dhe individë të shumtë - përfshirë parlamentarët - të cilët kanë për detyrë të sigurojnë zbatimin efikas dhe të plotë të vendimeve të Gjykatës. Mund të krijohen grupe pune për të bashkërenduar zbatimin e vendimeve të veçanta që kërkojnë veprim nga agjenci të shumta.

Ekzistojnë disa avantazhe të mundshme për një marrëveshje të tillë:

- ▶ Ai pasqyron **detyrimin e përbashkët** për të gjitha degët e shtetit për të zbatuar vendimet e Gjykatës dhe ndihmon për të rritur ndërgjegjësimin e të gjithë aktorëve përgjegjës vendas për këto detyrime.
- ▶ Në nivel praktik, diskutimi shumëpalësh ka potencialin **për të nxitur një bashkërendim efektiv dhe “pronësi” kolektive të procesit të zbatimit**. Nga ana tjetër, kjo mund të ndihmojë për të identifikuar dhe kapërcyer pikat e pengesave, të tilla si agjencitë që nuk janë të gatshme ose janë të paafta për të ndër marrë veprimet e kërkuara, dhe të lehtësojnë hartimin e një reforme ligjore dhe politike të mundshme dhe të qëndrueshme. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për gjykime komplekse që kërkojnë një kombinim të veprimeve legjislative, administrative dhe/ ose gjyqësore dhe vendime që kanë mbetur të pa zbatuara për një periudhë të gjatë dhe kërkojnë injektimin e momentumit.
- ▶ Një forum i tillë shumëpalësh ofron një **bashkëbisedues të dobishëm** për Departamentin e Këshillit të Evropës për Ekzekutimin e Vendimeve kur viziton një shtet për të monitoruar zbatimin e gjykimeve, duke e lejuar atë të kuptojë pozicionin e të gjitha palëve të interesuara
- ▶ Një forum i tillë siguron gjithashtu mënyrën efikase **për të kërkuar prova dhe këshilla** nga IKDNJ, shoqëria civile, akademikë dhe profesionistë ligjorë. Kjo mund të ndihmojë për të siguruar që institucionet e ngarkuara me zbatimin janë mbi perspektivën e grupeve, të drejtat e të cilëve janë në rrezik, në një rast të veçantë. Për më tepër, ofron një mundësi që shoqëria

civile të kontribuojë me zgjidhje krijuese ligjore dhe politike në procesin e zbatimit.

- ▶ Një grup pune i dedikuar, i cili bashkon rregullisht autoritetet publike, mund të ketë **efekt parandalues**, pasi mund të ndihmojë në sigurimin e zbatimit të saktë të Konventës në praktikën e përditshme të këtyre autoriteteve, duke kontribuar kështu për një përfshirje të fortë të të drejtave të Konventës në ligjin dhe praktikën kombëtare.

Në mënyrë që këto avantazhe të realizohen, thjesht krijimi i një grupi pune mjafton. Është e rëndësishme që grupi të mbledhet rregullisht, të ndiqet rregullisht nga delegatë të përshtatshëm, të aftë dhe me përvojë; të përfitojë nga ndërlidhja midis agjencive në periudhën ndërmjet takimeve; dhe është i pajisur mirë në mënyrë që, për shembull, takimet të rezultojnë në pika të qarta veprimi të cilat ndiqen në intervale të rregullta.

### **Komiteti i Ekspertëve në Republikën Çeke**

Në vitin 2015, Zyra e Agjentit Qeveritar Çek ngriti Komitetin e Ekspertëve për Ekzekutimin e Vendimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (*Kolegium expertů k výkonu rozsudků ESLP*). Ky është një organ konsultativ i përbërë nga pika qendrore të pozicioneve të larta të të gjitha institucioneve përkatëse - ministrive, parlamentit, Gjykatës Kushtetuese, Gjykatës së Lartë, Gjykatës së Lartë Administrative, Prokurorisë së Përgjithshme, mbrojtësit publik i të drejtave (avokati i popullit), organizatës së profesionistëve ligjorë, akademitë dhe OJQ-të. Roli i komitetit është të diskutojë dhe rekomandojë masa të mundshme (të përgjithshme) me qëllim zbatimin e gjykimeve të kundërta të Gjykatës kundër Republikës Çeke. Komiteti gjithashtu në mënyrë selektive diskuton gjykimet kundër shteteve të tjera ku i njëjti problem parimor ekziston në rendin juridik Çek.

Ky kapitull ka shqyrtuar funksionet e ndryshme të të drejtave të njeriut që të gjithë parlamentarët të kenë mundësinë t'i kryejnë në mënyrë që të sigurohen që të drejtat e njeriut mbrohen dhe realizohen në mënyrë efikase. Parlamentet kanë zgjedhur të zhvillojnë struktura të ndryshme institucionale për të siguruar që këto funksione përmbushen në mënyrë sistematike, dhe janë këto modele institucionale që trajton kapitulli tjetër.



## Kapitulli 4

# Organizimi i duhur i parlamentarëve për përmbushjen e detyrimeve ndaj të drejtave të njeriut

**S**i munden parlamentet kombëtare të mbështesin dhe forcojnë më tej vlerat e të drejtave të njeriut, demokracinë dhe sundimin e ligjit - vlera që ndahen nga parlamentet në të gjithë kontinentin dhe të mishëruara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut? Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës u ka bërë thirrje parlamenteve që të krijojnë struktura të brendshme të përshtatshme që u mundësojnë atyre përmbushjen e detyrimit për të mbrojtur dhe realizuar të drejtat e njeriut dhe për të mbështetur sundimin e ligjit përmes funksioneve të tyre parësore të përfaqësimit, legjisllacionit dhe mbikëqyrjes. Megjithatë, në praktikë, shumë parlamente në Këshillin e Evropës deri më sot nuk kanë krijuar ndonjë strukturë ose proces që siguron përputhje me standardet e Konventës dhe gjykimet e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Të tjerë kanë mekanizma që janë ende në fillimet e tyre, efektiviteti i të cilave pengohet nga mungesa e ekspertizës, burimeve ose vullnetit politik.

Kur ka një shkallë mbikëqyrjeje parlamentare për të drejtat e njeriut, përshtatja institucionale varion sipas tre modeleve kryesore. Këto mund të kategorizohen si:

- ▶ modeli i **specializuar**, në të cilin ekziston një komitet më vete me kompetencë e cila kryesisht ose ekskluzivisht ka të bëjë me të drejtat e njeriut;
- ▶ modeli **ndërsektorial**, në të cilin nuk ka komitet më vete me detyrë që mbulon çështjet e të drejtave të njeriut, të cilat, në momentin që dalin, trajtohen nga komitete të ndryshme brenda mandateve të tyre përkatëse; dhe
- ▶ modeli **hibrid**, në të cilin ekzistojnë më shumë se një komitet me interes të identifikuar për të drejtat e njeriut, dhe/ ose një nën-komitet i specializuar për të drejtat e njeriut që është themeluar brenda një sistemi tjetër të integruar.

Këto kategori nuk janë përcaktuar që të jenë të ngurta; për shembull, ekzistenca e një komiteti të specializuar nuk përjashton - dhe nuk duhet të përjashtojë - konsiderimin e çështjeve të të drejtave të njeriut nga komitetet e tjera. Përkundrazi, kjo tipologji kap gamën e modeleve që janë zhvilluar nga parlamentet, nga një komitet i vetëm kryesor në një qasje pjesërisht ose tërësisht të decentralizuar.

Para se ky kapitull të bëjë prezantimin e këtyre modeleve të ndryshme (4.1.) dhe mënyrave me të cilat të gjithë parlamentarët mund të bëhen garantues të të drejtave të njeriut (4.2.), mund të bëhen disa vërejtje të përgjithshme:

- ▶ APKE ka hequr dorë nga këshillimi i një modeli të vetëm institucional të punës parlamentare për të drejtat e njeriut, dhe në vend të kësaj ka adoptuar një qasje fleksibël për t'u siguruar që strukturat e ngritura janë të përshtatshme për kontekstin e veçantë kombëtar.
- ▶ “Parimet themelore të Asamblesë për mbikëqyrjen parlamentare të standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut” (bashkangjitur Rezolutës 1823 (2011)) përmendin në mënyrë të qartë “komitetet e ngritura për të drejtat e njeriut ose strukturat e duhura analoge”,<sup>44</sup> ndërsa u bëjnë thirrje edhe parlamenteve të ngrënë dhe/ ose të përforcojnë strukturat që do të lejojnë përfshirjen dhe mbikëqyrjen rigorozë të detyrimeve të tyre ndërkombëtare për të drejtat e njeriut”. Në të vërtetë, krijimi i komiteve të dedikuara më vete ka të ngjarë të jetë i pamjaftueshëm për të siguruar efektivitetin e mekanizmave parlamentarë për të drejtat e njeriut.

---

44. Edhe më qartë, Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut rekomandon që “[b]renda Parlamenteve, duhet të themelohen komitetet e duhura të përhershme ose organe të ngjashme dhe ato të përfshihen në monitorimin dhe vlerësimin e nivelit të zbatimit të brendshëm të rekomandimeve, veçanërisht ato që lidhen me reforma legjislative”; shiko Navanethem Pillay (2012). *Forcimi i sistemit të Traktatit të Kombeve të Bashkuara për të drejtat e njeriut. Raport nga Komiteti i Lartë i Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut*, qershor 2012, faqe 85.

## 4.1. Mënyra të ndryshme për të organizuar punën parlamentare për të drejtat e njeriut

### Modeli i komitetit të specializuar

Ndër strukturat që synojnë të garantojnë “ndjekjen dhe monitorimin e detyrimeve ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut, dhe veçanërisht detyrimeve që rrjedhin nga Konventa”<sup>45</sup>, të cilat i kanë krijuar disa shtete anëtare të Këshillit të Evropës, janë komitetet e specializuara për të drejtat e njeriut. Detyrimi i një komiteti të tillë të specializuar (ose nën-komiteti) mund të përfshijë shprehimisht - ose të interpretohet nga komiteti se përfshin - funksione specifike, siç është verifikimi i legjislacionit për respektimin e angazhimeve të brendshme, rajonale ose ndërkombëtare, dhe mbikëqyrja e ekzekutimit të vendimeve të Gjykatës. Sidoqoftë, jo të gjithë e bëjnë këtë dhe prandaj ekzistenca e një komiteti të specializuar nuk tregon domosdoshmërisht që këto funksione kryhen në mënyrë sistematike.

Ndër shtetet që miratojnë modelin e specializuar janë: Shqipëria, Finlanda, Greqia, Hungaria, Letonia, Mali i Zi dhe Mbretëria e Bashkuar.

#### Komiteti i Përbashkët për të Drejtat e Njeriut në Mbretërinë e Bashkuar

Komiteti i Përbashkët për të Drejtat e Njeriut mishëron modelin e komitetit të specializuar për të drejtat e njeriut. Ai filloi punën në 2001 dhe ka 12 anëtarë, të përzgjedhur në mënyrë të barabartë nga të zgjedhurit nga Dhoma e Komunëve dhe kryesisht të emëruarit nga Dhoma e Lordëve. KPDNJ është përpjekur të ketë dy ose tre këshilltarë ligjorë të dedikuar me ekspertizë mbi të drejtat e njeriut të cilët ofrojnë shërbime për anëtarët e saj. Përgjegjësia zyrtare e komitetit është jashtëzakonisht e gjerë, duke përfshirë “çështje që lidhen me të drejtat e njeriut” në Mbretërinë e Bashkuar, duke përfshirë rastet individuale.<sup>46</sup> Komiteti ka interpretuar mandatin e tij në mënyrë të gjerë. Ndër aktivitetet e tjera:

- shqyrton ligjet qeveritare (dhe, kur është e mundur, projektligjet) për përputhshmërinë me të drejtat e njeriut, dhe propozon ndryshime në projektligje në mënyrë që të heqë çdo mospërputhje të identifikuar në raportet e tij. Shqyrtimi legjislativ (ose para-legjislativ) i KPDNJ ndihmohet nga një “memorandum i të drejtave të njeriut” i përgatitur nga departamenti qeveritar përkatës, duke detajuar përputhshmërinë e projekt-ligjit me Konventën dhe detyrimet e tjera ndërkombëtare për të drejtat e njeriut (shiko 3.1.);

45. Rezoluta 2178 (2017), “Zbatimi i gjykimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut”, paragrafi 10.1, dhe Dok. 14340 (relator: Z. Pierre-Yves Le Borgn’), 12 qershor 2017.

46. Shikoni faqen e internetit të KPDNJ në [goo.gl/3js6mB](http://goo.gl/3js6mB).

- zhvillon shqyrtimin e përgjigjes ekzekutive ndaj vendimeve të kundërta të gjykatës në bazë të kriterëve të përcaktuara nga KPDNJ; për shembull kërkesa që qeveria të japë plane të detajuara lidhur me përgjigjen e saj brenda katër muajve dhe të marrë një vendim përfundimtar se si do të korrigjohet mospërputhja brenda gjashtë muajve;
- kryen kërkime tematike për çështje ku ekziston shqetësimi për të drejtat e njeriut, duke kërkuar prova nga një gamë e gjerë grupesh dhe individësh me përvojë dhe interes përkatës; dhe
- monitoron në mënyrë të përzgjedhur përputhshmërinë e Mbretërisë së Bashkuar me detyrimet e saj ndërkombëtare për të drejtat e njeriut në bazë të traktateve të KB për të drejtat e njeriut.

Praktika ekzistuese zbulon një sërë përfitimesh të mundshme të modelit të specializuar:

- ▶ Modeli i specializuar ka të ngjarë të preferohet nga parlamentet që po nxisin mbikëqyrjen e të drejtave të njeriut për herë të parë, ose në shtetet ku ekzekutimi i gjykimeve dhe verifikimi i legjislacionit për përputhshmërinë me të drejtat e njeriut është koordinuar dobët nga ekzekutivi.
- ▶ Krijimi i një komiteti të dedikuar për të drejtat e njeriut dërgon një sinjal që parlamenti njeh dhe synon të veprojë sipas detyrimeve të tij për të drejtat e njeriut.
- ▶ Një komitet i tillë luan një rol vendimtar në informimin e debatit parlamentar për të drejtat e njeriut. Kjo përfshin këshillimin e parlamentit për detyrimet dhe kuadrin e të drejtave të njeriut të cilat janë të rëndësishme për çdo çështje përpara tij, dhe shtyrjen e ekzekutivit për të justifikuar veprimin ose mosveprimin e tij për çështje që lidhen me të drejtat e njeriut dhe sundimin e ligjit.
- ▶ Një komitet për të drejtat e njeriut që është i pavarur nga ekzekutivi, me kalimin e kohës, mund të zhvillojë si mekanizma sistematikë mbikëqyrës, ashtu edhe ekspertizë mbi të drejtat e njeriut brenda anëtarëve dhe stafit të tij. Siç argumenton ish relatori i Asamblesë Parlamentare, Christos Pourgourides, modeli i specializuar ka “avantazhe të qarta” pasi “bashkon kompetencat dhe siguron drejtimin”.<sup>47</sup>
- ▶ Një organ i dedikuar për të drejtat e njeriut brenda parlamentit krijon një bashkëbisedues me ekzekutivin dhe një organ i cili mund të kryejë funksione të specializuara siç janë ekzaminimi “në kohë reale” i planeve të veprimit dhe raporteve të veprimit dhe marrja në konsideratë e raporteve nga ekzekutivi për vendimet e Gjykatës dhe shkallën e ekzekutimit të tyre (shiko 3.2.).

47. Dok. 12636 (shënimi 14), paragrafi 30.

- ▶ Një avantazh i mëtejshëm i të pasurit një organ kryesor të të drejtave të njeriut brenda parlamentit është potenciali që ai ka që të zhvillojë mirëkuptimin dhe kontaktin e pavarur me Gjykatën, Komitetin e Ministrave, Asamblenë Parlamentare, dhe ndoshta organe të tjera të Këshillit të Evropës si p.sh. Komitete për të Drejtat e Njeriut.
- ▶ Për më tepër, një komitet i specializuar mund të ketë më shumë të ngjarë të tërheqë dhe të mbajë këshilltarë juridikë dhe politikë profesionalë me cilësi të lartë dhe me ekspertizë mbi të drejtat e njeriut, të cilët janë pikë kyçe e punës efektive parlamentare për të drejtat e njeriut (shiko 4.2.).

### **Komiteti i Ligjit Kushtetues në Finlandë**

Funksioni kryesor i Komitetit të Ligjit Kushtetues në Finlandë është të japë mendim për ligjet (ose çështje të tjera) që i janë dërguar për shqyrtim në lidhje me kushtetutshmërinë e tyre dhe ndikimin e tyre në instrumentet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, përfshirë Konventën. Pasi të jetë paraqitur një propozim legjislativ, komiteti zgjedh pikëpamjet e nëpunësve civilë përkatës dhe ekspertëve të jashtëm të së drejtës kushtetuese në një seancë të mbyllur, zyrtare, përpara se të miratojë një mendim ose raport të arsyetuar. Nëse evidentohen papajtueshmëri, komiteti shpjegon se cilat dispozita i konsideron të papajtueshme me kushtetutën ose Konventën.

Opinionet e komitetit, si çështje zakonore, trajtohen zyrtarisht si të detyrueshme për parlamentin. Komiteti shpesh i referohet vendimeve të Gjykatës.<sup>48</sup> Ministria e Jashtme i dërgon të gjitha vendimet e Gjykatës kundër Finlandës në sekretariatit e komitetit për informacion; ato nuk qarkullohen përveçse nëse diçka e tillë kërkohet. Avokati parlamentar i Popullit i paraqet parlamentit një raport vjetor, duke përfshirë një pjesë të shkurtër për çështjet finlandeze në Gjykatë. Raporti shqyrtohet nga Komiteti i Ligjit Kushtetues; megjithatë, komiteti asnjëherë nuk ka marrë qëndrim në lidhje me seksionin (disi teknik) të raportit.

### **Modeli ndërsektorial**

Kur nuk ka një komitet të specializuar për të drejtat e njeriut, çështjet e të drejtave të njeriut duhet të trajtohen nga komitete të ndryshme parlamentare, nëse të drejtat e njeriut përkojnë me mandatin e tyre përkatës, shpesh duke përfshirë, por pa u kufizuar, në komitete me detyra më të gjera që mbulojnë drejtësinë, çështjet ligjore etj. dhe/ ose kushtetutën.

48. Shih DMPP, "Roli i parlamenteve në zbatimin e standardeve të KEDNJ" (shënimi 29), faqe 3 (me referenca të mëtejshme).

Shpesh përdoret termi “i integruar”; ky term nënkupton që, në praktikë, mbikëqyrja e të drejtave të njeriut është e përfshirë në punën e të gjitha komiteteve. Sidoqoftë, kjo shpesh nuk ndodh në parlamentet e shteteve anëtare të Këshillit të Evropës që kanë një strukturë komiteti ndërsektoriale. Në këtë kuptim, të qenit i integruar mund të kuptohet në shumë parlamente më shumë si aspiratë sesa përshkrim i praktikës aktuale.

Ndër avantazhet e mundshme të një qasjeje ndërsektoriale ose të integruar është që zvogëlon rrezikun që lënia e shqyrtimit të të drejtave të njeriut një organi të vetëm, të specializuar mund të krijojë një “depo” të ekspertizës dhe angazhimit për të drejtat e njeriut brenda parlamentit dhe dekurajon integrimin e të drejtave të njeriut dhe çështjeve përkatëse të zbatimit të ligjit, në punën e komiteteve të tjera. Ka kufi ajo që mund të arrihet nga një komitet i vetëm (shpesh me një anëtarësi relativisht të vogël), dhe integrimi mund të ndihmojë që të drejtat e njeriut të mos hidhen poshtë ose shpërfillen nga parlamentarët që nuk janë anëtarë të një komiteti të specializuar.

Parlamentet që miratojnë qasjen ndërsektoriale përfshijnë ato në Estoni, Islandë, Luksemburg, Hollandë, Norvegji dhe Zvicër.

## **Holanda**

Në Holandë, asnjë komitet parlamentar nuk ka një detyrë të shprehur qartë për të shqyrtuar legjislacionin për pajtueshmërinë me Konventën ose për të kryer mbikëqyrje të ekzekutimit të vendimeve të Gjykatës. As nuk ekziston një njësi e specializuar për të drejtat e njeriut në dispozicion të anëtarëve të parlamentit. Sidoqoftë, secila dhomë e parlamentit (Shtëpia e Përfaqësuesve holandezë dhe Senati) ka një komitet të përhershëm të drejtësisë dhe një shërbim juridik, i cili vendos theksin në verifikimin e legjislacionit për pajtueshmërinë me Konventën.

Legjislacioni i propozuar i paraqitur nga qeveria shoqërohet me një memorandum shpjegues, i cili identifikon çdo çështje të pajtueshmërisë me Konventën ose standardet e tjera ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Për më tepër, çdo projektligj, përpara se të paraqitet në parlament, duhet të kalojë përpara Këshillit të Shtetit Holandez (një organ këshillimor për qeverinë i krijuar me kushtetutë) për një mendim mbi çështjet që përfshijnë pajtueshmërinë me të drejtat e njeriut, të cilave iu përgjigjet qeveria. Ky material shërben për të informuar shqyrtimin pasues legjislativ nga komiteti(et) parlamentar përkatës. Parlamentarët gjithashtu mund të kërkojnë këshilla nga këshilli i shtetit ose nga nëpunësit civilë brenda ministrisë së drejtësisë, të cilët marrin trajnime për të drejtat e njeriut. Qeveria raporton gjithashtu çdo vit në parlament për ekzekutimin e vendimeve (shiko 3.2.).

Rreziku i dukshëm me qasjen ndërsektoriale të mbikëqyrjes së të drejtave të njeriut është se ajo mund të kthehet në një eufemizëm për mbikëqyrjen sporadike (ose, me të vërtetë, jo-ekzistente) - ku "përgjegjësia e të gjithëve nuk është përgjegjësi e asnjë".

## Modeli hibrid i komitetit

Modelet hibride kombinojnë elemente të qasjes së specializuar dhe asaj ndërsektoriale. Në raste të tilla, më shumë se një komitet ose nën-komitet parlamentar ka të drejtat e njeriut brenda mandatit të tij, të cilat mund ose mund të mos përfshijnë funksione specifike siç është monitorimi i ekzekutimit të vendimeve të Gjykatës.

Shembuj të modeleve të komitetit hibrid mund të gjenden në parlamentet e Armenisë, Qipros, Gjeorgjisë, Gjermanisë, Italisë dhe Lituanisë, midis shteteve të tjera.

### Gjermania

Dy komitetet e Bundestagut (Dhoma e Ulët) që kryesisht merren me çështje të të drejtave të njeriut janë Komiteti për të Drejtat e Njeriut dhe Ndhimën Humanitare dhe Komiteti për Çështje Ligjore dhe Mbrojtjen e Konsumatorit. Komiteti i Peticioneve gjithashtu mund të marrë parasysh çështjet e të drejtave të njeriut gjatë shqyrtimit të ankesave individuale në lidhje me ndikimin publik të legjislacionit.

Komiteti për Çështje Ligjore dhe Mbrojtjen e Konsumatorit drejton të gjitha çështjet që lidhen me ministrinë e drejtësisë. Komiteti për të Drejtat e Njeriut dhe Ndhimën Humanitare rrallë është komiteti kryesor për një çështje të veçantë, pasi nuk është në linjë të ndonjë ministrie specifike. Përkundrazi, ai diskuton çështjet e të drejtave të njeriut nga një këndvështrim i gjerë - si në bazë ndërkombëtare, ashtu edhe në lidhje me Gjermaninë. Asnjë komitet nuk ka një mandat të qartë për të marrë në konsideratë zbatimin e vendimeve të Gjykatës; përfshirja e tyre (ose ajo e komiteve të tjera parlamentare) varet nga çështja e veçantë e ligjit ose politikave e ngritur nga një gjykim. Parlamentarëve u jepen këshilla të pavarura nga ekspertët e shërbimit kërkimor brenda parlamentit, përfshirë çështjet e ligjit ndërkombëtar për të drejtat e njeriut.

Kur nga legjislacioni i ri ose i rishikuar kërkohet të zbatohet një vendim, çështja do të konsiderohet nga Komiteti për Çështjet Ligjore dhe Mbrojtjen e Konsumatorit. Në këto rrethana, është e zakonshme që komiteti të thërrasë përfaqësues të ministrisë së drejtësisë që të marrin pjesë për të shpjeguar pse e konsiderojnë të nevojshme dhe pse projektligji konsiderohet i mjaftueshëm për të zbatuar vendimin. Ministria e drejtësisë raporton çdo vit në parlament mbi vendimet e Gjykatës dhe shkallën e ekzekutimit të tyre (shiko 3.2.)

Një variant i modelit hibrid është kur një nën-komitet i specializuar me detyrë për të drejtat e njeriut formohet nën një komitet të përhershëm me një mandat më të gjerë.

### **Nën-komitetet në Dhomën e Deputetëve të Republikës Çeke**

Komiteti për Çështje Kushtetuese dhe Ligjore në Dhomën e Deputetëve (Dhoma e Ulët) të Parlamentit çek ka themeluar një Nënkomitet për Iniciativat Legjislative të Avokatit të Popullit dhe Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.<sup>49</sup> Përveç kësaj, Komiteti i Peticioneve ka një nën-Komitet për të drejtat e njeriut. Nën-komitetet janë efektivisht grupe pune të komitetit të tyre mëmë dhe takohen privatisht. Nën-komiteti për Iniciativat Legjislative të Avokatit të Popullit dhe Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut diskuton raportin vjetor të përgatitur nga agjenti i qeverisë për gjykimet kundër Republikës Çeke dhe shkallën e tyre të ekzekutimit. Komiteti për Çështjet Kushtetuese dhe Ligjore dhe Komiteti për Peticione luajnë rolin kryesor në verifikimin e pajtueshmërisë së ligjeve qeveritare dhe joqeveritare me traktatet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, përfshirë Konventën.

## **4.2. Mbështetja për të gjithë parlamentarët që të bëhen garantues të të drejtave të njeriut**

Seksioni i mësipërm tregoi se secili model ka avantazhet dhe disavantazhet e veta. Për më tepër, u bë e dukshme që është e rëndësishme të mos përqendrohemi vetëm në struktura. Komitetet që mbajnë etiketën “të drejtat e njeriut”, për shembull, mund të krijojnë iluzionin e veprimtarisë kur në të vërtetë nuk kryhet asnjë veprimtari. Përkundrazi, efikasiteti i strukturave të tilla varet nga faktorë të tillë si angazhimi politik dhe disponueshmëria e këshillave nga ekspertët për çështjet ligjore dhe të politikave si dhe mbështetja e sekretariatit. Ky seksion do të shqyrtojë se si mund të bëhet efektiv secili prej modeleve për punën parlamentare për të drejtat e njeriut të identifikuar më lart.

### **Sigurimi që të gjithë parlamentarët e dinë se kur janë në rrezik të drejtat e njeriut**

Parakusht për angazhimin efektiv parlamentar me të drejtat e njeriut është që parlamentarët të jenë të vetëdijshëm kur të drejtat e njeriut janë në rrezik. Kështu, nxitja e njohurive dhe ekspertizës së parlamentarëve është thelbësore

49. Ndër aktivitetet të tjera, Avokati i Popullit, i njohur gjithashtu si mbrojtës publik i të drejtave, ndërmjetëson mes ankuesve dhe organeve publike dhe kontribuon në promovimin e së drejtës për trajtim të barabartë dhe mbrojtje nga diskriminimi.

për krijimin e kulturës së të drejtave të njeriut brenda parlamentit, në të cilën çështjet e të drejtave të njeriut zhvendosen nga skajet në qendrën e debatit parlamentar.

Kjo mund të arrihet, para së gjithash, duke u siguruar që raportet e një komiteti për të drejtat e njeriut - ose të një pjese tjetër të makinerisë kombëtare të të drejtave të njeriut - të sillen në vëmendjen e parlamentarëve të tjerë përpara çdo procesi i cili përfshin debatin për të drejtat e njeriut.

Një metodë tjetër është të krijohen mekanizma, në mënyrë që kryetari i parlamentit (ose ekuivalenti i tij) të informohet gjithmonë paraprakisht kur një procedurë parlamentare angazhon detyrimin e parlamentit për të mbrojtur dhe realizuar të drejtat e njeriut, në mënyrë që kryetari i parlamentit (ose ekuivalenti i tij) të bëjë të mundur përmbushjen e këtij detyrimi - për shembull, duke u siguruar që një propozim legjislativ që ka implikime në të drejtat e njeriut të shqyrtohet nga komiteti(et) më i përshtatshëm.<sup>50</sup>

## **Sigurimi që të gjithë parlamentarët të mund të përdorin këshilla të pavarura për të drejtat e njeriut**

Rëndësia e krijimit të një organi të përhershëm me staf profesional të aftë për të ofruar këshilla të pavarura dhe eksperte për të drejtat e njeriut dhe sundimin e ligjit brenda parlamenteve kombëtare është nënvizuar vazhdimisht nga Asambleja Parlamentare, për shembull në [Rezolutën 1823 \(2011\)](#), dhe reflektohet në punën e vet për krijimin e kapaciteteve me stafin parlamentar.<sup>51</sup>

Aksesi në këshilla politikisht neutrale ndihmon për të siguruar pavarësinë - dhe shfaqjen e pavarësisë - e komiteteve për të drejtat e njeriut dhe parlamentit në përgjithësi. Ky përfitim ka shumë më pak të ngjarë të ndodhë kur këshilltarët janë të emëruar të përkohshëm të parlamentarëve ose grupeve të partive politike, ose kur ata janë të drejtuar nga qeveria ose organizatat joqeveritare (OJQ).

Zhvillimi i një organi me staf profesional parlamentar gjithashtu siguron vazhdimësi midis parlamenteve dhe siguron krijimin e një "kujtese institucionale", si në lidhje me çështjet thelbësore ashtu edhe me metodat e punës. Duke ofruar ekspertizë juridike dhe të politikave të aksesueshme, këshilltarët mund të mbështesin parlamentarët (mes aktiviteteve të tjera) në shqyrtimin e legjislacionit dhe monitorimin e përgjigjes ekzekutive ndaj gjykimeve dhe vendimeve për të drejtat e njeriut, në mënyrë të tillë që merr parasysh natyrën e detyrimit për shtetin dhe gamën e plotë të opsioneve të hapura për parlamentin, të pajtueshme me të drejtat e njeriut.

50. Chang dhe Ramshaw (shënimi 28), faqe 8.

51. DMPP, Divizioni i Mbështetjes së Projekteve Parlamentare (DMPP), *Projekte në bashkëpunim me Komitetin për çështjet Ligjore dhe të Drejtat e Njeriut* (pa datë).

Shkurtimisht, është thelbësore që këshilltarët parlamentarë të jenë politikisht të pavarur, të mjaftueshëm numerikisht dhe të plotësuar me burime, dhe të kenë mundësi të shumta për të zhvilluar aftësitë e tyre në lidhje me njohuritë dhe kuptimin e të drejtave të njeriut dhe sundimit të ligjit. Për më tepër, thelbi i rolit këshillimor nënkupton nevojën për t'u siguruar që ekspertiza për të drejtat e njeriut nuk kufizohet në një komitet të vetëm në parlament, por është integruar, aq sa është e mundur, në të gjithë gamën e plotë të veprimtarisë parlamentare.

I njëjti parim i integritetit vlen për kërkimet profesionale dhe shërbimet e informacionit brenda parlamentit, të cilat ofrojnë një shtesë të vlefshme për punën e këshilltarëve juridikë. Shërbimi i kërkimit parlamentar duhet të përfshijë në prezantimet e tij të shkurtra çështje të rëndësishme për të drejtat e njeriut dhe sundimin e ligjit dhe gjithashtu mund të sigurojë për parlamentarët në mënyrë proaktive përditësime mbi zhvillimet e rëndësishme të të drejtave të njeriut, në pritje të çështjeve të të drejtave të njeriut që mund të jenë në diskutim në botën parlamentare.

### **Tre mësimet për organizimin e punës parlamentare për të drejtat e njeriut**

Ndërsa Asambleja Parlamentare nuk ka pranuar të japë një plan për të institucionalizuar punën parlamentare për të drejtat e njeriut, mund të nxirren tre përfundime të përgjithshme.

Së pari, (nën-)komitetet e specializuara për të drejtat e njeriut, kur kanë kompetencën e duhur, fuqi dhe anëtarësim, janë një mjet i vlefshëm për të forcuar aftësinë e parlamenteve për të mbrojtur dhe realizuar të drejtat e njeriut në nivel kombëtar, veçanërisht në shtetet me pak ose aspak përvojë në angazhime domethënëse parlamentare me çështjet e të drejtave të njeriut.

Së dyti, dhe pavarësisht nga këto përfitime të mundshme, këto struktura nuk do të jenë efektive në vetvete, nëse nuk mbështeten nga angazhimi politik i anëtarëve të tyre dhe parlamentit në tërësi.

Së treti, në mënyrë që të sigurohemi që të gjithë parlamentarët të fitojnë ekspertizë më të madhe në çështjet e të drejtave të njeriut dhe të marrin përgjegjësinë e tyre të përbashkët për forcimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, specializimi dhe qasja ndërsektoriale nuk duhet të shihen si mundësi reciproke ekskluzive; përkundrazi, një komitet i specializuar për të drejtat e njeriut duhet të jetë një "motor" i integritetit.<sup>52</sup> Kështu, është e rëndësishme të sigurohemi që konsiderimi i të drejtave të njeriut dhe çështjet e lidhura me sundimin e ligjit të jenë të integruara në të gjithë gamën e funksioneve dhe aktiviteteve të një parlamenti, duke përfshirë si komitetet ashtu edhe shërbimet ligjore dhe kërkimore.

52. Siç argumentohet nga Murray Hunt, ish Krye-Këshilltar Ligjor në KPDNJ. Shihni Donald dhe Leach (shënimi 20), faqja 80.

Ky kapitull ka eksploruar përshtatjet institucionale dhe legjislativë që mund të bëjnë parlamentet për të siguruar pajtueshmërinë me detyrimet e shtetit për të drejtat e njeriut dhe rëndësinë e mbështetjes së parlamentarëve përmes ofrimit të këshillave të pavarura ligjore dhe për politikën. Në kapitullin tjetër, diskutohet se si funksionojnë në praktikë strukturat parlamentare të të drejtave të njeriut dhe parimet që mbështesin punën e tyre.



## Kapitulli 5

# Detyrat e parlamentarëve për struktura funksionale të të drejtave të njeriut

Nëse merret vendimi për krijimin e një komiteti parlamentar për të drejtat e njeriut<sup>53</sup>, si duhet të formohet ky i fundit dhe si duhet ta zhvillojë punën e tij të përditshme? Ky kapitull shqyrton këto pyetje në lidhje me statusin dhe detyrat e komitetit për të drejtat e njeriut (5.1.); anëtarësimin (5.2.); kompetencat (5.3.); praktikën e punës (5.4.); dhe marrëdhëniet me degët e tjera të shtetit dhe me organizatat në nivel vendor, rajonal dhe ndërkombëtar (5.5.). Për më tepër, duhet të merret në konsideratë trajnimi dhe asistencat teknike për të drejtat e njeriut e ofruar nga parlamentarët (5.6.) si dhe mënyra se si organet parlamentare të të drejtave të njeriut mund të vlerësojnë efektivitetin e tyre (5.7.).

Ky kapitull përqendrohet te burimet ekzistuese të informacionit dhe udhëzimeve të nxjerra për parlamentarët nga Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës<sup>54</sup> dhe Unioni Ndër-Parlamentar (UNP),<sup>55</sup> si dhe “Draft parimet dhe udhëzimet për mbrojtjen dhe realizimin e sundimit të ligjit dhe të drejtave të njeriut: (i

53. Në këtë kapitull, termi “Komiteti për të Drejtat e Njeriut” përdoret për t’iu referuar një komiteti të specializuar të të drejtave të njeriut ose çdo komiteti që përfshin shprehimisht të drejtat e njeriut brenda detyrave të tij (brenda modelit hibrid të përshkruar në 4.1.).

54. Shihni, në mënyrë të veçantë, [Rezolutën 1823 \(2011\)](#) (shënimi 4); DMPP, “Roli i parlamenteve në zbatimin e standardeve të GJEDNJ” (shënimi 29).

55. UNP/KB, Të Drejtat e Njeriut - Doracak për parlamentarët Nr. 26 (shënimi 21)..

referuar më tej si Draft Parimet dhe Udhëzimet), të cilat janë hartuar nga ish Këshilltari Kryesor Ligjor për Komisionin e Përbashkët për të Drejtat e Njeriut në Parlamentin e Mbretërisë së Bashkuar, Murray Hunt,<sup>56</sup> dhe miratuar nga KB.<sup>57</sup>

## 5.1. Statusi dhe detyrat

Asambleja Parlamentare rekomandon, në “Parimet Themelore për mbikëqyrjen parlamentare të standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut” bashkangjitu [Rezolutës 1823 \(2011\)](#), që komitetet parlamentare për të drejtat e njeriut duhet të kenë detyra të përcaktuara dhe të parashikuara qartë në ligj. Draft Parimet dhe Udhëzimet rekomandojnë më tej themelimin e një komiteti për të drejtat e njeriut nga vetë parlamenti dhe jo nga ekzekutivi. Përveç kësaj, ai duhet të ketë status të përhershëm. Këto garanci të pavarësisë dhe të autonomisë janë të rëndësishme për të siguruar që mekanizmat parlamentarë të të drejtave të njeriut të mos dobësohen ose të mos destabilizohen nëpërmjet administratave dhe që parlamentarët të jenë në gjendje të veprojnë në mënyrë të pavarur, larg presioni politik dhe t’i shprehin idetë e tyre pa u frikësuar nga kundërsulmet.<sup>58</sup>

Përgjegjësitë e Komitetit të të drejtave të njeriut, përkatësisht detyrat ose fushat e veprimtarisë të cilat i janë caktuar zyrtarisht, duhet të jenë mjaft të gjera, që të jenë në gjendje t’i pasqyrojë parlamentit detyrat urgjente, si për të mbrojtur, ashtu edhe për të realizuar të drejtat e njeriut në shtetin në fjalë, si dhe të marrë parasysh të gjitha burimet përkatëse të standardeve të të drejtave të njeriut, si në ligjin kombëtar, ashtu edhe në atë ndërkombëtar.

56. Për tekstin e plotë, shihni “Parlamentet dhe Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut”, [raporti](#) i konferencës së mbajtur në Senat në Varshavë, në datën 12 maj 2015, Shtojca: Draft parimet dhe udhëzimet për mbrojtjen dhe realizimin e sundimit të ligjit dhe të drejtave të njeriut, faqet 25-34. Shihni gjithashtu Chang dhe Ramshaw (shënimi 28), të cilët i përdorin Draft Parimet dhe Udhëzimet si mjet praktik për të vlerësuar aftësinë parlamentare për të siguruar mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave të njeriut në gjashtë vende: në Gjeorgji, në “ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë”, në Serbi, në Tunizi, në Ugandë dhe në Ukrainë.

57. Shihni Asamblenë e Përgjithshme të KB, “Forcimi i veprimtarisë së Kombeve të Bashkuara në fushën e të drejtave të njeriut përmes promovimit të bashkëpunimit ndërkombëtar dhe rëndësisë së mos-selektimit, paanshmërisë dhe objektivitetit: Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm”, Dok. A / 72/351, 21 gusht 2017, paragrafi 36: “Sekretari i Përgjithshëm nxit një angazhim më proaktiv nga ana e parlamentarëve në punën e mekanizmave ndërkombëtarë të të drejtave të njeriut, duke përfshirë zhvillimin e një serie parimesh dhe udhëzimesh që do t’i ndihmojnë dhe udhëzojnë ato.”

58. Dok. 12636 (shënimi 14), paragrafi 22.

Preferohet që detyrat të kufizohen në të drejtat e njeriut në kontekstin vendas. Aty ku përfshihen portofola të tilla siç janë punët e jashtme, është e rëndësishme të shmanget rreziku në rastet kur parlamentarët e përqendrojnë gjithë vëmendjen e tyre ose pjesën më të madhe të saj në situatën e të drejtave të njeriut në shtetet e tjera, duke lënë mënjanë mbikëqyrjen e të drejtave të njeriut në vendin e tyre.

## 5.2. Anëtarësia

Draft Parimet dhe Udhëzimet rekomandojnë që metoda e emërimit të komitetit për të drejtat e njeriut të jetë transparente dhe të zotërojë besimin e publikut dhe duhet të japë garanci që është i pavarur si nga qeveria ashtu edhe nga organet joshitetore. Në mënyrë të veçantë, rekomandohet që përbërja e komitetit preferohet të përcaktohet në mënyrë të tillë ku të përjashtohet mundësia e një mazhorance qeveritare dhe të sigurohet që anëtarët e qeverisë të mos kenë të drejtë të jenë anëtarë të komitetit. Duhet të ekzistojë një mekanizëm që konfliktet e mundshme të interesit të shpallen nga anëtarët e komitetit.

Për më tepër, rekomandohet që anëtarësimi në komitet të jetë sa më gjithëpërfshirës për sa i përket numrit të partive politike brenda parlamentit dhe të pasqyrojë parimet e pluralizmit dhe të ekuilibrit gjinor. Kreu i komitetit preferohet të zgjidhet nga anëtarët e parlamentit dhe duhet të jetë një parlamentar me eksperiencë e duhet të vërtetojë pavarësinë dhe angazhimin për të drejtat e njeriut.

Këto garanci zyrtare të pavarësisë dhe pluralizmit marrin vlerë të veçantë në parlamentet të cilat nuk kanë traditë të fortë në përdorimin e komisioneve që i kërkojnë llogari qeverisë. Duke pasur parasysh që të drejtat e njeriut shpesh mbrojnë pakicat (të cilat mund të jenë të marginalizuara ose jo shumë të njohura), rregullat që drejtojnë komitetet e specializuara për të drejtat e njeriut duhet të përmbajnë garanci jashtëzakonisht të forta kundër politizimit të padrejtë. Për shembull, duhet të merret në konsideratë dhe të shikohet mundësia që vendi i kryetarit t'i rezervohet një anëtarë të opozitës. Në parlamentet e përbërë nga dy dhoma, nëse merret vendimi për krijimin e një komiteti të specializuar për të drejtat e njeriut, duhet të merret parasysh fakti i krijimit të një komiteti të përbashkët nga të dy dhomat, në mënyrë që të maksimizohet potenciali për një shqyrtim të detajuar dhe me ndikim politik.

### 5.3. Kompetencat

Një komitet për të drejtat e njeriut duhet të ketë kompetenca mjaft të gjera që të përmbushë kompetencat e tij në mënyrë efektive, duke përfshirë këtu kompetencat për gjetjen e fakteve për të marrë informacion në lidhje me shkeljet e të drejtave të njeriut. Asambleja Parlamentare rekomandon që komitetet për të drejtat e njeriut të kenë:

- ▶ kompetenca për urdhra me shkrim në mënyrë që të jenë në gjendje të detyrojnë dëshmitarët të marrin pjesë dhe të kërkojnë dhënien e dokumenteve nga qeveria<sup>59</sup>, që kanë lidhje me detyrat e komitetit, dhe
- ▶ kompetencën për të iniciuar propozime legjislative dhe ndryshime në ligje.<sup>60</sup>

Draft Parimet dhe Udhëzimet rekomandojnë më tej që komiteti duhet të ketë kompetencën për të:

- ▶ iniciuar hetime të zgjedhura nga vetë ai;
- ▶ zhvilluar seanca dëgjimore të dëshmimeve të dhëna me gojë;
- ▶ kryer vizita, përfshirë këtu edhe vizitat jashtë vendit;
- ▶ pasur akses në vendet e paraburgimit pa paralajmërim;<sup>61</sup>
- ▶ raportuar në parlament; dhe
- ▶ bërë rekomandime për qeverinë.

59. [Rezoluta 1823 \(2011\)](#) (shënimi 4), Shtojca, paragrafi 1. Në të njëjtën kohë, Asambleja, duke miratuar “Parimet Globale për Sigurinë kombëtare dhe të Drejtën e Informacionit” ([Parimet Tshwane](#); të nxjerra në datën 12 qershor 2013), pranoi se duhet të ketë një ekuilibër të duhur midis problemeve të ligjshme të sigurisë kombëtare dhe të drejtës së publikut për të pasur akses në informacionin e mbajtur nga autoritetet publike. APKE ka theksuar se, “[si] rregull i përgjithshëm, të gjitha informacionet e mbajtura nga autoritetet publike duhet të jenë lehtësisht të arritshme” dhe, “si mbrojtje kundër përjashtimeve tepër të zgjeruara, aksesin në informacion duhet të jepet edhe në rastet kur normalisht mbulohet nga një përjashtim i ligjshëm, kur interesi publik për informacionin në fjalë tejkalon interesin e autoriteteve për ta mbajtur atë të fshehtë”, duke përfshirë këtu edhe rastin kur një informacion i tillë “do të jepte një kontribut të rëndësishëm në një debat të vazhdueshëm publik”. [Rezoluta e APKE-s 1954 \(2013\)](#), “Siguria kombëtare dhe aksesin në informacion”, paragrafët 9.1, 9.5 dhe 9.5.1.

60. [Rezoluta 1823 \(2011\)](#) (shënimi 4), Shtojca, paragrafi 1.

61. Komisionet parlamentare për të drejtat e njeriut duhet të jenë të vetëdijshme dhe të sigurojnë mosndërhyrje në vizitat e bëra në vendet e privimit të lirisë, të kryera nga subjektet e tjera, siç janë (ndër të tjera) IKDNJ-ja, OJQ-të, mekanizmat kombëtarë parandalues (MKP) sipas Protokollit Opsional të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Torturës dhe Trajtitimit ose Ndëshkimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore ose Poshtëruese (POIKDH), dhe Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtitimit ose Ndëshkimit Çnjerëzor ose Poshtëruese (CPT). Shihni, p.sh. APKE dhe Shoqata për Parandalimin e Torturës (SHPT) (2013). [Vizitimi i qendrave të para-burgimit të emigracionit - Një udhëzues për parlamentarët](#), Strasburg, Botimi i Këshillit të Evropës, faqet 18-19.

## 5.4. Praktikrat e punës

### Mbajtja e një faqe interneti të përditësuar

Një nga kërkesat kryesore për transparencë është fakti që komiteti për të drejtat e njeriut duhet të mbajë të përditësuar një faqe interneti ku të gjitha materialet përkatëse të jenë lehtësisht të arritshme. Këto materiale mund të përfshijnë:

- ▶ raportet e komitetit në parlament dhe çdo përgjigje të qeverisë ndaj këtyre raporteve;
- ▶ dorëzimi i provave me shkrim dhe transkriptimet dhe/ ose regjistrimet e provave me gojë (me përjashtim të kufizimeve të mirë përcaktuara për zbulimin e të dhëna të caktuara sensitive, që mund të kërkohen, për shembull në interes të mbrojtjes së dëshmitarëve);
- ▶ letërkëmbimet e përzgjedhura me ministrat, zyrtarët qeveritarë dhe organet e tjera të jashtme;
- ▶ njoftimet për shtyp; dhe
- ▶ çdo dokument që lidhet me fushëveprimin e komitetit dhe praktikrat e tij të punës.

### Publikimi i metodave të punës dhe një program pune që gëzon përparësi

Udhëzimet, komiteti për të drejtat e njeriut të botojë një deklaratë të praktikave të tij të punës dhe t'i mbajë ato nën rishikim të rregullt. Në mënyrë të veçantë, ai duhet të publikojë çështjet që propozon si përparësi në programin e tij të punës - për shembull, në lidhje me shqyrtimin legjislativ ose hetimet tematike - dhe të shpjegojë mënyrat që janë ndjekur për vendosjen e këtyre përparësive. Kjo praktikë është e rëndësishme si për forcimin e mirëkuptimit parlamentar dhe publik dhe rritjes së besimit në punën e komitetit në një shkallë më të gjerë, ashtu edhe për krijimin e një regjistrimi të përhershëm të punës së komitetit që do të vazhdojë të ekzistojë edhe në të ardhmen më gjatë se çdo anëtar komiteti dhe se stafi i tij.

### Raportimi në parlament

Për më tepër, rekomandohet që komiteti t'i raportojë rregullisht - dhe të paktën një herë në vit - parlamentit mbi gjithë veprimtarinë e tij dhe performancën e funksioneve të tij. Për veç kësaj, ai duhet të shfrytëzojë çdo mundësi për të ndërmarrë veprimet e duhura për sa u përket raporteve ose rekomandimeve të mëparshme të komitetit, me qëllim që të ndjekë veprimtarinë e ekzekutivit për sa i përket përgjigjes në kohën e duhur dhe në mënyrë adekuate.

## Si i merr vendimet komiteti

Në Draft Parimet dhe Udhëzimet rekomandohet që komiteti të përpiqet të arrijë konsensus mbi çështjet për të cilat raporton, brenda mundësive që i lejojnë. Ky parim pasqyron faktin që anëtarët e komiteteve mund të kenë konceptime të ndryshme politike dhe filozofike mbi të drejtat e njeriut dhe duhet t'i zgjidhin këto dallime kur marrin vendime për përparësitë e përgjithshme të komitetit dhe kur ofrojnë përgjigje ndaj propozimeve specifike legjislative ose gjyqimore dhe vendimeve të organeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

Në rastet kur nuk arrihet konsensusi, është thelbësore që anëtarët e komisionit të përpiqen të kapërcejnë pikëpamjet e njëanshme ose ideologjike duke u përqendruar në pikëpamje që janë mëse të justifikuar për sa i përket parimit. Është përgjegjësia e tyre që të mos shfaqin mungesë respekti të standardeve të të drejtave të njeriut të cilat janë marrë përsipër për t'u respektuar nga shteti, por të kontribuojnë në përmbushjen e këtyre detyrave.

### 5.5. Zhvillimi i marrëdhënieve të jashtme

Siç është njohur dhe nga Asambleja Parlamentare (në Shtojcën e [Rezolutës 1823 \(2011\)](#)) një komitet për të drejtat e njeriut nuk mund të funksionojë në mënyrë efektive në izolim. Përkundrazi, ndikimi dhe efektiviteti i tij varen si nga anëtarët e parlamentit ashtu edhe nga stafi parlamentar që zhvillon dhe mban marrëdhënie efektive pune me një gamë të gjerë bashkëbiseduesish kryesorë, kombëtarë dhe ndërkombëtarë. Vetëm përmes marrëdhënieve të tilla komiteti mund të marrë dhe transmetojë informacione, të pasurojë dhe t'u japë kuptimin e vet të drejtave të njeriut dhe të përmbushë detyrimin e tij të përbashkët për të mbrojtur dhe promovuar të drejtat e njeriut.

Një nga marrëdhëniet kryesore është ajo me **ekzekutivin**. Konsiderohet shumë e rëndësishme që ministrat dhe zyrtarët e qeverisë të marrin udhëzime të hollësishme nga parlamenti për veprimet që duhet të ndërmerren për t'u krijuar kushte parlamentarëve që të përmbushin detyrimet e tyre për mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave të njeriut. Marrëdhëniet midis parlamentit dhe ekzekutivit diskutohen më në detaje në 3.2.

Draft Parimet dhe Udhëzimet gjithashtu i referohen marrëdhënieve të parlamentit me **gjykatat** vendase, të cilat drejtohen nga parimi i rëndësishëm i ndarjes së pushteteve. Ndonjëherë mund të jetë e nevojshme që parlamenti t'u kërkojë përfaqësuesve pikëpamje ligjore duke kontribuar në këtë mënyrë në shqyrtimin e ligjeve ose politikave të tij që ndikojnë në ushtrimin e funksionit ligjor ose sundimin e ligjit në një shkallë më të gjerë. Në të njëjtën mënyrë, sipas Draft Parimeve dhe Udhëzimeve, kur një gjykatë dëshiron të marrë parasysh vlerësimin e dhënë nga parlamenti për një çështje të të drejtave të njeriut, për

të cilën gjykata duhet të marrë një vendim, parlamentarët duhet ta lehtësojnë procesin e një vlerësimi të tillë ligjor. Për shembull, siç shpjegohet në 6.3., Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut mund të dëshirojë të përcaktojë nëse një parlament merr në konsideratë në mënyrë të ndërgjegjshme implikimet e të drejtave të njeriut në legjislacion, në rastet kur Gjykata vendos për vlefshmërinë e çdo sfide vijuese që bazohet te të drejtat e njeriut për atë legjislacion.

Siç ka nënvizuar Asambleja Parlamentare,<sup>62</sup> një marrëdhënie tjetër e rëndësishme për të cilën duhet të nxitet parlamenti është marrëdhënia me **institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut (IKDNJ)**. Krijimi i një bashkëpunimi efektiv me IKDNJ-në, parlamentin dhe komitetin e tij për të drejtat e njeriut duhet të udhëhiqet nga Parimet e Beogradit për Marrëdhëniet midis Institucioneve Kombëtare të të Drejtave të Njeriut dhe Parlamenteve.<sup>63</sup> Këto mbulojnë rolin e parlamentit në krijimin e një IKDNJ dhe sigurimin e funksionimit, pavarësisë dhe përgjegjshmërisë së tij; bashkëpunimin midis parlamentit dhe IKDNJ për sa i përket legjislacionit, mekanizmave ndërkombëtarë të të drejtave të njeriut dhe edukimit, trajnimit dhe rritjes së ndërgjegjësimit për të drejtat e njeriut; dhe monitorimin e përgjigjes ekzekutive ndaj gjykimeve dhe vendimeve për të drejtat e njeriut të marra nga organet kombëtare dhe ndërkombëtare.

Parlamentet mund të kenë gjithashtu mundësinë për të zhvilluar marrëdhënie pune me pjesë të tjera të “**makinerive**” kombëtare të të drejtave të njeriut, siç janë mbrojtësit e publikut ose avokatët e popullit, komisionerët për të drejtat e grupeve të veçanta dhe recensuesit e pavarur. Marrëdhënie të tilla janë të rëndësishme për të siguruar koherencën dhe bashkërendimin midis të gjitha institucioneve të interesuara për mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave të njeriut.

Një komitet për të drejtat e njeriut gëzon gjithashtu pozitën e duhur për të zhvilluar marrëdhënie të drejtpërdrejta me **organet rajonale dhe ndërkombëtare të të drejtave të njeriut**, duke përfshirë këtu edhe Këshillin e Evropës, siç diskutohet në 6.2.

Komiteti për të drejtat e njeriut - dhe parlamenti në tërësi - duhet të jenë të lidhur ngushtë me palët e interesuara të **shoqërisë civile** dhe t’u ofrojnë atyre mundësi të vazhdueshme për paraqitjen e dëshmimeve dhe në këtë mënyrë t’i informojnë ata mbi shqyrtimin e politikave dhe legjislacionit. Kjo duhet të përfshijë grupe të shoqërisë civile që janë në gjendje të përfaqësojnë përvojën e grupeve ose individëve të veçantë dhe të ndihmojnë parlamentarët të dëgjojnë dëshmi të dhëna direkt nga individët, të drejtat e të cilëve mund të preken nga legjislacioni dhe politika, në përputhje me parimin e përfshirjes.

62. Dok. 12636 (shënimi 14), paragrafët 41-42.

63. Parimet e Beogradit mbi marrëdhëniet midis institucioneve kombëtare të të drejtave të njeriut dhe parlamenteve, Beograd, Serbi, 22-23 shkurt 2012.

## Seancat dëgjimore të dëshmimeve të dhëna nga personat, të drejtat e të cilëve janë në pyetje

Kur Komisioni i Përbashkët për të Drejtat e Njeriut në Parlamentin e Mbretërisë së Bashkuar kreu një hetim mbi të drejtat e njeriut të të rriturve me aftësi të kufizuara në të nxënë, ai shprehu dëshirën të dëgjonte dëshmi jo vetëm nga profesionistët dhe grupet e shoqërisë civile, por edhe nga njerëzit me aftësi të kufizuara në të nxënë.<sup>64</sup> Në mënyrë që të arrihet gjithëpërfshirja, KEDNJ:

- nxori një version Easy Read<sup>65</sup> ( i Lexueshëm Lehtësisht) të njoftimeve të saj për shtyp, duke i ftuar njerëzit me aftësi të kufizuara në të nxënë të ndajnë përvojat e tyre me komitetin;
- zgjati afatin e zakonshëm tremujor për t'iu përgjigjur thirrjeve për dëshmi për ta bërë më të lehtë pjesëmarrjen e personave me aftësi të kufizuara në të nxënë;
- e filloi hetimin duke marrë këshilla nga Instituti Britanik për Aftësitë e Kufizuara në të Nxënë mbi mënyrën se si t'i bënin më të arritshme seancat e dëshmimeve me gojë për dëshmitarët me aftësi të kufizuara në të nxënë;
- u takua me të rritur me aftësi të kufizuara në të nxënë, përfshirë këtu të rritur me aftësi të kufizuara, komplekse dhe të thella në të nxënë, së bashku me mbështetësit dhe familjet e tyre, në një sërë mjedisesh të ndryshme arsimore dhe rezidenciale.

Materialet e dorëzuara nga anëtarët e publikut, përfshirë këtu njerëzit me aftësi të kufizuara në të nxënë dhe familjet e tyre ose kujdestarët dhe profesionistët që punojnë në fushën e aftësive të kufizuara në të nxënë, u botuan si pjesë e një vëllimi të veçantë të dëshmimeve. Përmbledhjet e regjistruara në audio dhe ato të marra nga Easy Read të raportit të hetimit të KPDNJ janë botuar në faqen e saj të [internetit](#).

Duhet të mbahet gjithashtu kontakt i ngushtë me **institucionet akademike**, përfshirë këtu institucionet e të drejtave të njeriut dhe me **profesionistët ligjorë** dhe organet e tyre përfaqësuese. Rekomandohet gjithashtu që komiteti për të drejtat e njeriut të vendosë kontakte me **median** dhe të tregohet në mënyrë të veçantë vigjilent për rëndësinë e mediave të lira dhe të pavarura për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në një demokraci.

64. Komisioni i Përbashkët për të Drejtat e Njeriut (2008), *Një jetë si çdo kush tjetër? Të drejtat e njeriut të të rriturve me aftësi të kufizuara në të nxënë*, Raporti i Shtatë i Sesionit 2007-08.

65. Easy Read është një mënyrë që bën të arritshëm informacionin duke përdorur, midis teknikave të tjera, fjalë të thjeshta, fjali të shkurtra dhe imazhe për të mbështetur tekstin.

## 5.6. Trajnimi dhe asistenca teknike

Asambleja Parlamentare rekomandon që parlamentet të ofrojnë ose të organizojnë trajnime orientuese për të drejtat e njeriut dhe sundimin e ligjit për të gjithë anëtarët dhe stafin e ri, përveç trajnimit periodik që ofrohet më pas (shihni Rezolutën 1823 (2011), Shtojca).

” Të drejtat e njeriut mund të mbrohen mjaftueshëm kur ekzistenca dhe fushëveprimi i tyre dihet dhe kuptohet nga parlamentarët dhe stafi i tyre mbështetës. Meqenëse parlamentarët janë drejtues të mendimit, modelet e të cilëve kanë rëndësi, ka rëndësi të jashtëzakonshme zhvillimi i një kulture parlamentare për të drejtat e njeriut për të integruar në mënyrë efektive problemet e të drejtave të njeriut në të gjitha aspektet e punës parlamentare.

*Christos Pourgourides, ish relator i APKE për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut<sup>66</sup>*

Trajnimi duhet të jetë i projektuar në mënyrë të tillë që parlamentarët të jenë në gjendje të identifikojnë rastet kur ngrihen çështjet e të drejtave të njeriut dhe të sundimit të ligjit gjatë punës së tyre dhe të kuptojnë natyrën dhe fushën e detyrimeve të tyre për të drejtat e njeriut. Një trajnim i tillë gjithashtu duhet të përmirësojë mirëkuptimin e parlamentarëve dhe përfshirjen e mekanizmave rajonalë dhe ndërkombëtarë të të drejtave të njeriut (në lidhje me Këshillin e Evropës, shikoni 6.2. dhe 6.3. përkatësisht pjesën për APKE dhe Gjykatën).

Parlamentet mund të kërkojnë të kenë akses në asistencën teknike e cila është e disponueshme nga organizatat rajonale dhe ndërkombëtare për t'i ndihmuar ata në ngritjen e kapaciteteve të tyre për të mbrojtur dhe realizuar të drejtat e njeriut. Siç shpjegohet në 6.2., një ndihmë e tillë jepet nga Asambleja Parlamentare përmes Divizionit të tij Parlamentar për Mbështetje të Projektit.

## 5.7. Vlerësimi i efektivitetit të komitetit për të drejtat e njeriut

Draft Parimet dhe Udhëzimet rekomandojnë që angazhimet për të drejtat e njeriut duhet të hartojnë një metodologji për vlerësimin e efektivitetit të tyre në mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave të njeriut. Ky është një qëllim që meriton të lavdërohet, por që mund të jetë i vështirë për t'u realizuar në praktikë.

66. Dok. 12636 (shënimi 14), paragrafi 43.

Përbën sfidë fakti që parlamentet dhe komitetet për të drejtat e njeriut nuk punojnë në izolim ose nuk ushtrojnë kontroll mbi të gjitha aspektet e punës së tyre; për shembull, ata mund të varen nga organizatat e shoqërisë civile dhe IKDNJ-ja për të sjellë në vëmendjen e tyre problemet e të drejtave të njeriut dhe nga ekzekutivi për të zbatuar masat e të drejtave të njeriut ose për të siguruar informacionin e nevojshëm që do t'i mundësojë parlamentit të kryejë rolin e tij mbikëqyrës (shiko 3.2.). Për më tepër, ata duhet të punojnë brenda kufijve të burimeve të disponueshme për sa i përket anëtarësisë së komisionit, këshilltarëve dhe stafit tjetër.

Sfidë tjetër është fakti që shumë prej ndikimit parlamentar është i padukshëm dhe i pamatshëm. Në të vërtetë, ndikimi i punës parlamentare është krahasuar me një ajsberg, me majë të dukshme dhe bazë të madhe, të fshehur.<sup>67</sup>

Në majë të ajsbergut gjenden ndikimet e dukshme si:

- ▶ ndryshime në legjislacion ose në politika që vijnë drejtpërdrejt nga rekomandimet parlamentare;
- ▶ ndikim i drejtpërdrejtë në përgjigjen ekzekutive ndaj gjykimeve ose vendimeve për të drejtat e njeriut; për shembull, duke siguruar rishikime në planet e veprimit ose ndryshime legjislative; dhe
- ▶ sigurimin e ndryshimeve në sistemin ekzekutiv të zbatimit, duke përfshirë mekanizmat dhe afatet për raportimin dhe shkëmbimin e informacionit me parlamentin.

Në bazë të ajsbergut janë ndikimet më pak të lehta për t'u përcaktuar, të cilat mund të vijnë, për shembull, nga aktiviteti joformal, i pa-dokumentuar që zhvillohet në korridore, sesa në dhomat e komisioneve apo dhomat e parlamentit. Shembuj të ndikimit që janë të vështirë të maten përfshijnë mbledhjen dhe sintetizimin e dëshmimeve për çështjet e të drejtave të njeriut; çështje "vëmendjeje" që përndryshe mund të lihen pas dore; dhe përmirësimi i cilësisë së vendimmarrjes së qeverisë përmes mbikëqyrjes dhe përgjegjësisë<sup>68</sup> – me fjalë të tjera, duke ndikuar në sjelljen qeveritare në pritje të mbikëqyrjes parlamentare. Ky lloj ndikimi është parandalues për mungesën e vëmendjes parlamentare ndaj të drejtave të njeriut, i cili mund të jetë edhe më të rëndësishmit, por edhe më i vështiri për t'u identifikuar.

Duke pasur parasysh këto sfida, si mund të arrijë të vlerësojë efektivitetin e tij një komitet për të drejtat e njeriut? Vendosja e qëllimeve gjithëpërfshirëse mund të ndihmojë në përcaktimin e standardeve të suksesit në çdo vlerësim

---

67. Philippa Webb dhe Kirsten Roberts (2014). *Mbikëqyrja efektive parlamentare e të drejtave të njeriut*. - Një kornizë për hartimin dhe përcaktimin e efektivitetit, Kolegji i Mbretit, Londër, faqja 4.

68. Meg Russell dhe Meghan Benton (2011). *Ndikimi selektiv: Ndikimi i politikës së Komitetit përzgjedhës të Dhomës së Komunëve*, Njësia e Kushtetutës, Kolegji Universitar Londër, faqe 8.

të ardhshëm.<sup>69</sup> Qëllimet do të ndryshojnë midis parlamenteve dhe komiteve të të drejtave të njeriut dhe duhet të përshtaten sipas kontekstit kombëtar. Është propozuar që qëllimet e punës parlamentare për të drejtat e njeriut mund të përfshijnë:

- ▶ **rritjen e dukshmërisë** së çështjeve të të drejtave të njeriut në punën e parlamentit, qeverisë dhe në sytë e publikut;
- ▶ **rritjen e përgjegjësisë** për praktikën e paligjshme të të drejtave të njeriut duke krijuar një vend tjetër para të cilit mund të diskutohen dhe monitorohen çështjet që lidhen me çështjet e të drejtave të njeriut, me qëllim përdorimin e mjeteve parlamentare për të ndikuar në ligj, politikë dhe opinionin publik;
- ▶ **përmirësimin e koordinimit** të politikave për të drejtat e njeriut brenda dhe ndërmjet parlamentit, qeverisë dhe shoqërisë civile, duke krijuar një qendër për bashkëveprim midis atyre që janë përfshirë në çështjet e të drejtave të njeriut;
- ▶ **Identifikimin e mundësive** për të bërë konkrete normat, për të cilat shteti ka marrë angazhim në ligjin ose politikën kombëtare, në përputhje me parimin e subsidiaritetit; dhe
- ▶ **Dhënien e një shkalle legjitimiteti demokratik** mbi normat e të drejtave të njeriut, duke u kërkuar parlamentarëve që të merren me kuptimin praktik të atyre normave në përmbajtjen e ligjit dhe politikave.<sup>70</sup>

Nëse një parlament vendos të vlerësojë efektivitetin e tij në arritjen e qëllimeve të tij, vëmendja duhet t'i kushtohet procesit të vlerësimit. Procesi ka të ngjarë të ketë besueshmëri më të madhe nëse:

- ▶ është ndërmarrë nga një konsulent i jashtëm me pavarësi dhe ekspertizë të provuar;
- ▶ ka një detyrë dhe metodologji të qartë;
- ▶ siguron mundësi për pjesëmarrje, ose përfaqësim të një shumëllojshmërie këndvështrimesh, përfshirë përvojën e grupeve, të drejtat e të cilave janë veçanërisht të ndjeshme ndaj abuzimit;
- ▶ publikon rezultatin e tij si dhe rekomandimet ose veprimet në vazhdimësi.

## Rishikimi – dhe përshtatja – e praktikave të punës

69. Webb dhe Roberts (shënimi 67), faqet 7-8.

70. Po aty, faqja 7.

Pas rreth pesë viteve funksionim, Komiteti i Përbashkët për të Drejtat e Njeriut vendosi të vlerësojë efektivitetin e praktikave të tij të punës.<sup>71</sup> Si rezultat i rishikimit, KPDNJ ndryshoi disa nga praktikat e saj të punës. Për shembull, vendosi që ta përqendrojë shqyrtimin e tij në çështjet më të rëndësishme të të drejtave të njeriut të ngritura nga propozimet legjislative, dhe të hartojë raporte legjislative më të shkurtra dhe më të përqendruara, në mënyrë që të përmirësojë aftësinë për të paralajmëruar në kohë parlamentin për to (shiko 3.1.).

Duke përdorur burimet e nxjerra nga kjo qasje më selektive, komiteti vendosi të zgjerojë më shumë fushat e punës së tij, duke përfshirë:

- monitorimin e zbatimit të vendimeve të Gjykatës;
- shqyrtimin e traktateve të të drejtave të njeriut të bëra nga Mbretëria e Bashkuar përpara se të ratifikohen, nëse ngrenë çështje të rëndësishme për të cilat parlamenti duhet të ndërgjegjësohet;
- kryerjen e hetimeve për çështjet e të drejtave të njeriut që përbëjnë shqetësim kombëtar, ku përparësi iu jepet subjekteve në të cilat KPDNJ mund të japë një kontribut të rëndësishëm dhe të dobishëm në debatin parlamentar dhe publik (shiko 3.1.).

Ky kapitull ka shqyrtuar tiparet thelbësore dhe praktikat e punës së një organi parlamentar efektiv për të drejtat e njeriut. Parimet kryesore që mbështesin krijimin dhe funksionimin e një komiteti për të drejtat e njeriut përfshijnë pavarësinë, pluralizmin politik, ekuilibrin gjinor, transparencën dhe përfshirjen. Nëse parlamentarët do të bëhen garantues efektivë të të drejtave të njeriut, është gjithashtu e rëndësishme që ata të kenë mundësi për trajnime dhe t'i rishikojnë qëllimet e tyre dhe praktikat e punës herë pas here. Gjithashtu thelbësore është shkalla e lidhjes së organeve parlamentare për të drejtat e njeriut me aktorët e tjerë kombëtarë, që merren me mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave të njeriut. Gjithashtu duhet të forcohen lidhjet me organet e Këshillit të Evropës në Strasburg, siç hulumton kapitulli tjetër.

---

71. Komiteti i Përbashkët për të Drejtat e Njeriut (2006), *Praktikat e ardhshme të punës të Komitetit*, Raporti i Sesionit të njëzet e tretë 2005-06, faqet 3-4.



## Kapitulli 6

# Si mund të punojnë parlamentarët më ngushtë me Këshillin e Evropës?

**P**arlamentet kombëtare dhe Këshilli i Evropës janë aleatë të fortë në përpjekjen e tyre të përbashkët për të mbrojtur dhe realizuar të drejtat e njeriut, si pjesë e angazhimit të tyre për vlerat e demokracisë, të drejtat e njeriut dhe sundimin e ligjit. Duke krijuar mekanizma për të interpretuar, zbatuar dhe monitoruar të drejtat e njeriut në kontekstin e tyre kombëtar, parlamentarët kontribuojnë në zhvillimin e një kuptimi të përbashkët të standardeve të të drejtave të njeriut në të gjithë kontinentin e Evropës. E marrë në këto terma, puna parlamentare për të drejtat e njeriut ofron një mundësi të shkëlqyeshme për parlamentarët që të formojnë agjendën në Strasburg.

Ky kapitull shikon rolin e veçantë të delegatëve të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës (6.1.), dhe mënyra të ndryshme në të cilat të gjithë parlamentarët mund të intensifikojnë kontaktin me institucionet e ndryshme të Këshillit të Evropës (6.2.). Një nxitje e mëtejshme që parlamentarët të angazhohen me të drejtat e njeriut në diskutimet e tyre është potenciali për të “fituar” mbrojtje nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut nëse ligjet që ata kanë kaluar, më vonë kundërshtohen në Strasburg (6.3.).

” [A]sambleja para së gjithash mbetet një rrjet njerëzor i parlamentarëve dhe zyrtarëve të përkushtuar, të motivuar për të mbrojtur vlerat humaniste

*Wojciech Sawicki, Sekretar i Përgjithshëm i Asamblesë Parlamentare<sup>72</sup>*

## 6.1. Roli dhe përgjegjësia e veçantë e delegatëve të Asamblesë Parlamentare

Një përgjegjësi e veçantë për të “sjellë në shtëpi” standardet evropiane për të drejtat e njeriut, bie mbi ata parlamentarë që janë gjithashtu anëtarë të delegacionit parlamentar të vendit të tyre në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Evropës,<sup>73</sup> të cilët mund të veprojnë si shtues të veprimtarive të këtij të fundit.

Anëtarët e Asamblesë bëjnë që zërat e tyre – dhe zërat e zgjedhësve të tyre – të dëgjohen në Strasburg, ndër të tjera, duke marrë përsipër krijimin e raporteve; duke kontribuar në debate plenare; duke marrë pjesë në mbledhjet e komiteteve; duke propozuar mocione për rezolutat ose rekomandimet e Asamblesë; duke marrë pjesë në zgjedhjet nga Asambleja; duke u bërë anëtarë të misioneve të vëzhgimit të zgjedhjeve; dhe duke shtruar pyetje para Komitetit të Ministrave. Në punën e tyre, ata duhet të përqafojnë dhe të angazhohen për promovimin e parimeve dhe vlerave mbi të cilat mbështetet Këshilli i Evropës.<sup>74</sup>

Në të njëjtën kohë, Asambleja ka theksuar vazhdimisht se delegatët e APKE-s kanë një detyrë të veçantë, ata kontribuojnë në zbatimin efektiv të normave ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

72. Këshilli i Evropës, “Udhëzuesi i anëtarëve, Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës” (shënimi 2), faqe 5.

73. Për të zbuluar se kush janë përfaqësuesit e APKE të parlamentit tuaj, konsultohuni në faqen e internetit të Asamblesë, në [www.assembly.coe.int/nw/Home-EN.asp](http://www.assembly.coe.int/nw/Home-EN.asp).

74. Shih APKE, “Rregullorja e Procedurës së Asamblesë”, Rezoluta 1202 (1999) e miratuar më 4 nëntor 1999, e modifikuar për herë të fundit nga Rezolutat 2169 dhe 2182 (2017); dhe gjithashtu Këshilli i Evropës, “Udhëzuesi i anëtarëve të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës” (shënimi 2). Në rast të sjelljeve të këqija, Kuvendi mund të shkarkojë anëtarët që mbajnë poste të zgjedhura brenda APKE (përkatësisht presidenti dhe nënkryetarët, dhe kryetarët e komiteteve dhe nënkryetarët); Rregullat 54 dhe 55 të [Rregullores së Punës së Asamblesë](#).

” Në këtë drejtim, mandati i dyfishtë i anëtarëve të Asamblesë – si anëtarë të Asamblesë ashtu edhe të parlamenteve të tyre kombëtare – ka rëndësi të veçantë për rritjen e vetëdijes së kolegjëve të tyre për çështje të të drejtave të njeriut. Unë e konsideroj si detyrë të të gjithëve ne, që të kontribuojmë në një proces të tillë në çdo nivel të mundshëm. Këtu kemi një përgjegjësi të veçantë.

*Christos Pourgourides, ish relator i APKE për zbatimin e gjykrimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut<sup>75</sup>*

Ndërsa Asambleja përbëhet nga delegatë nga të 47 shtetet anëtare, arritjet e saj janë përfundimisht arritjet e parlamentarëve kombëtarë që, si anëtarë të APKE, flasin dhe veprojnë në emër të 800 milionë evropianëve. Anëtarët e Asamblesë Parlamentare janë caktuar që në mënyrë ideale të përmbushin mandatin e dyfishtë që posedojnë për shkak të përkatësisë si në APKE, ashtu edhe në parlamentin e tyre kombëtar; për shembull, duke çuar bisedën rreth çështjeve të të drejtave të njeriut dhe aktiviteteve të APKE, dhe duke promovuar mirëkuptimin dhe zbatimin e standardeve të Konventës në nivel vendor.

” Theksoj nevojën për përfshirjen e kësaj Asambleje, e cila përbëhet nga parlamentarë kombëtarë, në këtë fushë. Ne duhet ta çojmë përpara këtë debat, veçanërisht në vendet ku kjo çështje nuk diskutohet, për t’u siguruar që, si qeveritë ashtu dhe gjykatat, të luajnë rolin e tyre në zbatimin e vendimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. [...] Ne duhet ta zhvillojmë këtë luftë në parlamentet tona kombëtare për të siguruar mbikëqyrjen e nevojshme të zbatimit të këtyre vendimeve të vendeve tona. Është detyra dhe përgjegjësia jonë ta bëjmë.

*Pier- Iv Le Borgn’, ish-relator i APKE për ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut<sup>76</sup>*

Në praktikë, roli i dyfishtë i delegatëve të Asamblesë ka qenë i dobishëm në krijimin e standardeve unifikuese pan-evropiane të të drejtave të njeriut: Anëtarët e APKE, të cilët ishin të përfshirë në elaborimin e traktateve të reja të Këshillit të Evropës për të drejtat e njeriut - shumë prej të cilave janë instrumente novatore

75. Dok. 12636 (shënimi 14), paragrafi 45.

76. APKE, Seanca e zakonshme e vitit 2017 (pjesa e tretë), protokollin, seanca njëzet e gjashtë, e enjte 29 qershor 2017 në 3.30 p.m., Dok. AS (2017) CR 26.

që lidhen, për shembull, me trafikimin e organeve njerëzore<sup>77</sup> ose mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna seksuale<sup>78</sup> – kanë përdorur lidhjet e tyre të ngushta me Strasburgun për të nxitur miratimin e legjislationit zbatues brenda parlamenteve të tyre. Kjo është bërë për të siguruar ratifikimin e shpejtë dhe reforma përparimtare në nivel vendor për t'u siguruar që qytetarët e vendeve të tyre të gëzojnë në mënyrë efektive të drejtat dhe liritë e përcaktuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe instrumentet e tjera të Këshillit të Evropës.

### **Konsultimet midis agjentëve qeveritarë dhe delegacionit të AKPE**

Disa shtete anëtare të Këshillit të Evropës kanë hartuar praktika për të nxitur dialogun midis parlamentit dhe koordinаторit të ekzekutimit të vendimeve të Gjykatës – më shpesh agjentit qeveritar dhe zyrës së tij/saj - të cilat mund të marrin formën e takimeve të rregullta ose ad hoc, që merren me ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës. Delegacioni Zviceran i AKPE, për shembull, zhvillon konsultime tremujore me agjentin e qeverisë kombëtare për të diskutuar çështje problematike në lidhje me kërkesat në pritje të Gjykatës, vendimet e dhëna, ose raste për të cilat mbështetja politike është e nevojshme për të përparuar, nëse duhet, një projekt legjislativ.

*Këshilli i Evropës, Komiteti Drejtues për të Drejtat e Njeriut<sup>79</sup>*

Angazhimi proaktiv i të drejtave të njeriut të anëtarëve të APKE “në bazën e tyre në shtëpi” është thelbësor për të forcuar subsidiaritetin dhe për t'u siguruar që mbrojtja e të drejtave të njeriut është efektive. Parlamentarët që janë edhe anëtarë të Asamblesë kanë aftësi dhe përgjegjësi:

- ▶ të informojnë kolegët e tyre në parlamentin kombëtar për aktivitetet e APKE dhe sigurojnë përcjelljen e duhur të rezolutave dhe rekomandimeve të Asamblesë;
- ▶ të krijojnë dhe të shtojnë diskutimet e arsyeshme dhe të mirë-informuara për të drejtat e njeriut bazuar në vlerat e tolerancës, pluralizmit, demokracisë dhe mosdiskriminimit të cilat i ndajnë shtetet anëtare të Këshillit të Evropës;
- ▶ të korrigjojnë kritikën e gabuar dhe të keq-informuara për sistemin e Strasburgut kur shfaqet në kontekstin e tyre kombëtar; dhe
- ▶ të krijojnë dhe mbrojnë strukturat dhe procedurat e nevojshme për ta bërë përfshirjen parlamentare të të drejtave të njeriut efektive në praktikë.

77. Konventa e Këshillit të Evropës kundër Trafikimit të Organeve Njerëzore (miratuar 25 mars 2015, hyrja në fuqi 1 mars 2018), [CETS Nr. 216](#).

78. Konventa e Këshillit të Evropës për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi seksual dhe abuzimi seksual (miratuar 25 tetor 2007, hyrja në fuqi 1 korrik 2010), [CETS Nr. 201](#).

79. CDDH, “Udhëzues për praktikën e mira” (shënimi 19), paragrafi 97.

” Unë ju bëj thirrje [anëtarëve të APKE] t’u tregoni kolegëve në vendet tuaja seriozitetin e sfidave ndaj sistemit të të drejtave të njeriut në përgjithësi dhe seriozitetin e prapambetjes në vende të ndryshme, dhe t’u transmetoni faktin se të drejtat e njeriut në Evropë nuk janë çështje e zakonshme. Unë gjithashtu ju bëj thirrje që [...] të merrni rol aktiv në nivel kombëtar në zbatimin e vendimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, të mbani qeveritë tuaja nën presion, që të alokojnë para, të ndryshojnë ligjet, si dhe të shtyni qeveritë tuaja të bëjnë më shumë për të zbatuar plotësisht dhe në kohë vendimet për të drejtat e njeriut.

*Nils Muiznieks, ish-komisioner i Këshillit të Evropës për të drejtat e njeriut<sup>80</sup>*

## **6.2. Si mund të ndërtojnë të gjithë parlamentarët një marrëdhënie më të ngushtë me Këshillin e Evropës**

Të gjithë parlamentarët mund të përfitojnë nga të mësuarit më shumë rreth “sistemit të Strasburgut”, dhe veçanërisht për funksionet, kompetencat dhe arritjet përkatëse të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe Asamblesë Parlamentare. Duke krijuar lidhje më të ngushta me institucionet e Këshillit të Evropës, parlamentarët mund të përfitojnë nga asistenca teknike në dispozicion për të ndihmuar në rritjen e aftësive të tyre për të mbrojtur të drejtat e njeriut në kontekstin e brendshëm, duke u siguruar që zërat e tyre të dëgjojnë në Strasburg. Në të njëjtën kohë, të gjithë parlamentarët kombëtarë duhet t’i bëjnë përgjegjës delegatët e tyre të Asamblesë, t’i nxisin ata të qëndrojnë në krah të zhvillimeve në Strasburg, dhe këto njohuri t’i çojnë në parlamentin e tyre kombëtar.

Ky seksion eksploron mënyra të ndryshme me të cilat parlamentarët mund të angazhohen në Asamblesë Parlamentare dhe Gjykatë.

### **Marrja e mbështetjes nga Asambleja Parlamentare**

Asambleja mbledh 324 politikanë të zgjedhur dhe një numër të barabartë zëvendësish nga 47 vendet anëtare të Këshillit të Evropës, të cilët takohen katër herë në vit në Strasburg për të diskutuar çështje aktuale që janë në kompetencën e saj të gjerë.

80. APKE, Raporti Vjetor i Aktivitetit 2016 nga Komisioneri i Këshillit të Evropës për të Drejtat e Njeriut, “Seanca e zakonshme 2017 (pjesa e dytë), protokolli, mbledhja e pesëmbëdhjetë, e mërkurë 26 prill 2017”, Dok. [AS \(2017\) CR 15](#).

Duke qenë një forum kryesor për debatin politik në Evropë, Asambleja ka ndikim të rëndësishëm: ajo ka fuqinë të propozojë traktate shumëpalëshe, të monitorojë zgjedhjet dhe pajtueshmërinë e shteteve me detyrimet që morën përsipër kur aderuan në Këshillin e Evropës,<sup>81</sup> të kryejë hetime për shkelje të të drejtave të njeriut, të kërkojë opinione juridike mbi ligjet dhe kushtetutat e shteteve anëtare, të propozojë sanksione kundër vendeve anëtare dhe të pezullojë disa të drejta të delegacioneve parlamentare që shkelin parimet e Këshillit të Evropës. Asambleja ka vepruar shpesh si një “motor” për forcimin e vlerave të përbashkëta të demokracisë, të drejtave të njeriut dhe sundimit të ligjit mbi të cilin u ndërtua Këshilli i Evropës, veçanërisht duke kërkuar ndërmarrjen e veprimeve nga Komiteti i Ministrave.<sup>82</sup>

Vitet e fundit, Asambleja ka marrë rol gjithnjë e më aktiv në monitorimin dhe promovimin e zbatimit të vendimeve të Gjykatës. Në zbatim të nenit 46 (2) të Konventës, përgjegjësia kryesore për mbikëqyrjen e zbatimit të vendimeve të Gjykatës i takon Komitetit të Ministrave (KM), megjithatë Asambleja ka miratuar një numër raportesh<sup>83</sup> dhe rezolutash<sup>84</sup> mbi këtë çështje që nga viti 2000, si dhe rekomandime<sup>85</sup> drejtuar Komitetit të Ministrave. Kontributi i saj në mbikëqyrjen e zbatimit të vendimeve të Gjykatës është vlerësuar në mënyrë të përsëritur nga qeveritë evropiane, veçanërisht në deklaratat e **Brajtonit** dhe **Brukselit**.

” [Z]batimi i vendimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut ka përfitur shumë në të kaluarën dhe vazhdon të përfitojë nga përfshirja më e madhe e Asamblesë Parlamentare dhe Parlamenteve Kombëtare.

*Përgjigja e Komitetit të Ministrave në Rekomandimin e APKE 1764 (2006)*

Në lidhje me këtë, Asambleja e ka përcaktuar veten si nxitëse të zellshme për rol më të madh të parlamentarëve në sigurimin e ekzekutimit të shpejtë dhe të plotë të vendimeve dhe në çështje të tjera që lidhen me të drejtat e njeriut. Përpjekjet e Kuvendit për të rritur rolin e parlamenteve në lidhje me të drejtat e njeriut morën impuls shtesë në 2012, me krijimin e një divizioni të

81. Për një përmbledhje të funksioneve të monitorimit të Këshillit të Evropës, përfshirë ato të Asamblesë, shihni Komitetin e APKE për çështjet Ligjore dhe të Drejtat e Njeriut, “Pasqyrë e mekanizmave themelore të monitorimit të të drejtave të njeriut dhe aktiviteteve të lidhura me Këshillin e Evropës”, Dok. *AS/Jur/Inf (2018) 03*, 18 janar 2018.

82. Për më shumë informacion mbi kompetencat e Kuvendit, shihni faqen e APKE-s, <http://website-pace.net/en> (me link me dokumentet përkatëse).

83. Dok. 8808 i 12 korrikut 2000; Dok. 9307 i 21 dhjetorit 2001; Dok. 9537 i 5 shtatorit 2002; Dok. 10192 i 1 qershorit 2004; Dok. 10351 i 21 tetorit 2004; Dok. 11020 i 18 shtatorit 2006; Dok. 12455 i 20 dhjetorit 2010.

84. Shihni, veçanërisht, Rezolutën 1226 (2000); Rezolutën 1516 (2006); Rezolutën 1787 (2011); Rezolutën 2075 (2015); dhe Rezolutën 2178 (2017).

85. Shihni, veçanërisht, Rekomandimin 1955 (2011); Rekomandimin 2079 (2015); dhe Rekomandimin 2110 (2017).

specializuar brenda Sekretariatit të APKE, Divizioni i Mbështetjes së Projektit Parlamentar (DMPP). Përmes programeve të synuara të bashkëpunimit dhe kurseve trajnuese që përfshijnë parlamentarët dhe stafin e parlamenteve kombëtare, DMPP është duke punuar për të rritur ndërgjegjësimin midis këtyre palëve të interesuara për standardet e Këshillit të Evropës në fusha të ndryshme tematike, të tilla si liria e shprehjes, barazia dhe mosdiskriminimi, të drejtat sociale dhe çështjet elektorale. Ai ka vendosur theks të ri në rritjen e aftësive të parlamenteve për të mbrojtur zbatimin efektiv të brendshëm të standardeve të Konventës dhe ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës së Strasburgut. Për të çuar më tej këtë qëllim, divizioni ka organizuar një sërë kursesh trajnimi në Strasburg dhe vendet anëtare.

## **Përfshirja në zgjedhjen e kandidatëve për gjykatësin tuaj kombëtar**

Ndërveprimi midis Strasburgut dhe parlamenteve kombëtare funksionon në të dy drejtimet, dhe parlamentarët mund të bëjnë që zëri i tyre të dëgjohet në Strasburg përmes rrugëve të ndryshme. Ata mund të marrin përsipër vetë për të ndihmuar në sigurimin që pozicionet kryesore në Këshillin e Evropës të plotësohen me individë të cilësisë, autoritetit, integritetit dhe pavarësisë më të lartë. Një mënyrë për ta bërë këtë është që ata të angazhohen në mënyrë aktive në përzgjedhjen e kandidatëve për gjykatësin e tyre kombëtar në Gjykatën Evropiane të Drejtave të Njeriut.

47 gjyqtarët për në Gjykatë zgjidhen nga Asambleja Parlamentare, nga listat me tre kandidatë të propozuara nga secili shtet,<sup>86</sup> për një mandat të vetëm nëntë vjeçar. Çdo vit, mijëra kërkues depozitojnë kërkesat në Gjykatën e Strasburgut, duke kërkuar rishqyrtim me pretendimin për shkelje të drejtave të tyre të Konventës. Për këta kërkues, Gjykata e Strasburgut, si arbitri i fundit për sa i përket qëllimit dhe kuptimit të këtyre të drejtave, është shpesh fanari i fundit i shpresës. Përkundër këtij sfondi, dhe duke pasur parasysh ndikimin e konsiderueshëm që ka pasur praktika gjyqësore e Gjykatës në formësimin e peizazhit të drejtave të njeriut në kontinentin Evropian,<sup>87</sup> rëndësia që të kemi gjyqtarë të kalibrit më të lartë që shërbejnë në Strasburg, nuk ka si të jetë tepruar. Përgjegjësia parësore për të siguruar që Asambleja të mund të zgjedhë vetëm nga kandidatët më të përshtatshëm u është ngarkuar shteteve.

---

86. Asambleja, përveç Sekretarit të Përgjithshëm të APKE-së, zgjedh gjithashtu edhe Komisionerin e Këshillit të Evropës për të Drejtat e Njeriut, Sekretarin e Përgjithshëm dhe Zëvendës Sekretarin e Përgjithshëm të Këshillit të Evropës.

87. Shihni Këshilli i Evropës, Ndikimi i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në shtetet palë – Shembuj të përzgjedhur (shënimi 3).

## Si zgjidhen gjyqtarët e gjykatës?<sup>88</sup>

Ekzistojnë dy faza të procesit zgjedhor:

### 1. Procedurat kombëtare të përzgjedhjes

Shtetet zgjedhin tre kandidatë të cilët duhet të kenë kualifikimet dhe përvojën e duhur juridike përveç njohurive aktive të gjuhës angleze ose frënge. Shtetet duhet të paraqesin kandidatë nga të dyja gjinitë (listat me kandidatë nga vetëm njëra gjini do të merren në konsideratë vetëm nëse ajo gjini përfaqësohet me numër më të vogël, ose në rrethana të jashtëzakonshme). Një panel ekspertësh ndërkombëtar, të caktuar nga Komiteti i Ministrave, u ofron qeverive këshilla konfidenciale mbi përshtatshmërinë e kandidatëve të mundshëm për postin, përpara se lista e kandidatëve të paraqitet në Asambleshën Parlamentare.

### 2. Zgjedhja nga Asambleja Parlamentare

Më pas lista shqyrtohet nga Komiteti për Zgjedhjen e Gjyqtarëve për në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, anëtarët e të cilit intervistojnë të tre kandidatët përpara se të japin rekomandim se cili prej tyre besojnë se është më i fortë. Nëse konstatohet se të tre kandidatët nuk kanë kualifikimet e nevojshme për t'u ulur si gjyqtarë në Gjykatë, komiteti e refuzon listën dhe kërkon që shteti të paraqesë një listë të re. Ai gjithashtu mund t'ia kthejë listën shtetit nëse procedurës kombëtare të përzgjedhjes i mungon drejtësia dhe transparenca.

Pasi komiteti pranon listën dhe bën rekomandimin, Asambleja plenare voton për kandidatin me votim të fshehtë. Në raundin e parë kërkohet një shumicë absolute e votave të hedhura. Nëse kjo nuk arrihet, zhvillohet një raund i dytë dhe kandidati me më shumë vota, sipas rregullit, zgjidhet për të shërbyer në Gjykatë.

88. Për një përshkrim të hollësishëm se si zgjidhen gjyqtarët për në Gjykatë, shihni Komitetin e APKE për Zgjedhjen e Gjyqtarëve në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, *Procedura e zgjedhjes së gjyqtarëve në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut*, dokumentin informativ të përgatitur nga Sekretariati, *AS/Cdh/Inf (2018) 01 rev 8*, 7 shtator 2018. Shihni gjithashtu Andrew Drzemczewski (2015). "Komiteti i Asamblesë Parlamentare për Zgjedhjen e Gjyqtarëve në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Këshilli i Evropës", *Revista Ligjore për të Drejtat e Njeriut*, Vëllimi 35, faqe 269-274.

Procedurat e përzgjedhjes kombëtare ndryshojnë në shtete të ndryshme,<sup>89</sup> dhe parlamentarët nuk përfshihen rregullisht në këtë proces. Megjithatë, përfshirja parlamentare në përzgjedhjen dhe emërimin e kandidatëve mund të jetë jetike për të ndihmuar që procesi “të reflektojë [parimet] e procedurës demokratike, shtetit të së drejtës, mosdiskriminimit, përgjegjshmërinë dhe transparencën.”<sup>90</sup> Përkundër këtij sfondi, Asambleja ka rekomanduar, tek [Rekomandimi 1429 \(1999\)](#), që Komiteti i Ministrave të ftojë qeveritë e shteteve anëtare të “konsultohen me parlamentet e tyre kombëtare kur hartojnë listat, në mënyrë që të sigurohet transparenca e procedurës kombëtare të përzgjedhjes.” Kjo kërkon që, në thelb, që qeveritë “të njoftojnë parlamentet dhe komitetet e duhura për procedurat dhe programet, kur hartojnë listat e kandidatëve për Gjykatën.”<sup>91</sup>

Parlamentarët mund të insistojnë që të përfshihen në procedurën e përzgjedhjes. Ata mund të miratojnë legjislacionin për të hartuar mekanizma të drejtë dhe transparentë për përzgjedhjen, dhe të vendosin kriteret për përzgjedhje mbi bazë merite, për tre kandidatë të kualifikuar.

Kështu, duke u përfshirë në procesin e përzgjedhjes së kandidatëve për postin e gjyqtarit në Gjykatë, parlamentet mund të marrin përgjegjësinë e tyre për të siguruar që kandidatët të jenë “me karakter të lartë moral dhe të kenë kualifikimet e kërkuara për emërimin në zyrën e lartë gjyqësore ose të jenë ekspertë ligjorë me njohuri të larta”, siç kërkohet nga Konventa. Duke vepruar në këtë mënyrë, parlamentarët kontribuojnë në përforcimin e cilësisë dhe autoritetit të Gjykatës gjithashtu.

## Takimi me gjykatësin kombëtar dhe zyrtarë të tjerë të Këshillit të Evropës

Forma më e drejtpërdrejtë e kontaktit, megjithëse deri më tani ende e nënvleftësuar, është që anëtarët e parlamentit - veçanërisht, por jo vetëm, anëtarët e komisioneve të specializuara për aktivitete për të drejtat e njeriut - të kryejnë një vizitë studimore në Strasburg dhe të takohen me gjykatësin (veçanërisht me gjykatësin e tyre kombëtar) dhe avokatë nga Regjistri i Gjykatës, si dhe me stafin nga organe të tjera të Këshillit të Evropës.

---

89. Shihni [Rezolutën e APKE 1646 \(2009\)](#), “Emërimi i kandidatëve dhe zgjedhja e gjyqtarëve në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut”, paragrafi 2 (gjithashtu [Dok. 11767](#), raportues: Z. Christopher Chope, Mbretëria e Bashkuar). Shihni gjithashtu Nisma për Drejtësi për Shoqërinë e Hapur / Komisioni Ndërkombëtar i Juristëve (KNJ) (2017). [Forcimi nga brenda: ligji dhe praktika në zgjedhjen e gjyqtarëve dhe komisionerëve për të drejtat e njeriut](#), Nju Jork, Fondacionet e Shoqërisë së Hapur.

90. [Rekomandimi i APKE 1649 \(2004\)](#), “Kandidatët për Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut”, paragrafi 3. Shihni gjithashtu [Rezolutën e APKE 1646 \(2009\)](#) (shënimi 89), paragrafi 2.

91. [Rekomandimi i APKE 1649 \(2004\)](#) (shënimi 90), paragrafi 20.

Komiteti për Çështje Juridike deri më tani ka organizuar dy vizita në Gjykatë për anëtarët e tij, të cilat përfshinin takime me (asokohe) kryetarin, kryesekretarin dhe zv/kryesekretarin e Gjykatës, përveç disa drejtuesve të divizionit, duke u ofruar kështu delegatëve mundësinë për të mësuar dhe diskutuar mbi organizimin dhe punën e Gjykatës. Në mënyrë të ngjashme, kurset e trajnimit për parlamentarët dhe stafin parlamentar të ofruara nga PPSD (shiko më lart, 6.2.) përfshijnë takime dypalëshe midis pjesëmarrësve dhe anëtarëve të regjistrit në divizionet përkatëse.

Nga ana tjetër, struktura të specializuara për të drejtat e njeriut ose parlamentarë të interesuar mund të marrin në konsideratë gjithashtu të ftojnë stafin e Këshillit të Evropës ose gjykatësin e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, të zgjedhur për vendin e tyre, për shkëmbim pikëpamjesh në parlament – pasi të kenë kuptuar se takime të tilla të mos bëhen rrugë që politikanët e zgjedhur të diskutojnë çështjet e mbetura pezull apo të kërkojnë që “gjykatësit të mbajnë përgjegjësi”.

### **Shkëmbimi i pikëpamjeve me gjykatësin tuaj kombëtar në Gjykatë**

Gjykatësi i atëhershëm, në lidhje me Mbretërinë e Bashkuar dhe Kryetarin e Gjykatës, Sër Nicolas Bratza, së bashku me regjistruetin e atëhershëm të Gjykatës, zhvilluan në mars 2012 një shkëmbim mendimesh me anëtarët e Komitetit të Përbashkët për të Drejtat e Njeriut në Parlamentin e Mbretërisë së Bashkuar. Seanca dëgjimore nxori forumin për debat mbi marrëdhëniet midis Gjykatës së Strasburgut dhe institucioneve vendase, përfshirë parlamentin. Kryetari Bratza tregoi gjithashtu shembuj të mirë të “dialogut gjyqësor” midis Strasburgut dhe gjykatave më të larta vendase, dhe shpjegoi një sërë mekanizmash që Gjykata kishte krijuar - përfshirë procedurën e gjykimit pilot, politikën e përparësisë dhe vendimet me një gjyqtar – që të merrej me zgjidhjen e, në vitin 2012 të ashtuquajtura të prapambetura, një numri të konsiderueshëm çështjesh në pritje.

” Mendoj se është plotësisht e përshtatshme që parlamentarët të inkurajohen të mund dhe ndjekin zhvillimet dhe të kuptojnë punën dhe problemet me të cilat përballlet Gjykata jonë.

*Sër Nicolas Bratza, ish-Kryetari i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut<sup>92</sup>*

92. Shihni Komisionin e Përbashkët për të Drejtat e Njeriut, *Transkriptimi i pakorrigjuar i dëshmive me gojë nga Sër Nicolas Bratza dhe Erik Fribergh mbi gjykimet e të drejtave të njeriut*, 13 mars 2012.

Kur ekzistojnë masa mbrojtëse kundër politizimit të padrejtë të seancave të tilla me gojë, ose përpjekjeve për të zvogëluar pavarësinë e gjyqësorit ndërkombëtar për të drejtat e njeriut, përfshirja e drejtpërdrejtë e parlamentarëve me gjyqtarin e tyre kombëtar në Gjykatë mund të jetë një mjet i vlefshëm për të rritur ekspertizën e parlamentarëve për të drejtat e njeriut. Dialogu i hapur nxit mirëkuptimin e ndërsjellë, ndihmon për të hedhur poshtë mitet për sistemin e Strasburgut, dhe në fund ndihmon legjislaturën për të shfrytëzuar potencialin e saj për të qenë një forcë galvanizuese në mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave të njeriut.

## Sigurimi i fondeve të duhura për Këshillin e Evropës

Disponueshmëria dhe cilësia e krijimit të kapaciteteve dhe programeve të tjera të bashkëpunimit me Asamblenë dhe organet e tjera të Këshillit të Evropës nga të cilat mund të përfitojnë parlamentarët, varet nga Organizata, duke u siguruar me fondet e duhura për të kryer funksionet e saj të ndryshme. Financimi i pamjaftueshëm ndikon negativisht mënyrën si Këshilli i Evropës mund të trajtojë sfidat me të cilat përballlet vetë Organizata dhe shtetet e saj anëtare, përfshirë parlamentet.

### Buxheti i Këshillit të Evropës

Buxheti i Këshillit të Evropës përbëhet kryesisht nga kontributet e vendeve anëtare. Kontributet kombëtare për këtë “buxhet të zakonshëm” llogariten në bazë të popullsisë dhe të produktit të brendshëm bruto. Pjesa tjetër e fondeve të Këshillit të Evropës - buxheti i jashtëzakonshëm - përbëhet nga buxhetet e marrëveshjeve të pjesëshme (të cilët kanë buxhetet e tyre), të programeve të përbashkëta me Bashkimin Evropian, dhe të kontributeve vullnetare nga shtetet. Programi dhe buxheti dyvjeçar miratohet nga Komiteti i Ministrave, në bazë të një propozimi të Sekretarit të Përgjithshëm.<sup>93</sup>

Ka qenë një traditë e gjatë për Asamblenë Parlamentare të japë komente për buxhetin dhe të paraqesë ide, “me qëllim vendosjen e Këshillit të Evropës në një pozicion për të marrë rolin e tij unik të garantuesit të vlerave demokratike që i gjithë kontinenti Evropian ndan.”<sup>94</sup> Asambleja ka shprehur shqetësim

93. Buxheti i përgjithshëm i Këshillit të Evropës për vitin 2018 është 466 045 100 €. Programi dhe buxheti i Këshillit të Evropës 2018-2019, 1300 (Buxheti) Takimi, 21-23 nëntor 2017, Dok. KM (2018) 1. Shihni gjithashtu informacionin në faqen e internetit të Komitetit të Ministrave, në <https://goo.gl/GcngR4>.

94. Rezoluta e APKE 1575 (2007), “Dimensioni politik i buxhetit të Këshillit të Evropës”, paragrafi 2.

për situatën buxhetore të Këshillit të Evropës, prej disa vitesh, pas vendimit të shteteve anëtare për të zbatuar parimin e rritjes zero (fillimisht në terma realë dhe, nga viti 2014, në terma nominalë <sup>95</sup>) në lidhje me kontributet e detyrueshme të shteteve anëtare për buxhetin e zakonshëm.<sup>96</sup>

Parlamentarët kanë rolin t'u kujtojnë qeverive të tyre përkushtimin ndaj vlerave të përbashkëta evropiane të demokracisë, të të drejtave të njeriut dhe sundimit të ligjit, të cilat Këshilli i Evropës i mbron dhe promovon. Ata mund të dërgojnë mesazhin e fortë se aftësia e Këshillit të Evropës për të vazhduar të jetë kujdestari i të drejtave të njeriut në të gjithë kontinentin e Evropës, varet nga fakti se sa burime ka në dispozicion për të vazhduar punën e tij. Asambleja i fton delegatët e APKE, në [Rezolutën 1575 \(2007\)](#), që t'i "kushtojnë vëmendje të veçantë gjatë diskutimeve buxhetore për angazhimin e shtetit të tyre përballë Këshillit të Evropës dhe, nëse është e nevojshme, të mbrojnë kontributin kombëtar në Buxhetet e Këshillit të Evropës". Parlamentarët gjithashtu mund të insistojnë, ndaj ekzekutivit, se kontributet buxhetore nuk duhet të përdoren kurrë si një instrument levash politike, dhe që shtetet të kthehen tek politika e rritjes së vërtetë, për sa i përket buxhetit të zakonshëm të Këshillit të Evropës, në përputhje me Thirrjen e Asamblesë në [Opinion 294 \(2017\)](#).

” Efikasiteti i sistemit pan-evropian të mbrojtjes së të drejtave të njeriut të krijuar nga Konventa, varet nga aftësia që kemi për të dhënë rezultatet që priten prej nesh, pra të trajtojmë shkeljet serioze dhe sistematike të të drejtave të njeriut, si dhe t'u japim mbështetjen e duhur shteteve anëtare me qëllim që këto shkelje të mos përsëriten. Për ta përmbushur këtë detyrë kemi nevojë për mjetet dhe burimet e duhura, dhe në të gjitha vizitat zyrtare në shtetet anëtare shtroj çështjen e situatës buxhetore të Organizatës sonë. Në diskutimet tona, ne nuk duhet ta anashkalojmë këtë çështje dhe unë kam besim në mbështetjen tuaj.

*Anne Brasseur, ish Kryetare e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës<sup>97</sup>*

95. Shihni, p.sh., [Rezoluta e APKE 2186 \(2017\)](#), "Thirrje për një samit të Këshillit të Evropës për të riafirmuar Bashkimin Europian dhe për të mbrojtur dhe promovuar sigurinë demokratike në Evropë", paragrafi 12.

96. Shihni, ndër të tjera, [Opinionin e APKE 294 \(2017\)](#), "Buxheti dhe përparësitë e Këshillit të Evropës për dyvjeçarin 2018-2019", paragrafët 16-17, 20.

97. Konferenca e nivelit të lartë e organizuar në Bruksel, [fjala e hapjes](#) nga Anne Brasseur (shënimi 16), faqet 21-22.

### 6.3. Të fituarit e mbrojtjes nga Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut: si e respekton Gjykata praktikën e mirë parlamentare

Ndërkohë që forcimi i lidhjeve me Strasburgun ndihmon parlamentarët të zhbllokojnë potencialin e tyre të plotë të për tu bërë garantues të të drejtave të njeriut, kur parlamentet përmbushin detyrimet e tyre për të drejtat e njeriut, ka edhe përfitime të tjera siç është forcimi i parimit të subsidiaritetit dhe kryesisht i sistemit të Konventës në tërësi.

Gjykata ka treguar se është përshtatur me rëndësinë e diskutimit të brendshëm demokratik mbi përcaktimet e saj gjyqësore. Mirëbesimi, debatet demokratike në parlament për çështjet e të drejtave të njeriut sot në Strasburg shihen si një mjet që ndihmon në ruajtjen dhe forcimin e parimit të subsidiaritetit mbi të cilin sistemi i Konventës u ndërtua, duke bërë kështu që puna e parlamenti për të drejtat e njeriut të jetë thelbësore për ruajtjen e efektivitetit të sistemit të Strasburgut.

Prandaj, kur parlamentet marrin pjesën e tyre të përgjegjësisë për respektimin dhe realizimin e të drejtave të njeriut me besnikëri në kontekstin e brendshëm, kjo nuk kalon pa u vënë re nga Gjykata e Strasburgut. Gjykata është e ndërgjegjshme për rolin shumë të rëndësishëm që parlamentet kanë si ligjvënës, legjitimitetin e drejtpërdrejtë demokratik të tyre dhe faktin që ata janë “të pozicionuar më mirë sesa një gjykatë ndërkombëtare për të vlerësuar nevojat dhe kushtet lokale”.<sup>98</sup> Ajo është respektuese e proceseve parlamentare dhe madje nxit zhvillimin të strukturave parlamentare dhe proceseve që lehtësojnë diskutimin e mirinformuar mbi implikimet e të drejtave të njeriut në masat e propozuara legjislative dhe politike.<sup>99</sup>

” [F]akti që sipas regjistrit parlamentar është treguar vëmendje e thelluar ndaj implikimeve të të drejtave të njeriut të një dekreti, ka domethënie në lloje të caktuara çështjesh, d.m.th. aty ku ngrihet marzhi i vlerësimit.

*Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, Kontributi i Gjykatës në Konferencën e Brukselit*

98. *Hatton dhe të Tjerët kundër. Mbretërisë së Bashkuar Kërkesa*. 36022/97, vendimi i 8 korrikut 2003, paragrafi 97.

99. Matthew Saul (2017). “Si ndërvepron, si mund, dhe duhet të ndërveprojë gjyqësori ndërkombëtar për të drejtat e njeriut me parlamentet kombëtare?”, Tek M. Saul, A. Føllesdal dhe G. Ulfstein (redaktorë), Gjyqësori ndërkombëtar për të drejtat e njeriut dhe parlamentet kombëtare: Evropa dhe më gjerë, Kembrixh, Shtypi i Universitetit të Kembrixhit, Kapitulli 14.

” Aktgjykimi ... për Mbrojtësit e Kafshëve, sikurse edhe për të tjerët, përfaqëson pohimin e rëndësishëm se kur shqyrtohet nëse dhe deri në çfarë mase duhet t’i japë Gjykata një Shteti Anëtar marzhin e vlerësimit, sa i përket vlerësimit të këtij të fundit për domosdoshmërinë dhe proporcionalitetin e një kufizimi të të drejtave të njeriut, cilësia e vendimmarrjes, si në fazën legjislativë ashtu edhe para gjykatave, është thelbësore dhe në fund të fundit mund të jetë vendimtare për çështjet marginale.

*Gjykatësi Robert Spano, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut*<sup>100</sup>

Konkretisht, cilësia e shqyrtimit parlamentar të të drejtave të njeriut ka dalë në pah pasi Gjykata, në disa raste, e ka marrë atë parasysht në vlerësimin e proporcionalitetit të kufizimeve të të drejtave të një kërkuesi, dhe e ka përdorur si bazë për të përshtatur një marzh më të gjerë vlerësimi për shtetet e paditura në procedurat para tij. Marzhi i vlerësimit, si rezultat i parimit të subsidiaritetit, i referohet lirisë që shtetet kontraktuese gëzojnë për të vendosur mënyrën si i kryejnë detyrimet e tyre sipas Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Kur një ligj apo politikë e kundërshtuar vjen si rezultat i diskutimeve të arsyeshme pjesëmarrëse brenda një parlamenti që punon me ndërgjegje për të rishikuar dhe siguruar pajtueshmërinë e masës së propozuar me Konventën dhe me standarde të tjera ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, ka shumë të ngjarë të jetë i mbrojtur nga një shoqëri demokratike dhe si rrjedhim Gjykata ka pak gjasa të konstatojë shkelje.<sup>101</sup>

### **Të fituarit e mbrojtjes nga Gjykata (I) – reklamimi politik**

Një shembull i spikatur i rastit kur cilësia e procesit parlamentar pati ndikim të rëndësishëm në gjetjet dhe konkluzionet e Gjykatës është *Mbrojtësit Ndërkombëtarë të Kafshëve kundër Mbretërisë së Bashkuar* [GC] (Aplikimi Nr. 48876/08, 22 prill 2013). Dhoma e Madhe u thirr për të përcaktuar nëse ndalimi i reklamimeve politike nga Mbretëria e Bashkuar - e cila kishte penguar kërkuesin, grup përkrahësish në mbrojtje të kafshëve, të vendoste një reklame televizive – arriti tek ndërhyrja disproporcionale, në të drejtën e OJQ-së për liri shprehje. Gjykata i kushtoi shumë rëndësi

100. Robert Spano (2014). “Universaliteti apo diversiteti i të drejtave të njeriut? Strasburgu në epokën e subsidiaritetit”, 14 *Rishikimi Ligjor për të Drejtat e Njeriut*, Vëllimi 14, faqe. 487 ff., faqe 498.

101. Shihni vendimet e Dhomës së Madhe në *Mbrojtësit Ndërkombëtarë të Kafshëve kundër Mbretërisë së Bashkuar* [GC] (Kërkesa Nr. 48876/08, 22 prill 2013); *S.A.S. kundër Francës* [GC] (Kërkesa Nr. 43835/11, 1 korrik 2014); *Lambert dhe të Tjerët kundër Francës* [GC] (Kërkesa Nr. 46043/14, 5 qershor 2015); dhe *Parrillo kundër Italisë* [GC] (Kërkesa Nr. 46470/11, 27 gusht 2015).

faktit që nga organet parlamentare ishte kryer një “ekzaminim i veçantë i aspekteve kulturore, politike dhe juridike të ndalimit” mbi reklamimin politik në Mbretërinë e Bashkuar: para miratimit, projektligjet përkatëse kishin qenë objekt i një procesi të hollësishëm shqyrtimi nga organe parlamentare të ndryshme, konsultime me ekspertë dhe kishte përfshirë një rishikim të hollësishëm të praktikës përkatëse gjyqësore të Gjykatës. Cilësia e rishikimit parlamentar (si dhe gjyqësor) mbi domosdoshmërinë e ndalimit të reklamimit politik bëri që Gjykata të arrinte në konkluzionin që ndërhyrja në të drejtën e lirisë së shprehjes së kërkuesit OJQ të ishte e justifikuar.

### **Të fituarit e mbrojtjes nga Gjykata (II) - të drejtat për riprodhim**

Shtetet gëzojnë një marzh të gjerë vlerësimi për rregullimin e çështjeve që kanë të bëjnë me të drejtat riprodhuese, fushë që nuk ka një konsensus europian të vendosur, dhe që lejon ngritje çështjesh morale dhe etike që janë komplekse dhe delikate, kundrejt një sfondi të shpejtë ndryshimi mjekësor dhe shkencor. Në rastin e *Parrillo kundër. Italisë* [GC] (Kërkesa Nr. 46470/11, 27 gusht 2015), për shembull, Gjykata mbështeti ndalimin për dhurim për kërkime shkencore të embrioneve të marra nga fekondimi in vitro. Me përfundimin se ndalimi përbënte ndërhyrje të lejuar në të drejtën e kërkuesit për respektimin e jetës së saj private (neni 8 i Konventës), Gjykata kishte parasysh faktin se procesi i hartimit të ligjit përkatës ishte gjithëpërfshirës i mendimeve të ndryshme shkencore dhe etike, mbi bazën e të cilëve legjislatura italiane kishte kryer një ekzaminim të plotë dhe të ekuilibruar të interesave të ndryshme në fjalë.

Me fjalë të tjera, kur vlerësohet nëse një kufizim i të drejtave të njeriut të një kërkuesi ishte “i domosdoshëm në një shoqëri demokratike”, gjyqtarët në Strasburg janë më të prirur ta “shpërblejnë” angazhimin parlamentar të mirëfilltë, dhe të drejtë me çështjet e të drejtave të njeriut, duke garantuar konsiderata të larta për shtetin.

Ky kapitull përcakton disa mundësi për të gjithë parlamentarët që të përfshihen në punën e Këshillit të Evropës - duke marrë rol aktiv në përzgjedhjen e kandidatëve për gjyqtarë të Gjykatës, duke kërkuar mbështetje teknike nga Këshilli i Evropës, dhe duke u takuar me gjyqtarin e tyre kombëtar ose gjyqtarë e tjerë. Duke vepruar në këtë mënyrë, parlamentarët mund të përfitojnë nga ekspertiza unike e “sistemit të Strasburgut”, duke formuar në të njëjtën kohë axhendën evropiane për të drejtat e njeriut.



# Përfundim

---

**R**ëndësia e parlamenteve kombëtare si garantuese të të drejtave të njeriut është përshkruar si “një ide të cilës i ka ardhur koha”.<sup>102</sup> Parlamentet, me tre rolet e tyre, atë të përfaqësimit, legjislacionit dhe mbikëqyrjes, kanë rol unik dhe jashtëzakonisht të rëndësishëm në mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave të njeriut dhe në mbrojtjen e sundimit të ligjit.

Ky udhëzues bazohet në praktikat e zhvillimit të parlamenteve në të gjithë Këshillin e Evropës për krijimin e rregullave institucionale efektive për të mbrojtur dhe realizuar të drejtat e njeriut - në veçanti, për të verifikuar përputhshmërinë e legjislacionit vendas me standardet e përcaktuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe për të siguruar zbatimin e plotë dhe në kohë të vendimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Mbrojtja e të drejtave të njeriut nuk është vetëm detyrim për parlamentarët, por edhe mundësi. Kur parlamentarët interpretojnë dhe zbatojnë standardet e të drejtave të njeriut në kontekstin e tyre kombëtar, ata kontribuojnë në zhvillimin e një mirëkuptimi të përbashkët të domethënies dhe fushëveprimit të drejtave në të gjithë Evropën. Për më tepër, ligjet dhe politikat, të cilat janë hartuar në bazë të diskutimeve të mirë informuara dhe të ndërgjegjshme për sa i përket implikimeve të tyre në të drejtat e njeriut, kanë më shumë gjasa të përballojnë çdo shqyrtim të ardhshëm gjyqësor.

Aktualisht, mundësia e shfrytëzimit të këtyre mundësive nga ana e parlamenteve kryesisht nuk është përmbushur. Parlamentarët janë të lutur të përdorin këtë udhëzues në mënyrë që të mund ta shfrytëzojnë atë lloj potenciali për t’u bërë garantues të vërtetë e të efektshëm të të drejtave të njeriut.

---

102. Deputeti Hywel Francis, Fjala përshëndetëse në një seminar të organizuar nga Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës mbi Rolin e Parlamenteve Kombëtare në Zbatimin e Vendimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, Portcullis House, Westminster, 14 tetor 2013.



# Shtojca 1 – Lista e kontrollit për parlamentarët

---

■ **A i kryen parlamenti juaj këto funksione të të drejtave të njeriut, qoftë përmes një komiteti të specializuar apo me anë të një marrëveshje tjetër?**

- ▶ A shqyrtoni projektligje për pajtueshmërinë me ligjin ndërkombëtar për të drejtat e njeriut, përfshirë këtu edhe dispozitat e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (Konventës) dhe protokollet e saj?
- ▶ A miratoni ligje për të vënë në zbatim vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (Gjykata)?
- ▶ A monitoroni zbatimin nga ana e ekzekutivit të vendimeve të Gjykatës dhe përgjigjen e tij ndaj vendimeve gjyqësore kundër shteteve të tjera, të cilat kanë implikime në rendin juridik të brendshëm?
- ▶ A përfshiheni në hartimin dhe miratimin e traktateve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut?
- ▶ A kryeni hetime tematike për problemet e të drejtave të njeriut?

■ **A i ka dhënë Parlamenti juaj udhëzime të hollësishme ekzekutivit për sa u përket nevojave që duhen për të kryer rolin tuaj mbikëqyrës, duke përfshirë këtu edhe parashtrimin e kërkesave:**

- ▶ për të bashkëngjitur memorandume për të drejtat e njeriut në të gjitha propozimet legjislative?
- ▶ për të raportuar të paktën një herë në vit në parlament, ndër të tjera, mbi zbatimin e vendimeve të Gjykatës?
- ▶ për të ndarë planet e veprimit dhe raportet e veprimit në po të njëjtën kohë kur ato dorëzohen në Komitetin e Ministrave të Këshillit të Evropës?
- ▶ për të ndarë përmbledhjet dhe përkthimet e vendimeve përkatëse të Gjykatës?
- ▶ për të përfshirë parlamentarët, sa më shumë të jetë e mundur, në çdo grup pune të krijuar për të bashkërenduar zbatimin e vendimeve të Gjykatës?

## ■ Nëse parlamenti juaj i cakton funksionet të të drejtave të njeriut një komiteti të posaçëm:

- ▶ a gëzon komiteti status të përhershëm?
- ▶ a janë përcaktuar qartë dhe ruajtur siç duhet detyrat e komitetit në urdhrat e përhershëm të parlamentit (ose ato ekuivalente me të)?
- ▶ a janë detyrat e komitetit të zgjeruara mjaftueshëm për të pasqyruar detyrimin e parlamentarëve:
  - për të mbrojtur dhe realizuar të drejtat e njeriut në shtetin në fjalë duke marrë parasysh të gjitha burimet përkatëse të ligjit kombëtar dhe ndërkombëtar?
  - për të njohur autoritetin interpretues të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, duke marrë parasysh të gjithë praktikën e tij gjyqësore?
  - për të njohur dhe vepruar sipas detyrimit pozitiv të shtetit?
- ▶ A përfshin qartësisht detyra e komitetit, ose a mund të interpretohet nga anëtarët e tij se përfshin:
  - verifikimin sistematik të përputhshmërisë së projekt-legjislacionit me Konventën Evropian për të Drejtat e Njeriut dhe me instrumentet e tjera ndërkombëtare të të drejtave të njeriut?
  - monitorimin sistematik të zbatimit të vendimeve gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, përfshirë këtu edhe kërkesën që qeveritë të paraqesin raporte të rregullta (dhe të paktën një herë në vit) në parlament mbi vendimet gjyqësore të të drejtave të njeriut dhe zbatimin e tyre?
- ▶ a ka komiteti kompetenca ose të drejtë të:
  - iniciojë propozime legjislative dhe ndryshime në ligje?
  - lëshojë urdhrë me shkrim për dëshmitarët dhe dokumentet që lidhen me detyrat e tij?
  - iniciojë hetime sipas përzgjedhjes të bërë nga vetë ai?
  - zhvillojë seanca dëgjimore të dëshmimeve me gojë?
  - ndërveprojë me shoqërinë civile?
  - kryejë vizita, përfshirë këtu edhe vizitat jashtë vendit?
  - ketë akses hyrjeje në vendet e paraburgimit pa paralajmërim?
  - raportojë në parlament?
  - bëjë rekomandime për qeverinë?

- ▶ a ka komiteti akses te këshilltarët e pavarur ekspertë të të drejtave të njeriut?
- ▶ a ka komiteti burime të mjaftueshme për të kryer funksionet e tij, përfshirë këtu edhe mbështetjen e përkushtuar të sekretariatit?
- ▶ a është metoda e emërimit të anëtarëve të komisionit transparente dhe a siguron që komiteti:
  - të jetë i pavarur nga ekzekutivi, për shembull, duke mos i lejuar ministrat të jenë anëtarë të komitetit?
  - të përputhet me parimet e ekuilibrit gjinor?
  - të pasqyrojë ekuilibrin e pushtetit midis grupeve politike brenda parlamentit?
  - të kryesohet nga një parlamentar me eksperiencë me të dhëna të vërtetuara që dëshmojnë pavarësinë dhe angazhimin në çështjet e të drejtave të njeriut?

#### ■ A i përfshini çështjet e të drejtave të njeriut në strukturat / komitetet parlamentare?

- ▶ A mund të keni akses në hulumtimet profesionale dhe shërbimet e informacionit brenda parlamentit?
- ▶ A janë këshillat ligjore të disponueshme për të gjithë parlamentarët që mund të kenë nevojë për ato në punën e tyre dhe jo vetëm për një komitet të specializuar për të drejtat e njeriut?

#### ■ A sigurohet parlamenti juaj që është efikas në kryerjen e funksioneve të tij për të drejtat e njeriut, duke:

- ▶ mbajtur faqen e internetit të përditësuar, ku informacionet mbi aktivitetet parlamentare për të drejtat e njeriut dhe të gjitha materialet përkatëse janë lehtësisht të arritshme?
- ▶ publikuar metodat e punës dhe një program pune me përparësi të komitetit të të drejtave të njeriut në parlamentin tuaj?
- ▶ ruajtur dialog të rregullt dhe marrëdhënie efektive pune me palët e tjera kombëtare të interesit, përfshirë institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut ose avokatin e popullit, gjyqësorin, akademikët dhe profesionistët ligjorë, dhe përfaqësues të shoqërisë civile?
- ▶ ftuar organizatat joqeveritare që të kontribuojnë në punën e tij, për shembull duke paraqitur prova nga pyetje tematike, duke ndihmuar në përcaktimin e përparësive për pyetjet aktuale mbi të drejtat e njeriut, ose duke siguruar prova në lidhje me ndikimin e legjislacionit për gëzimin e të drejtave të njeriut?

- ▶ ofruar apo siguruar trajnime të rregullta për parlamentarët dhe stafin parlamentar mbi të drejtat e njeriut dhe sundimin e ligjit?
- ▶ rishikuar praktikat e punës dhe i reformuar aty ku mund të bëhen më efikase?

### ■ A krijon dhe mban parlamenti juaj kontakt të ngushtë me Këshillin e Evropës?

- ▶ A ka procedurë, brenda parlamentit, me anë të së cilës delegatët në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Evropës (APKE) informojnë të gjithë parlamentarët mbi veprimtaritë e tyre dhe sigurojnë përcjelljen e duhur të rezolutave dhe rekomandimeve në Asamble?
- ▶ A luan parlamenti ndonjë rol për të siguruar që kandidatët për gjykatës kombëtar në Gjykatë të jenë të kalibrit më të lartë, duke përfshirë edhe krijimin e proceseve të drejta dhe transparente të përzgjedhjes, edhe kriteret emërimi të bazuara në meritë?
- ▶ A kanë kryer anëtarët e parlamentit vizita në Strasburg për të takuar gjykatësin kombëtar apo zyrtarë të tjerë të Gjykatës, Asamblenë Parlamentare ose zyrtarë të tjerë të Këshillit të Evropës?
- ▶ A e pyet parlamenti qeverinë në lidhje me financimin e Këshillit të Evropës dhe, nëse është e nevojshme, të mbrojë kontributin kombëtar në buxhetin e tij?

# Shtojca 2 – Rezoluta 1823 e APKE (2011)<sup>103</sup>

---

Miratuar nga Asambleja Parlamentare e  
Këshillit të Evropës më 23 qershor 2011

## **Parlamentet Kombëtare: garantuesit e të drejtave të njeriut në Evropë**

1. Asambleja Parlamentare kujton që vendet anëtare të Këshillit të Evropës janë përgjegjës për zbatimin efikas të normave ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, të cilat ata i kanë nënshkruar, veçanërisht ato të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (ETS Nr. 5, këtu e tutje “Konventa”). Ky detyrim ka të bëjë me të gjitha organet shtetërore, qoftë ekzekutive, gjyqësore apo legjislative.

2. Parlamentet kombëtare shpesh anashkalohe në këtë kontekst. Potenciali i tyre duhet të hulumtohet më tej. Ato janë thelbësorë për zbatimin efikas të normave ndërkombëtare të të drejtave të njeriut në nivel kombëtar dhe përmbushin detyrën e tyre për të mbrojtur të drejtat e njeriut përmes legjisllacionit (përfshirë verifikimin e projekt-legjisllacionit), përfshirjes në ratifikimin e traktateve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, duke i kërkuar llogari ekzekutivit, duke u ndërlidhur me institucionet kombëtare për të drejtat e njeriut dhe nxitur përhapjen e një kulture të gjerë të të drejtave të njeriut.

3. Anëtarët e Asamblesë, duke pasur mandat të dyfishtë – si anëtarë të Asamblesë dhe të parlamenteve përkatëse kombëtare – kanë detyrën e veçantë të kontribuojnë për një veprim të tillë.

4. Asambleja vëren se “Parimet e Parisit” të Kombeve të Bashkuara të vitit 1993 janë bërë standardi i pranuar ndërkombëtarisht për standardet thelbësore minimale për rolin dhe funksionimin e institucioneve të pavarura kombëtare për të drejtat e njeriut; përcaktime të ngjashme duhet të hartohen për organet parlamentare.

---

103. Debati i Asamblesë më 23 qershor 2011 (Seanca e 25-të) (shihni Dok. 12636, raporti i Komitetit për Çështjet Ligjore dhe të Drejtat e Njeriut, raportuesi: Z. Pourgourides). Teksti i miratuar nga Kuvendi më 23 qershor 2011 (Seanca e 25-të).

5. Në lidhje me zbatimin e vendimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (këtu e tutje “Gjykata”), Asambleja:

5.1. beson që parlamentet kombëtare janë në mënyrë unike vendosur për t’i kërkuar llogari qeverive në përgjegjësi për zbatimin e shpejtë dhe efikas të vendimeve të Gjykatës, si dhe për të miratuar me shpejtësi ndryshimet e nevojshme legjislative;

5.2. shprehet keqardhje që debati pas Interlakenit për të ardhmen e sistemit të Konventës nuk merr mjaftueshëm në konsideratë rolin e rëndësishëm të parlamenteve dhe shpreh keqardhjen për heshtjen e Deklaratës së Izmirit në këtë drejtim;

5.3. tregon shembujt pozitivë në disa shtete anëtare, veçanërisht në Mbretërinë e Bashkuar, Holandë, Gjermani, Finlandë dhe Rumani, të cilat kanë krijuar struktura parlamentare për të monitoruar zbatimin e gjykimeve të Gjykatës.

6. Për më tepër, Asambleja:

6.1. inkurajon parlamentarët të monitorojnë përcaktimin dhe zbatimin e standardeve të të drejtave të njeriut nga autoritetet vendore gjyqësore dhe administrative;

6.2. u kërkon parlamentarëve që të ushtrojnë përgjegjësinë e tyre për të kontrolluar me kujdes ekzekutivin në vendet e tyre kur bëhet fjalë për zbatimin e, veçanërisht, normave ndërkombëtare të të drejtave të njeriut;

6.3. u bën thirrje qeverive të përfshijnë parlamentet kombëtarë në procesin e negociimit të marrëveshjeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe në procesin e zbatimit të gjykimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut;

6.4. u bën thirrje të gjitha shteteve anëtare të parashikojnë procedura të përshtatshme parlamentare për të verifikuar në mënyrë sistematike pajtueshmërinë e projekt-legjislacionit me standardet e Konventës dhe për të shmangur shkeljet e ardhshme të Konventës, duke përfshirë monitorimin e rregullt të të gjitha gjykimeve që mund të ndikojnë potencialisht në urdhrat ligjore përkatës;

6.5. nxit parlamentet të rritin përpjekjet e tyre për të kontribuar në mbikëqyrjen e vendimeve të Gjykatës duke mbikëqyrur hapat e ndërmarrë nga autoritetet kompetente për të ekzekutuar gjykime të kundërta, përfshirë shqyrtimin e masave aktuale të marra;

6.6. u bën thirrje parlamenteve të krijojnë dhe/ ose të forcojnë strukturat që do të lejojnë integrimin dhe mbikëqyrjen rigoroze të detyrimeve të tyre ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, në bazë të parimeve të më poshtme.

7. Prandaj, Kuvendi fton parlamentet të zbatojnë parimet themelore të mëposhtme për mbikëqyrjen parlamentare të standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.

## **Shtojca – Parimet themelore për mbikëqyrjen parlamentare të standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut**

### **1. Kuadri dhe përgjegjësitë përkatëse**

Parlamentet kombëtare krijojnë strukturat përkatëse parlamentare për të siguruar një monitorim të rreptë dhe të rregullt të respektimit dhe mbikëqyrjes së detyrimeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, siç janë komitetet e dedikuara për të drejtat e njeriut ose strukturat përkatëse analoge, detyrat e të cilave do të përcaktohen qartë dhe përfshihen në ligj.

Këto detyra duhet të përfshijnë, *ndër të tjera*:

- ▶ verifikim sistematik të përputhshmërisë së projekt-legjislationit me detyrimet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut;
- ▶ kërkesa që qeveritë të paraqesin rregullisht raporte për vendimet përkatëse të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe zbatimin e tyre;
- ▶ iniciimi i propozimeve legjislative dhe ndryshimeve në ligje;
- ▶ autoritetin për të thirrur dëshmitarë dhe dokumente në lidhje me detyrat e tyre.

Këto komitete do të kenë përgjegjësinë për t'u siguruar që parlamentet këshillohen dhe informohen siç duhet për çështjet e të drejtave të njeriut. Gjithashtu duhet të ofrohet trajnim për të drejtat e njeriut për parlamentarët dhe stafin e tyre.

### **2. Këshillim i pavarur**

Komitetet për të drejtat e njeriut ose strukturat e duhura analoge duhet të kenë akses në ekspertizë të pavarur në ligjin e të drejtave të njeriut. Ata do të kenë në dispozicion gjithashtu burime të mjaftueshme për të siguruar mbështetje të specializuar të sekretariatit.

### **3. Bashkëpunimi me institucione të tjera dhe me shoqërinë civile**

Sipas rastit, do të ruhen bashkëpunimi dhe dialogu i rregullt me institucionet përkatëse kombëtare (për shembull, institucionet kombëtare të të drejtave të njeriut, komisionerët parlamentarë) dhe organet ndërkombëtare (për shembull, Asambleja Parlamentare, Komisioneri i Këshillit të Evropës për të Drejtat e Njeriut, organet Evropiane dhe organet e tjera ndërkombëtare monitoruese të të drejtave të njeriut), si dhe me përfaqësuesit e organizatave të rëndësishme jo-qeveritare që kanë përvojën e duhur dhe të plotë.

## Shtojca 3 – Lexime dhe burime shtesë

---

Chang B. dhe Ramshaw G. (2016), *Forcimi i aftësive parlamentare për mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave të njeriut: raport sintezë*, Londër, Fondacioni Westminster për Demokraci, <https://goo.gl/D2p15y>.

Këshilli i Evropës (2016), *Ndikimi i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në shtetet palë - Shembuj të zgjedhur*, Botimi i Këshillit të Evropës, gjithashtu i disponueshëm si dokument informacioni i Komitetit të APKE për çështjet Ligjore dhe të Drejtat e Njeriut, *Dok. AS/Jur/Inf(2016)04*, 8 janar 2016.

Donald A. dhe Leach P. (2016), *Parlamentet dhe Gjykata Evropiane e të drejtave të njeriut*, Oksford, Oxford University Press.

Hunt M., Hooper H. dhe Yowell P. (eds) (2015), *Parlamentet dhe të drejtat e njeriut: korrigjimi i deficitit demokratik*, Oxford, Hart Publishing.

Hunt M., Hooper H. dhe Yowell P. (2012), *Parlamentet dhe të drejtat e njeriut: korrigjimi i deficitit demokratik*, Këshilli i Kërkimit të Arteve dhe Shkencave Humane, Seria e Politikave Publike Nr. 5, <https://goo.gl/Q59NZq>.

Unioni ndër-parlamentar (2016), *Të Drejtat e Njeriut - Udhëzues për parlamentarët Nr. 26*, Gjenevë, UNP/Zyra e Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut.

Iniciativa për Drejtësi e Shoqërisë së Hapur (2013), *Nga të drejtat në mjete juridike: strukturat dhe strategjitë për zbatimin e vendimeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut*, New York, Fondacionet e Shoqërisë së Hapur, <https://goo.gl/L8HFp6>.

Divizioni i Mbështetjes së Projektit Parlamentar (DMPP) (2016), Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës, “Roli i parlamenteve në zbatimin e standardeve të GJEDNJ: përmbledhje e strukturave dhe mekanizmave ekzistues - Memorandumi i Historikut”, DMPP (2016) 19, 2 nëntor 2016, <https://goo.gl/c8YagR>.

Saul M., Føllesdal A. dhe Ulfstein G. (eds) (2017), *Gjyqësori ndërkombëtar për të drejtat e njeriut dhe parlamentet kombëtare*: Evropa dhe më gjerë, Kembrixh, Cambridge University Press.

Fondacioni Westminster për Demokraci (2011), *Të drejtat e njeriut dhe parlamentet: udhëzues për anëtarët dhe stafin*, Londër, Fondacioni Westminster për Demokraci/Shoqata e Ligjit Ndërkombëtar, <https://goo.gl/u4y786>.

## Burimet e zgjedhura të Këshillit të Evropës

■ Këshilli i Evropës, Komiteti i Ministrave, *Mbikëqyrja e ekzekutimit të vendimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Raporti Vjetor i 10-të 2016 (mars 2017)*. Të gjitha raportet vjetore të disponueshme në: <https://goo.gl/16X29q>.

■ Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, dokumente me të dhëna tematike dhe profilet e vendeve, <https://goo.gl/nhCNkt>.

■ **Baza e të dhënave HUDOC** siguron akses në praktikën gjyqësore të Gjykatës (Dhoma e Madhe, aktgjykimet dhe vendimet e komisionit, çështjet e komunikua, opinionet këshilluese, njoftimet për shtyp dhe përmbledhjet ligjore nga “Shënimi Informacioni për praktikën gjyqësore” (i cili botohet çdo muaj), Komisioni Evropian i të Drejtave të Njeriut (vendime dhe raporte) dhe Komiteti i Ministrave (rezolutat). Faqja e kërkimit HUDOC është e disponueshme në anglisht, frëngjisht, rusisht, spanjisht dhe turqisht; dhe baza e të dhënave përmban më shumë se 21 000 tekste në 31 gjuhë, përveç gjuhëve zyrtare (anglisht dhe frëngjisht); <https://goo.gl/Jc2LHc>.

■ Baza e të dhënave HUDOC-EXEC mundëson akses në dokumentet që lidhen me ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (statusi i ekzekutimit të çështjeve, planet/raportet e veprimit të qeverisë, komunikimet e tjera, vendimet e Komitetit të Ministrave (nga 1 janar 2011 e në vazhdim) dhe rezolutat përfundimtare. Faqja e kërkimit HUDOC-EXEC është në dispozicion në anglisht dhe frëngjisht; <https://goo.gl/4WoSQM>.

■ Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës, “Zbatimi i vendimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut”, Dok. 14340 e 12 qershorit 2017 (relator: Z. Pierre-Yves Le Borgn’, Francë), <https://goo.gl/bLM7JE>.

■ “Forcimi i subsidiaritetit: integrimi i praktikës ligjore të Gjykatës së Strasburgut në ligjin kombëtar dhe praktikën gjyqësore”, Kontributi i Komisionit për Çështjet Ligjore dhe të Drejtat e Njeriut të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës në Konferencën mbi Parimin e subsidiaritetit, Shkup, 1-2 tetor 2010, Dok. AS/Jur/Inf (2010) 04, <https://goo.gl/JXY7SS>.



2 ENGLISH ANGL

GERMAN ALLEMAND

372

371

370



Për pothuajse prej 70 vitesh, Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës i ka frymëzuar parlamentarët që të përdorin mandatet e tyre demokratike për të nxitur një kulturë gjithëpërfshirëse të respektimit të të drejtave të njeriut brenda një demokracie të mbështetur fort në sundimin e ligjit.

Si ligjvënës dhe përfaqësues të qytetarëve evropianë, parlamentarët kanë përgjegjësi, së bashku me degët e ekzekutivit dhe gjyqësorit të shteteve të tyre, të parandalojnë dhe të denoncojnë shkeljet e të drejtave të njeriut. Ata mund ta realizojnë këtë duke u siguruar që normat ndërkombëtare të të drejtave të njeriut zbatohen në mënyrë efektive, norma të cilat vendet e tyre i kanë nënshkruar vullnetarisht, veçanërisht ato të përcaktuara në Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

Qëllimi i këtij udhëzuesi është që t'i pajisë parlamentarët e gjithë Evropës për përmbushjen e përgjegjësisë të tyre dhe për shfrytëzimin e mundësive për të mbrojtur dhe zbatuar të drejtat e njeriut. Për këtë qëllim, udhëzuesi rishikon strukturat, funksionet dhe metodat e punës që lejojnë parlamentet të verifikojnë në mënyrë më efektive përputhshmërinë e legjislacionit, duke përfshirë këtu projekt-legjislacionin dhe praktikën administrative në vendet e tyre, me standardet evropiane për të drejtat e njeriut. Këto burojnë nga Konventa, por edhe nga praktika gjyqësore e Gjykatës së Strasburgut dhe nga puna e organeve të tjera të Këshillit të Evropës. Si frymëzim, udhëzuesi përfshin shembuj të praktikave më të mira nga një numër parlamentesh evropiane.

[www.assembly.coe.int](http://www.assembly.coe.int)

Ky përktim u prodhua me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian dhe të Këshillit të Evropës. Pikëpamjet e shprehura këtu në asnjë rast nuk mund të merren bazë për të reflektuar opinionin zyrtar të asnjë pale.



Këshilli i Evropës është organizata kryesore e kontinentit për të drejtat e njeriut. Në të bëjnë pjesë 47 shtete anëtare, përfshirë të gjithë anëtarët e Bashkimit Evropian. Asambleja Parlamentare, e përbërë nga përfaqësues të 47 parlamenteve kombëtare, mundëson organizimin e një forumi për debate dhe propozime mbi çështjet sociale dhe politike të Evropës. Shumë konventa të Këshillit të Evropës burojnë nga Asambleja, duke përfshirë këtu Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Të gjithë shtetet anëtare të Këshillit të Evropës kanë nënshkruar Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dokument i cili është hartuar për të mbrojtur të drejtat e njeriut, demokracinë dhe shtetin e së drejtës. Gjykata Evropiane mbikëqyr zbatimin e Konventës nga shtetet anëtare.

[www.coe.int](http://www.coe.int)

Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian kanë vendosur të lidhin së bashku dijen, burimet dhe fatet e tyre. Së bashku, ata kanë ndërtuar një zonë të stabilitetit, demokracisë dhe zhvillimit të qëndrueshëm, duke e ruajtur kulturën diversitetit, tolerancën dhe liritë individuale. Bashkimi Evropian është i angazhuar t'i ndajë arritjet dhe vlerat e tij me vendet dhe popujt përtej kufijve të saj.

[www.europa.eu](http://www.europa.eu)

Përktimi është bashkë financiar nga Bashkimi Evropian

